



Në mbështetje të nenit 12, nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 paragrafi 2 shkronja (c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 9 të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal të datës 13.03.2008, nenit 10, nenit 39 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika 2.3 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 00.10.2022 merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023

1. Miratohet vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronës publike.
2. Normat tatimore të cekura në pikën 1 të këtij vendimi janë si në vijim:

Kategoria e Pronës	Norma tatimore
Për njësitë bujqësore të parcelave	0.16 %
Për njësitë bujqësore të objekteve	0.16 %
Për njësitë pyjore të parcelave	0.16 %
Për njësitë rezidenciale të parcelave	0.16 %
Për njësitë rezidenciale të objekteve	0.16 %
Për njësitë komerciale të parcelave	0.17 %
Për njësitë komerciale të objekteve	0.17%
Për njësitë industriale të parcelave	0.16%
Për njësitë industriale të objekteve	0.16 %

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Tatimit në Pronë në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim do të aplikohet së zbatuari nga 1 Janari 2023.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Ministrisë së Financave,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Zyrës së Tatimit në Pronë,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ____/22
Datë: 00.10.2022

Defrim Kafexhiu
Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja f) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 10 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, Ligjit Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.6 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Shkresës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Nr. Prot. 5557-5/22 të datës 06.10.2022, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt.00.10.2022 miraton këtë :

V E N D I M

Për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave

1. Me këtë vendim miratohet Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Rahovecit 2022-2027.
2. Shtojcë e këtij Vendimi është edhe Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Rahovecit 2022-2027.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike dhe Kryetari i Komunës.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me 01 Nr. 372/22 i datës 23.09.2022.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Shërbime Publike,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËSNË RAHOVEC

01-Nr. ____/22
Datë: 00.10.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
PRISTINE - ULAZNA - RECEIVING
06.10.2022
020-848/5

Për:	Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit, Defrim Kafexhiu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Rahovecit
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Venera Çerkini, Zëvendësuese e Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës: 1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë
Lloji i aktit:	Vendimi Nr.372/22 për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, miratuar nga KK Rahovec.

I nderuari Kryetar, Latifi,
I nderuari Kryesues, Kafexhiu,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave më datë 29.09.2022, ka pranuar nga MAPL vendimin Nr.372/22 për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, miratuar nga KK Rahovec, datë 23.09.2022.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, kërkon nga kuvendi i komunës së Prishtinës :

Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit

Vendimi Nr.372/22 për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, miratuar nga KK Rahovec, datë 23.09.2022.

Arsyetimi

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të përmbajtjes së vendimit Nr.372/22 për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, miratuar nga KK Rahovec, datë 23.09.2022, konstatoi se:

Hyrja e vendimit është bazuar në dispozitat e Ligjit nr 04/-L-060 për Mbeturina, mirëpo, nëse merret parasysh data e miratimit të Vendimit Nr.372/22 për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, viti përfundimtar duhet të jetë 2027, respektivisht 2022-2027, përndryshe plani konsiderohet që është hartuar për katër (4) vite e jo pesë (5) vite si parashihet me dispozitat ligjore në fuqi

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mbetet në dispozicion të Komunës së Rahovecit dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly of Rahovec



PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIM TË
MBETURINAVE
Komuna Rahovec
2022-2027



TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE DHE KONTEKSTI I PLANIT	12
1.1 Hartimi i Planit Komunal për Menaxhim të Mbeturinave.....	12
1.2 Metodologjia.....	12
2. POLITIKAT, STRATEGJIA DHE KORNIZA LIGJORE KOMBËTARE.....	14
2.1 Baza ligjore dhe instrumentet juridik për menaxhim të mbeturinave.....	14
2.2 Principet e menaxhimit të mbeturinave	14
2.3 Kuadri ligjor në Kosovë mbi mbeturinat.....	15
2.4 Rolet dhe përgjegjësitë	16
3. ASPEKTI INSTITUCIONAL	18
3.1 Organizimi në nivel qendror.....	18
3.2 Organizimi i menaxhimit të mbeturinave në nivel komune.....	19
4. KONTEKSTI LOKAL, KORNIZA STRATEGJIKE DHE PROFILI I KOMUNËS.....	21
4.1 Përshkrim i përgjithshëm i komunës	21
4.2 Relievi	22
4.3 Infrastruktura rrugore.....	25
4.4 Aspekti socio – ekonomik.....	26
4.5 Gjendja e përgjithshme mjedisore	32
5. KONTEKSTI LOKAL I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE	33
5.1 Situata aktuale e shërbimi të grumbullimit të mbeturinave në komunë	33
5.2 Mbuleshmëria me shërbimin e menaxhimit të mbeturinave.....	36
5.3 Forma e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave	42
5.4 Përmbledhje e gjetjeve në menaxhim të mbeturinave	43
5.5 Riciklimi i mbeturinave	44
5.6 Kompostimi.....	44
5.7 Administrimi i mbeturinave të vëllimshme dhe rrymave tjera	45

5.8 Deponimi i mbeturinave	45
5.9 Shërbimet e pastrimit të rrugëve dhe shërbime tjera mirëmbajtjeje	47
5.10 Mjetet për ofrimin e shërbimit	47
5.11 Financat dhe të hyrat financiare	48
5.12 Përmbledhje e gjetjeve kryesore nga vlerësimi i gjendjes fillestare	51
5.13 Nevojat dhe prioritetet	51
6. PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE	52
6.1 Planifikimi strategjik dhe vizioni	52
6.2 Objektivat dhe Rezultatet e PKMM	54
7. VLERËSIMI DHE ANALIZA E PËRBËRJES SË MBETURINAVE KOMUNALE	59
7.1 Kriteret për planifikim	59
7.2 Gjenerimi i mbeturinave	60
7.3 Përbërja e mbeturinave në komunën e Rahovecit	62
7.4 Projektioni i rritjes së sasisë së mbeturinave 2021 – 2025	64
8. PLANI FINANCIAR I SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE	68
8.1 Kosto e shërbimit 2021-2025	68
8.2 Kosto operative të shërbimit	69
8.3 Kosto kapitale	69
8.4 Kostot investive për realizimin e PKMM	72
9. PLANIFIKIMI I MBULIMIT TË KOSTOVE	79
10. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	82
10.1 Rregullorja komunale	82
10.2 Zbatimi i rregullores dhe sanksionet	82
10.3 Licencimi mjedisor	83
10.4 Pjesëmarrja e sektorit privat	83
10.5 Mbështetja politike	83

11. NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK.....	84
11.1 Metoda për komunikim dhe informim.....	84
11.2 Pjesëmarrje qytetare	85
12. PLANI VEPRIMIT	86

LISTA E FIGURAVE

Figure 1. Hierarkia e menaxhimit të mbeturinave.....	15
Figure 2. Struktura organizative e KRM "EKO Regjioni".....	21
Figure 3. Harta e Pozitës gjeografike të komunës së Rahovecit.....	22
Figure 4. Rrjetëzimi dhe infrastruktura rrugore e komunës së Rahovecit...Error! Bookmark not defined.	
Figure 5. Destinimi i sipërfaqeve.....	28
Figure 6. Ekonomia- Industria shpërndarja	30
Figure 7. Ndertime në zona të reja shtesë.....	31
Figure 8. Harta e deponive ilegale (2020) Komuna Rahovec.....	Error! Bookmark not defined.
Figure 9. Ndarja e territorit në zona të shërbimit- Komuna Rahovec	38
Figure 10. Lokacioni i Deponise Sanitare te Mbeturinae ne Landovice.....	41
Figure 11. Sistemi Ajrimit te Deponise ne Land.....	41
Figure 12. Diagrama e përbërjes së mbeturinave (raporti GIZ 2012/ AMMK 2014)	62
Figure 13. Rritja e sasisë së mbeturinave deri 2026 sipas fraksioneve të gjeneruara në Komunën e Rahovecit	66
Figure 14. Fraksionet e mbeturinave në vit (2021)	63

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Statistika për Komunën e Rahovecit.....	27
Tabela 2. Shpërndarja e popullsisë sipas vendbanimeve.....	27
Tabela 3. Numri i klienteve në faturim (referuar të dhënave të ASK dhe të paraqitura nga KRM "EKO Regjioni").....	32
Tabela 4. Orari i operimit (referent 2019-2020).....	Error! Bookmark not defined.
Tabela 5. Të dhëna mbi çështjet mjedisore lidhur me menaxhimin e mbeturinave	43
Tabela 6. Logjistika e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave.....	42
Tabela 7. Logjistika e operimit për grumbullimin e mbeturinave.....	43
Tabela 8. Të dhëna lidhur me inkasimin për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave.....	44
Tabela 9. Kostot potenciale të të ardhurave	44
Tabela 10. Objektivi I sipas PKMM.....	54
Tabela 11. Objektivi II sipas PKMM i ofrimit të shërbimit për ndarje në burim	51
Tabela 12. Objektivi i III sipas PKMM	52

Tabela 13. Objektivi i IV sipas PKMM.....	52
Tabela 14. Objektivi 5.1 sipas PKMM.....	58
Tabela 15. Objektivi 5.2 sipas PKMM.....	58
Tabela 16. Gjenerimi i mbeturinave për banor në komunë të Rahovecit referuar sasisë së deponimit (periudhë gjashtë mujore).....	61
Tabela 17. Përbërja e mbeturinave në komunën e Rahovecit sipas gjenerimit.....	62
Tabela 18. Përbërja e mbeturinave të fraksionit të thata/të riciklueshme.....	63
Tabela 19. Karakteristikat e përbërjes së deponive ilegale në komunën e Rahovecit.....	59
Tabela 20. Rritja e popullsisë dhe sasisë së mbeturinave komunale në Komunën e Rahovecit gjatë 5 viteve të ardhshme.....	60
Tabela 21. Gjenerimi i mbeturinave.....	60
Tabela 22. Llojet e mbeturinave vjetore të gjeneruara në Komunën e Rahovecit.....	61
Tabela 23. Përbërja vjetore e mbeturinave të amvisërisë (2020).....	62
Tabela 24. Shpenzime operative.....	69
Tabela 25. Tabela përmbledhëse e investimit.....	68
Tabela 26. Projekcioni i të hyrave të shërbimit prej MM.....	79
Tabela 27. Projekcioni i të hyrave të shërbimit/Inkasimi.....	Error! Bookmark not defined.
Tabela 28. Kosto referente sipas tregut të shitjes të materialit të riciklueshëm.....	81

Parathënie nga Kryetari i Komunës

Të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit,

Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave, përveçse si obligim ligjor njëherësh e konfirmon zotimin që kemi në këtë fushë për Komunën tonë. Qëllimi kryesor i këtij plani është planifikimi konkret në këtë fushë me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm në shërbim të një qyteti me mjedis të pastër për të gjithë ne. Duke investuar dhe krijuar kushte për një sistem më të mirë të menaxhimit të mbeturinave njëherësh synojmë të kontribuojmë në zhvillimin ekonomik në komunën tonë, përmes krijimit të vendeve të reja të punës në sektorin e riciklimit.

Në fund, si komunë jemi duke bërë përpjekje me qëllim përmbushjen e objektivave për maksimizimin e efikasitetit të shërbimit për qytetarë dhe minimizimin e impakteve mjedisore dhe financiare duke synuar bashkëpunim në zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës së Rahovecit në fushën e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të saj.

Për realizimin e këtij plani, dua të falënderoj organizatën joqeveritare Green Art Center –Prishtina (GAC) për mbështetje dhe përkrahjen e vazhdueshme profesionale në komunën e Rahovecit dhe hartimin e planeve konkrete në menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave, me rëndësi të veçantë për komunën tonë.

Ndërkohë, si komunë dhe bashkërisht do të punojmë në vazhdimësi për të krijuar kushte për ruajtjen e mjedisit dhe mbështetjen ndaj iniciativave për ndarje në burim dhe riciklim të mbeturinave.

Kryetari i Komunës

Smajl Latifi

Shkurtesat

AKMM	Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
ASK	Agjensia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DMP	Drejtoria për e Mjedisit dhe Pyjeve
GAC	Green Art Center Prishtina
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
MEA	Ministria e Ekonomisë dhe Ambjentit
KRM	Kompania Regjionale për Grumbullim të Mbeturinave
MM	Menaxhimi i Mbeturinave
PKMM	Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave
PMMI	Plani lokal i Menaxhimit të Mbeturinave Inerte
SRKMM	Strategjinë e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave

Përkufizimet e Mbeturinave

Përkufizimet që janë përdorur në këtë document janë ato që janë përdorur në Ligjin Nr.2012/04-L-060 për Mbeturinat.

Bio-mbeturinë – mbeturinat biodegraduese nga kopshtet, parqet, ushqimet dhe mbeturinat e kuzhinës nga familjet, restorantet, objektet turistike, shitoret me pakicë dhe mbeturinat engjashme nga impiantet për përpunimin e ushqimit.

Deponi – vendi i caktuar dhe rregulluar për mbeturina, ku do të vendosen mbeturinat nën apo mbi sipërfaqe të tokës.

Deponim përfundimtar i mbeturinave – operimet të cilat ofrojnë zgjidhje përfundimtare për mbeturinat të cilat nuk mund të ripërdoren apo përpunohen, duke mos rrezikuar mjedisin apo shëndetin e njeriut.

Deponim – çdo operim i cili nuk është përpunim, as në rastet kur operimi ka për pasojë sekondare rikuperimin e substancës apo energjisë.

Kompostim – trajtim i mbeturinave të biodegradueshme nën veprimin e mikroorganizmave në prezencën e oksigjenit, i cili kryhet me qëllim të prodhimit të kompostit nën kushte të kontrolluara.

Konsumator – personi icili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve ose merr shërbime të caktuara sipas Ligjit Nr. 04/L-060 "Për Mbeturinat", Republika e Kosovës.

Kullim – çdo lëng që rrjedh ose i shpërlarë nga mbeturinat e deponuara dhe që shkarkohet nga deponia ose gjendet brenda deponisë.

Licenca për menaxhimin e mbeturinave – leje me shkrim e cila lëshohet me vendim të Ministrisë, me të cilën vërtetohet se janë plotësuar kushtet sipas Ligjit Nr. 04/L-060 "Për Mbeturinat", Republika e Kosovës.

Mbeturinë – substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedhë apo është i detyruar ta hedhë.

Mbeturina industriale – mbeturinat të cilat krijohen nga aktivitetet, proceset industriale, prodhimi artizanale dhe veprimtari të tjera prodhuese.

Mbeturina inerte – mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar si:

i. mbeturina inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materietë tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;

iii. të tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Mbeturina komerciale – mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industrial.

Mbeturina komunale – mbeturina nga amvisëritë dhe mbeturina nga aktivitetet e tjera të cilat, për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.

Mbeturina medicinale – mbeturina të cilat krijohen gjatë kryerjes së shërbimeve medicinale.

Mbeturina të parrezikshme – mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme.

Mbeturina të rrezikshme – mbeturinat që paraqesin një apo më shumë veti të rrezikshme.

Mbeturina të veçanta – mbeturinat të cilat për nga natyra e krijimit dhe trajtimit konsiderohen të veçanta.

Mbeturina të vëllimshme – mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave bëhet në mënyrë të veçantë.

Mbledhje – mbledhje dhe transportim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objektin për trajtim ose deponim të mbeturinave.

Mbledhje e ndarë – nënkupton mbledhjen, kur grumbullimi i mbeturinave bëhet në mënyrë të ndarë në lloje, të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik.

Menaxhim i mbeturinave – aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut, mbledhjen, transportin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin dhe deponimin përfundimtar të mbeturinës, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së këtyre aktiviteteve.

Parandalim – masat e ndërmarra para se substanca, materiali apo produkti të bëhet mbeturinë, për të redukuar:

- i. sasinë e mbeturinës, përfshirë ri-shfrytëzimin e produkteve ose zgjatjen e jetëgjatësisë së produkteve;
- ii. efektet negative të mbeturinave për mjedisin dhe shëndetin e njeriut;
- iii. përmbajtjen e substancave të dëmshme në materiale dhe produkte.

Përdorimi mbeturinave – çdo operim, veprimtari që kryhet për qëllime riciklimi ose ripërdorimi të mbeturinave, pjesërisht ose në tërësi, duke përfshirë edhe çdo aktivitet të specifikuar.

Përpunim i mbeturinave – operim, rezultati kryesor i të cilit është vënia në shërbim e mbeturinave për qëllime të dobishme, duke zëvendësuar materialet e tjera të cilat përndryshe do të duhej të përdorreshin për të plotësuar një funksion të caktuar, apo përgatitja e mbeturinës për të plotësuar ato funksione në ndonjë impiant apo në ekonominë e gjerë.

Person – person fizik ose juridik i cili është i involvuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi në proceset për menaxhimin e mbeturinave.

Prodhuesi mbeturinës – çdo person, veprimtaria e të cilit krijon /prodhon mbeturinë ose çdonjëri që merret me para-procesim, përzierje apo operime të tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës.

Riciklim – çdo operim i përpunimit nga i cili materialet mbeturinë janë rikthyer në produkte, materiale, substance, qoftë si origjinale apo për qëllime tjera. Kjo përfshin rikthimin e materialeve organike, por nuk përfshin përfitimin e energjisë dhe ripërpunimin në materiale që përdoren si karburante apo për operimet e mbulimit të mbeturinave.

Ri-përdorim – çfarëdo operimi me të cilin çdo produkt apo komponent, i cili nuk është mbeturinë, përdoret përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin është destinuar.

Stabilizim i mbeturinës – çdo trajtim i mbeturinës me metodën e caktuar me qëllim të zvogëlimit të ndikimeve negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Zotëruesi mbeturinës – prodhuesi i mbeturinës apo personi që e posedon mbeturinë.

1. HYRJE DHE KONTEKSTI I PLANIT

1.1 Hartimi i Planit Komunal për Menaxhim të Mbeturinave

Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave (PKMM) është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbeturinave duke i harmonizuar me politikën në nivel qendror dhe atë lokal për menaxhimin e mbeturinave komunale.

PKMM mundëson orientimin strategjik për të ardhmen e sektorit për menaxhim të mbeturinave për Komunën e Rahovecit si dhe njëkohësisht krijon një qëndrim të përbashkët midis akterëve të ndryshëm në nivel lokal. Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave PKMM-ja paraqet dokumentin bazë me të cilin organizohet procesi i menaxhimit të mbeturinave në nivel të Komunës.

Qëllimi i PKMM është parashtrimi i qartë i politikave të menaxhimit të mbeturinave në nivel komunal, duke harmonizuar interesat e të gjithë akterëve dhe publikut, të cilit ky shërbim i ofrohet për të siguruar një menaxhim më efikas dhe të qëndrueshëm, ku do të krahasohen dhe vlerësohen të gjitha opsionet e mundshme, duke përfshirë impiantet e përshtatshme për trajtimin e mbeturinave sipas llojeve.

Më konkretisht, ky plan ka si qëllim të mundësojë dhe sigurojë si më poshtë:

- Përputhshmëri me Strategjinë e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave (SRKMM) dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave dhe arritjen e objektivave kombëtare të paracaktuara në fushën e menaxhimit të mbeturinave;
- Identifikimin e prioriteteve në sektorin e menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve dhe krijimin e strategjive për zbatimin e tyre në mënyrë efektive, të ndërthurura sipas një Plan Veprimi.
- Opsionet më të mira për menaxhimin e mbeturinave: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave në përputhje me objektivat kombëtare.
- Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementëve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbeturinat në të gjithë sistemin e menaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standartet e menaxhimit të tyre
- Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave;
- Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbeturina sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare.

1.2 Metodologjia

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit në hartimin e planeve komunale për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave, Komuna e Rahovecit në partneritet me Green Art Center-Prishtina dhe

përmes asistencës teknike të ekspertizës së angazhuar prej Institutit për Zhvillim Të Qëndrueshëm (ISD), u mundësua hartimi i Planit Komunal për Menaxhim të Mbeturinave për Komunën e Rahovecit.

Në fazën e parë u themelua grupi i punës me përfaqësues nga zyrtarë të komunës dhe përfaqësues të Green Art Center – Prishtina (GAC). GAC si bashkëpunëtor me Komunën e Rahovecit ishte pjesë e zhvillimit të PKMM që në fillimet e tij duke rishikuar dhe përzgjedhur opsionet që i përshtaten më shumë politikave të Komunës. Çdo etapë e këtij plani, duke përfshirë prioritetet e komunës, vizionin, objektivat, opsionet, investimet dhe afatet kohore u diskutuan dhe u ranë dakort gjatë takimeve të grupit të punës si edhe janë bazuar dhe harmonizuar me prioritetet e Komunës në këtë sektor.

Konkretisht të shprehura në mënyrë të listuar hapat bazë të ndjekura në procesin e planifikimit të menaxhimit të mbeturinave janë si mëposhtë:

Hapi 1. Krijimi i strukturave organizative

Hapi 2. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese

Hapi 3. Planifikimi operacional i menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave

Hapi 4. Planifikimi financiar për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave

Hapi 5. Konsultimet për zbatueshmërinë e planit me përfaqësuesit kryesorë të komunës.

Procesi i konsultimit ka parashtruar nevojat në sektorin e menaxhimit të mbeturinave që i nevojiten komunës, duke ofruar mundësi për komente apo diskutime të ndryshme. Përfaqësuesit e Komunës së Rahovecit kanë asistuar gjatë lëvizjeve në terren si edhe kanë dhënë asistencën e tyre në lidhje me identifikimin e gjendjes ekzistuese të ofrimit të shërbimit në gjithë territorin e komunës përmes ofrimit të të dhënave për analizim të detajuar gjatë përgatitjes së planit.

2. POLITIKAT, STRATEGJIA DHE KORNIZA LIGJORE KOMBËTARE

2.1 Baza ligjore dhe instrumentet juridik për menaxhim të mbeturinave

Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave (SRKMM 2021 – 2030) dhe Planit i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturina (PRKMM 2013-2017 referuar fazës së parë sipas SRKMM) ka përcaktuar drejtimin e politikës së Qeverisë së Kosovës për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave deri në 2022, duke synuar minimizimin e mbeturinave që në burim si dhe zvogëlimin e rrezikshmërisë prej tyre, të zbatohet riciklimi dhe trajtimi (mekanik, biologjik, energjetik) deri te ripërdorimi dhe shfrytëzimi i mbeturinave. Me këtë strategji dhe planin e veprimit për mbeturina, synohet të përmirësohet gjendja aktuale e menaxhimit të mbeturinave duke ndërtuar konceptin e drejtë dhe modern për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave.

Kjo strategji është krijuar duke u mbështetur në angazhimin financiar të Qeverisë së Kosovës për të përmirësuar sektorin e mbeturinave në lidhje zbatimin e politikave për reduktimin e mbeturinave, riciklimin, kompostimin apo përpunimin e tyre për përfitim energjie. Në kuadër të Strategjigjisë së Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave janë vendosur objektiva, të cilët synojnë përmirësimin e mënyrës së menaxhimit të mbeturinave në Kosovë. Realizimi i synimeve dhe prioritetëve sipas kësaj strategjie janë përmbledhur sipas këtyre objektivave:

Objekti 1: Masat e përgjithshme për forcimin e sistemit për menaxhimin dhe monitorimin e mbeturinave;
Objekti 2: Investimi në zonat me probleme kritike dhe në infrastrukturën për mbeturina;
Objekti 3: Rritja e shkallës së vetëdijësisë, ndërgjegjësisë dhe informimit


Strategjia Kombëtare e Mbeturinave përshkruan mekanizmat kyç për investimet në sektorin e mbeturinave dhe ka parashikuar nevojat për financim sipas dy fazave. Sipas planifikimeve të nivelit qëndror, në mënyrë që të arrihet përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e mbeturinave, është llogaritur që një kosto investimesh prej 133.85 milion euro ku tregohet se jo më shumë së gjysma e fondeve të përgjithshme do të sigurohen nga të ardhurat publike, përderisa pjesa tjetër do të sigurohet nga burime tjera. Në mënyrë që të mirë menaxhohen mbeturinat në nivel nacional, vendi është ndarë në nivel strategjik në 7 regjione bazuar në kufijtë gjeografikë sipas regjioneve aktuale. Këto njësi janë parë si strukturë bazë, por nuk përjashtohet mundësia e bashkimit apo bashkëpunimit midis këtyre zonave për të përfituar nga ekonomia e shkallës (referuar LIGJI NR. 04/L-060 Për Mbeturina). Në vazhdim, çështjet e këtyre regjioneve të mbeturinave do të menaxhohen nga një strukturë apo grup i zonës së mbeturinave që përbëhet nga partnerë mjedisorë rajonal dhe lokalë.

Plani Kombëtar i Mbeturinave ka përmbledhur dhe sygjerruar disa masa dhe veprime për mirë menaxhimin e mbeturinave komunale dhe rrymave tjera (referuar vetëm planit për fazën e parë të SRKMM në planin kohor 2013-2017), nga teknologjitë e trajtimit të mbeturinave deri tek minimizimi dhe riciklimi e tyre.

2.2 Principet e menaxhimit të mbeturinave

Direktivat e BE-së dhe dokumentat strategjik, rekomandojnë që të gjithë planet në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal duhet të bazohen në parimet e përgjithshme të paraqitur më poshtë:

- ❖ *Hierarkia e mbeturinave:* Hierarkia e mbeturinave përfaqëson një nga parimet kryesore udhëzuese në menaxhimin e mbeturinave në BE. Hierarkia përshkruan një set të metodave prioritare në menaxhimin e mbeturinave duke vendosur "parandalimin dhe ripërdorimin" në majë dhe depozitimin si alternativën më pak të favorshme.



- ❖ *Parimi reduktues:* Të sigurojë ruajtjen e burimeve natyrore, duke minimizuar sa më shumë të jetë e mundur gjenerimin e mbeturinave. Qëllimi kryesor në reduktimin e mbeturinave qëndron në domosdoshmërinë e ndërprerjes së lidhjes midis rritjes ekonomike dhe gjenerimit të tyre.

Figure 1. Hierarkia e menaxhimit të mbeturinave

- ❖ *Parimi parandalues:* Të sigurojë reduktimin e impakteve nga mbeturinat në shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit, veçanërisht të reduktojë substancat e rrezikshme tek mbeturinat. Ky parim mundëson vënien në lëvizje të mekanizmave institucional dhe kontrollues të cilët nëpërmjet monitorimeve të vazhdueshme arrijnë të adresojnë potencialet që vijnë nga mbeturinat e rrezikshme si edhe gjenerimin e tepër të mbeturinave urbane.
- ❖ *Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë:* Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë kërkon që Mbeturinat të menaxhohen më afër vendit ku prodhohet. Politika e BE-së rekomandon që shtetet anëtare të merren vetë me Mbeturinat e tyre, duke shmangur eksportin në vende të tjera.
- ❖ *Parimi i përgjegjësisë së prodhuesit apo ndotësit:* Prodhuesit, nga prodhimtaria e të cilëve krijohet mbeturina janë përgjegjës për zgjedhjen e teknikave më të përshtatshme dhe më të pranueshme për mjedisin. Prodhuesit e mbeturinave janë të detyruar të bartin koston e të gjitha masave parandaluese për ndotjen e mjedisit, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave. Sipas parimit "Ndotësi paguan": Ata që ndotin mjedisin duhet të bartin koston totale të menaxhimit të mbeturinave, duke përfshirë për koston e masat parandaluese dhe eliminimin e dëmit të shkaktuar nga aktivitetet e tyre.

2.3 Kuadri ligjor në Kosovë mbi mbeturinat

Qeveria e Kosovës është e angazhuar në procesin e anëtarësimit në BE dhe për këtë qëllim Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapesinor dhe Infrastruktura është duke punuar drejt përafrimit dhe adoptimit të legjisllacionit të shtetit të Kosovës në përputhje me instrumentet legjisllative të BE-së.

Korniza ligjore për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë është pjesërisht e harmonizuar me Acquis të Bashkimit Europian (BE) për sektorin e mbeturinave. Aktualisht, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapesinor dhe Infrastruktura (MMPHI) është duke bërë përpjekje për harmonizim të plotë, ku qëllimi kryesor i kornizës aktuale ligjore për menaxhimin e mbeturinave është shmangja dhe reduktimi i gjenerimit të

mbeturinave, ripërdorimi i elementeve të ripërdorshme të mbeturinave, parandalimi i ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut; si dhe përfundimisht deponimi i mbeturinave në mënyrë miqësore ndaj mjedisit.

Ligji kryesor që rregullon sektorin e mbeturinave në Kosovë është Ligji nr. 04/L-060 për mbeturinat ("Ligji për mbeturinat"). Ky ligj është veçanërisht i rëndësishëm kur shpjegohet rregullimi i sektorit të mbeturinave në Kosovë në raport me ligjet e tjera, veçanërisht ato që adresojnë krijimin, menaxhimin dhe udhëheqjen e ndërmarrjeve publike (p.sh.harmonizimi me: Ligji për Ndërmarrjet Publike dhe Ligji për Shoqëritë Tregtare).

Ligje të tjera që në një farë mënyre ndikojnë në rregullimin e sektorit të mbeturinave përfshijnë:

1. Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Ligji për Vetëqeverisjen Lokale");
2. Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar nga ligjet që ndryshojnë Ligjin për Ndërmarrjet Publike Ligji nr. 05/L-009 dhe Nr. 04/L-111 ("Ligji për NP");
3. Ligji Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, i ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 04/L-006 ("LSHT");
4. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar nga ligjet që ndryshojnë dhe plotësojnë Ligjin për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës nr. 04/L-237 i vitit 2014, 05/L-068 i vitit 2016 dhe nr. 05/L-092 i vitit 2016 ("Ligji për PP");
5. Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko-Privat ("Ligji për PPP");
6. Ligji Nr. 04/L-024 për Ndihmën Shtetërore ("Ligji për Ndihmën Shtetërore");
7. Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit ("Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit");
8. Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinorë ("Ligji për Planifikim Hapësinorë");
9. Ligjet tjera që kanë ndikim të kufizuar në rregulloren e menaxhimit të mbeturinave përfshijnë: Ligji për Ndërtim, Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, Ligji mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligji për Ujëra, Ligji për Kimikatet, Ligji për Parandalimin dhe Kontrollin e Ndotjes, Ligji për Produktet Biocide, Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ligji për Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimeve dhe Mbeturinave. Komponentët kryesorë të këtyre mbeturinave janë: guri, betoni, tulla, komponentë hekuri, komponentë plumbi, komponentë elektrik, etj.

2.4 Rolet dhe përgjegjësitë

Bazuar në politikën kombëtare për mbeturina, Pas miratimit të Ligjit për Mbeturinat, komunat kanë marrë përgjegjësi shtesë lidhur me menaxhimin dhe administrimin e mbeturinave, duke përfshirë obligime shtesë në lidhje me mbledhjen e tarifës së mbeturinave si dhe përzgjedhjen e modelit të operatorit në pajtim me ligjin. Përveç kësaj, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale përcakton menaxhimin e mbeturinave si kompetencë e plotë dhe ekskluzive e komunave. Bazuar në këto kompetenca, komunat kanë autorizimin ligjor për krijimin e strukturave, mekanizmave si dhe për parashikimin e një buxheti të ndarë për menaxhimin më të mirë dhe më efikas të sektorit të mbeturinave brënda territoreve të tyre administrative.

Pushteti lokal

Pushteti lokal, ose organi ekzekutiv në nivel lokal (Komuna), është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikës lokale për menaxhimin e mbeturinave, e cila duhet të jetë në harmoni me Strategjinë Kombëtare dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbeturinave. Konkretisht Komuna është përgjegjëse për:

- Hartimin dhe miratimin e planit Komunal për menaxhimin e mbeturinave;

- Përcaktimet e lokacioneve, bazuar tek plani hapësinor, sipas nevojave përkatëse për menaxhimin e mbeturinave komunale;
- Përcaktimin e tarifave për shërbimet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale;
- Caktimin dhe mbikqyrjen e zbatimit të standardeve të shërbimit për ndërmarrjet e kontraktuara për grumbullimin e mbetjeve.

Kompanitë rajonale/komunale të menaxhimit të mbeturinave

Në përgjithësi edhe pse dispozitat e Ligjit për Mbeturinat parashohin bazë ligjore për liberalizimin e sektorit të mbeturinave duke hapur tregun për operatorët privat në menaxhimin e mbeturinave, ende ky shërbim ofrohet prej ndërmarrjeve publike që operojnë dhe ofrojnë shërbime të menaxhimit të mbeturinave për komunat. Të themeluara si Ndërmarrje Publike në bazë të Ligjit për NP-të dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare, këto kompani kanë si aktivitet kryesor realizimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave dhe bartjen e mbeturinave të grumbulluara në deponitë sanitare. Konkretisht, në Kosovë janë të regjistruara dhe veprojnë 7 Kompani Regjionale për grumbullim të mbeturinave që mbulojnë rajone të caktuara administrative me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave.

Kompanitë e tilla janë të regjistruara dhe veprojnë si Shoqëri Aksionare, ku një komunë e caktuar ose një numër komunash i zotërojnë aksionet në këto kompani. Këto kompani janë kompani publike përgjegjëse për kryerjen e shërbimeve të grumbullimit, bartjen nga vendbanimet dhe deri tek deponitë e mbeturinave. Kompanitë regjionale publike e ofrojnë shërbimin për disa komuna në një rajon të caktuar dhe komunat që mundësohen me shërbim nga këto kompani kanë përfaqësuesin e tyre në bordin e kompanisë.

Roli dhe përgjegjësia e këtyre kompanive është po aq e rëndësishme bazuar në kuadrin ligjor për mbeturinat dhe detyrimet për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave, marrin parasysh që detyrimet brenda kompanive të Komunave si aksionarë të këtyre kompanive,

Kompanitë e tjera

Kompanitë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK). Këto kompani janë kompani shtetërore dhe janë përgjegjëse për menaxhimin e deponive regjionale të mbeturinave të komunave.

Në bazë të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK SH. A.), është kompani e licencuar për menaxhimin e deponive sanitare regjionale të mbeturinave Komunale në Republikën e Kosovës, e korporatizuar dhe e regjistruar si Shoqëri Aksionare konform Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare.

Kompanitë e licensuara, apo sektori privat, janë kompani të cilat licensohen nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe ofrojnë shërbimet për grumbullimin, trajtimin, riciklimin, transportimin dhe deponimin e llojeve të ndryshme të mbeturinave.

3. ASPEKTI INSTITUCIONAL

3.1 Organizimi në nivel qëndror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, si organi legjislativ i vendit, është përgjegjës për pjesën e miratimit të ligjeve, në këtë rast në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe në monitorimin e zbatimit të tyre nga komisionet ligjore të formuara. Më konkretisht ai është përgjegjës për: i) miratimin e ligjit për mjedisin, ligjit për mbeturinat dhe kuadrin ligjor relevant për fushën përkatëse; ii) nxjerrjen e strategjive për mbrojtjen e mjedisit; iii) dhënien e rekomandimeve dhe monitorimin e zbatimit të ligjeve nga komisionet e kuvendit.

Qeveria e Republikës së Kosovës, është organi përgjegjës për miratimin e Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave si dhe për nxjerrjen e udhëzimeve administrative qeveritare.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) është organi, i cili propozon, harton dhe mbikqyrë zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit pranë kësaj ministrie, është organi përgjegjës për aspektet e politikës kombëtare dhe kuadrin ligjor dhe rregullator për menaxhimin e mbeturinave. Konkretisht detyrat e këtij departamenti janë:

- Propozon, harton dhe siguron bazën për krijimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit;
- Harton dokumente Strategjike dhe legjislatonin për fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- Propozon masa dhe projekte për rehabilitimin e zonave të "nxehta";
- Përcakton dhe propozon investimet dhe financimin në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- Kryen aktivitete administrative dhe profesionale për anëtarësim në Konventa, Traktate, Marrëveshje dhe Organizata ndërkombëtare, për mbrojtjen e mjedisit;
- Ofron mbështetje profesionale, për çështjet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e burimeve natyrore;
- Shqyrton dhe përgatit propozim vendim për kërkesat e palëve, për çështje të ndryshme mjedisore;
- Përgatit raporte të ndryshme për çështje mjedisore.

Ky departament në strukturën e tij ka katër divizione në varësi të tij: i) Divizioni për Edukimin dhe Ndërgjegjësimin Mjedisor; ii) Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale; iii) Divizioni për Mbeturina dhe Kimikate; Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës. Divizioni i cili është drejtëpërdrejtë përgjegjës për sektorin e mbeturinave është Divizioni për Mbeturina dhe Kimikate.

Ky divizion ndër detyrat dhe përgjegjësitë më të rëndësishme ka:

- Hartimin e Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Plan Veprimin për Menaxhimin e Mbeturinave;
- Përgatitjen e programeve për monitorim dhe raportet për gjendjen ekzistuese të mbeturinave;
- Dhënien e licensave për menaxhimin e mbeturinave dhe dhënien e lejeve për eksport, import dhe tranzit të mbeturinave;
- Mbikqyrjen e zbatimit të kuadrit ligjor dhe menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme.

3.2 Organizimi i menaxhimit të mbeturinave në nivel komune

Bazuar në legjislacionin kombëtar, respektivisht LIGJI NR. 04 / L-060 Për Mbeturina, grumbullimi dhe trajtimi i mbeturinave dhe shërbimet e tjera të pastrimit i janë deleguar autoriteteve lokale, duke i bërë këto të fundit përgjegjëse për menaxhimin e tyre (Ligji nr. 03/L-040 "Për vetëqeverisjen lokale", 2008). Sipas Ligjit për Mbeturina, autoritetet kompetente për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë janë Ministria dhe Komunitet. Kompetencat e komunave në pajtim me Ligjin për Mbeturina përfshijnë:

- Krijimin e sistemit për menaxhimin e mbeturinave bazuar sipas parimit të hierarkisë për menaxhimin e mbeturinave për territorin e tyre, hartimin e planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave dhe krijimin e kushteve për zbatimin e tij;
- Përgjegjësi për Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave (PKMM) dhe zbatimin e tij;
- Hartimin e raportit vjetor për menaxhimin e mbeturinave;
- Rregullimin e përgjegjësisë dhe detyrimeve për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, zbatimin e tyre, organizimin dhe menaxhimin e mbeturinave në territorin e tyre;
- Mirëmbajtjen dhe përkujdesjen për sistemin e informimit të publikut dhe raportimit për kryerjen e punëve të përcaktuara me këtë ligj, si dhe aktet tjera ligjore për menaxhimin e mbeturinave;
- Zbatimin e procedurave të prokurimit, përzgjedhjen e personave të licencuar për mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe transportin e mbeturinave: inerte, komunale, komerciale, të vëllimshme, dhe mbeturinat nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore brënda territorit të tyre;
- Caktimin e tarifave dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve financiare për shërbimet komunale;
- Evidentimin e vendeve të ndotura në territorin e tyre, hartimin e projekteve për sanimin e tyre me shënime për lokacionin, karakteristikat hapësinore gjeometrike, lloji i ndotjes, sasia e mbeturinave, afatet për përmirësimin e gjendjes dhe shënime të tjera me rëndësi për realizimin e projekteve.

Përveç saj, në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, komunat do të kenë kompetenca të plota dhe ekskluzive për ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike, duke përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimet dhe kanalizimet atmosferike, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugët lokale, transportin lokal dhe skemat e ngrohjes lokale. Në pajtim me Ligjin për Mbeturinat dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, komunat nxjerrin akte nënligjore që rregullojnë

Referuar ndarjes administrative-territoriale çdo lloj shërbimi që komuna ofron në territorin që administron dhe komunitetit banues planifikohen dhe financohen nga kjo komunë. Paragrafi më poshtë ilustron strukturën e komunës në lidhje me organizimin e sektorit/departamentit për menaxhimin e mbeturinave: Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale, në të cilën banorët e saj realizojnë vetëqeverisjen në pajtim me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisjen lokale të Republikës së Kosovës . Organet komunale janë Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës.

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë i Komunës, i cili përbëhet prej anëtarëve të tij të zgjedhur nga qytetarët, në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale, i cili ushtron funksionet e pushtetit lokal të përcaktuar me Ligj dhe Statutin e Komunës.

Kuvendi i Komunës së Rahovecit përbëhet nga 30 (tridhjetë) anëtarë.

Kuvendi i Komunës miraton akte juridike brenda fushës së kompetencave të tij, të cilat nuk janë në kundërshtim me sistemin kushtetues dhe ligjor të Kosovës dhe vlejnë për territorin e Komunës së Rahovecit.

Kryetari i Komunës është udhëheqës i degës së Ekzekutivit të Komunës dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga banorët që kanë të drejtë vote në Komunë, në përputhje me Ligjin mbi zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës. Kryetari i Komunës zgjidhet për një mandat 4 (katër) vjeçar .

Lista e drejtorive Komunale -Komuna e Rahovecit me Statut ka këto drejtori:

1. Drejtoria e Administratës së përgjithshme
2. Drejtoria e Arsimit
3. Drejtoria për Buxhet dhe Financa
4. Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
5. Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
6. Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë
7. Drejtoria për Shërbime Publike Komunale
8. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
9. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
10. Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport
11. Drejtoria Inspektuese
12. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

Rolet dhe përgjegjësitë e organeve komunale në menaxhim të mbeturinave për komunën e Rahovecit janë të ndara sipas kompetencave dhe janë paraqitur si më poshtë:

- Komuna kontraktin operatorët (publik apo privat) për aktivitetet e Menaxhimit të Mbeturinave, duke u bazuar në ligjin përkatës.
- Drejtoria e Shërbime Publike dhe Infrastruktura është përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha punimeve në pronën publike dhe komunale, monitorimin e punëve të kompanive të angazhuara për mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve dhe hapësirave tjera komunale.
- DSHPI është përgjegjëse për caktimin e tarifave të shërbimeve të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale nga ndërmarrjet për administrimin e mbeturinave
- Drejtoria e Financave është përgjegjëse për propozimin e taksave, tarifave dhe ngarkesave tjera komunale si dhe inkasimin e tyre.
- Drejtoria e Planifikimit dhe Urbanizmit, është përgjegjëse për planifikimin e zhvillimit hapësinor dhe urbanistik të Komunës, ndihmon në përgatitjen e rregullores lokale për kontroll të mbeturinave dhe hedhurinave brenda territorit të Komunës.
- Drejtoria e Inspektionit, është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe aplikimin e ligjeve dhe akteve tjera ligjore në fushën e ndërtimit, tregut, sanitarisë, veterinarisë, bujqësisë, mbrojtjes së ambientit, trafikut urban-komunikacionit, hidroekonomisë, rrugëve etj.
- KRM "EKO Regjioni" NJP "Ambienti" dhe një pjesë kompania private e licencuar "Ekodrinia" ofrojnë shërbim sipas statutit të saj duke ushtruar kompetenca ekzekutive.

Në diagramin më poshtë ilustron struktura organizative në KRM "EKO Regjioni", si operator publik cili është përgjegjës për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave komunale në komunën e Rahovecit.




Figure 2.Struktura organizative e KRM"Ekoregjioni"

Ndër të tjerash, sipas legjislacionit në fuqi instruktohen komunat të hartojnë dhe miratojnë kuadrin e nevojshëm rregullator lokal për mbeturina. Kuadri lokal përfshin rregulloret e ndryshme që përcaktojnë proceset e menaxhimit të mbeturinave, përshkruajnë indikatorët, specifikojnë kriteret dhe instruktojnë strukturat lokale në përmbushjen e detyrave dhe funksioneve si dhe në zgjidhjen e problemeve që mund të dalin në vijim. Kuadri rregullator lokal duhet të përfshijë:

- Rregulloren komunale për menaxhimin e mbeturinave: është përgjegjësi e Komunës së Rahovecit të hartojë këtë rregullore e cila përcakton metodologjitë dhe rregullat për shërbimet e pastrimit të qytetit dhe menaxhimit të mbeturinave brënda territorit administrativ të komunë, të hartojë procedura për ankesat e banorëve, si dhe për aplikimin e sanksioneve. Rregullorja duhet të miratohet nga Këshilli Komunal.
- Rregulloren komunale për tarifat e mbeturinave: kjo rregullore ka për qëllim të krijojë një sistem efektiv për mbulimin e kostos së shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave. Rregullorja e tarifave të mbeturinave përfaqëson një politikë komunale afatgjatë për mbulimin e kostos, nivelin e tarifave dhe sistemin e mbledhjes së tyre dhe vendos rregulla specifike për autoritetet lokale si dhe për komEKO Regjionin lokal dhe biznesin.

Komuna e Rahovecit gjatë hartimit të PKMM do të synojë të përcaktojë qartë qëllimet dhe objektivat për menaxhimin e mbeturinave në komunë. Për të caktuar objektivat për PKMM 2021-2025 do të bëhet një studim i detajuar i gjendjes mjedisore dhe sektorit të menaxhimit të mbeturinave në nivel komunal, analiza e të cilave do të adresojnë zhvillimin e programeve sipas objektivave të përcaktuara, nxisin qëndrueshmërinë e sistemit primar të grumbulimit të mbeturinave dhe aplikimin e skemave për reduktim dhe ndarjen në burim për riciklim të tyre.

4. KONTEKSTI LOKAL, KORNIZA STRATEGJIKE DHE PROFILI I KOMUNËS

4.1 Përshkrim i përgjithshëm i komunës

Rahoveci është qytet dhe komunë në pjesën jug-perëndimore të Kosovës. Në veri kufizohet me Klinën, në lindje me Suharekën, në pjesën jugore gjendet komuna e Prizrenit, ndërsa në tërë pjesën perëndimore kufizohet me komunën e Gjakovës. Përafërsisht ka diku 276 km² dhe është vendbanim i 56,208 banorëve. Territori i komunës së Rahovecit përfshihet në regjionin e Prizrenit dhe ka një pozitë të mirë gjeografike. Shtrihet në pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik dhe i takon Evropës juglindore. Ky territor përfshin pjesën qendrore dhe jugore të rrafshit të Dukagjinit dhe është i ndarë në tri tërësi ose mikro regjione e këto janë: rrafshirë-luginore, kodrinore dhe malore. Territori i komunës shtrihet në

hemisferën veriore të Ekuadorit me shkallë 42° e 30' dhe 42° e 50' të gjërsise veriore gjeografike dhe ndërmjet 20° e 21' dhe 20° e 55' të gjatësisë lindore gjeografike. Vendbanimet në komunën e Rahovecit janë të koncentruara në lartësitë mbidetare prej 310 m. (Krusha e Madhe pjesa e re e vendbanimit pjesa lindore të bregut të lumit Drini i Bardhë) deri në 920 m. lartësi mbidetare që është i koncentruar vendbanimi i Zatriqit.

Për nga lartësia mbidetare këto vendbanime ndahen në luginore-rrafshirë, kodrinore dhe malore. Vendbanimet të cilat janë të përfshira në luginë ose rrafshirë janë këto : (310 – 350 m.) Xërxa, Fortesa, Gexha, Malësia e Vogël, Drinasi, Denji, Dabidoli, Çifllaku, Nagaci, Hoça e Vogël dhe Retia.

Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lartësitë mbidetare prej 350 – 600 m që i takojnë kategorisë së vendbanimeve kodrinore janë : Rahoveci, Drenoci, Senovci, Pastaselli, Palluzhë, Kramoviku, Mrasori, Hoça e Madhe, Apterushë, Zaçishti, Patoçani i Ulët, Patoçani i Epërm, Nashpalla, Bratotini, Vranjaka, Celina dhe Krusha e Madhe (edhe pse disa pjesë të reja të vendbanimeve të këtyre fshatrave u takojnë pjesës së kategorisë së luginave ose rrafshirave).



Figure 3.Harta e Pozitës gjeografike të komunës së Rahovecit sipas ndarjeve administrative

Tabela 1.Statistika mbi numrin e popullsisë për Komunën e Rahovecit

NJA	Nr. Popullsisë	Nr. Popullsi. Urbane	Nr. Popullsi. Rurale	Nr. Ek.familjare totale	Nr. Bisneseve	Nr. Institucione
Total	56,208	15,892	40,316	9,927	3000	73

* Në të gjitha të dhënat e marra dhe elaboruara në kuadër të planit do të përdoret numri i popullsisë i llogaritur nga Agjensia e Statistikave të Kosovës.

Në territorin e Komunës së Rahovecit ka rezerva të gurit dekorativ dhe minerale si krom, azbest, nikel, kobalt, bakër dhe qymyr guri (thëngjilli). Gurët dekorative gjenden në afërsi të fshatit Drenovc, në një largësi prej 5, 5 km nga qyteti i Rahovecit. Rezervat për këtë material ndërtimor dekorativ mendohet të jenë rreth 207.386 m³. Shtresat e lezolitit dekorativ janë sipërfaqësore të mbuluara me një shtresë humusi prej 0,5 m. Gurët gëlqerorë gjenden në Hudhrat e Danit, një vend në veri-perëndim të qytetit të Rahovecit 8 km la

rg tij. Ato shtrihen në formë blloqesh me trashësi që varion nga 0,3 në 2 metra, dhe janë 1,5 metra poshtë sipërfaqes së tokës. Gurët gëlqerore paraqiten në ato të kuq dhe të murrëm. Gëlqerorët e kuq paraqesin më shumë interes ekonomik. Rezerva e gurëve gëlqerore mendohet të ketë një volum prej 382.913 m³. Az bestit : Shtresat e lezolitit të azbestit janë të përqendruara në afërsi të fshatit Rudin/Pastasell në perëndim të Rahovecit, në një largësi prej 8 km. Sipas hulumtimeve është përcaktuar sipërfaqja e shtresës prej 100.000 m² dhe mendohet që rezerva të kapë shifrën prej 10.000.000 Ton. Kjo e dhënë është e përafërt dhe kërkon hulumtime të hollësishme gjeologjike. Kobalti, Nikeli dhe Bakri - Në rrethinën e Gurit të Kuq janë konstatuar shtresa e xeheroreve të Nikeli-Kobaltit. Përbërja mesatare e këtij xeherori sipas hulumtimeve të bëra vite më parë për mineralin në formë të ngurtë është (Nikeli 0,18 %, Kobalti 0,13 % dhe Bakri 2,73 %). Sasia e rezervave të këtij xeherori nuk dihet. Kromi: mendohet që ky mineral të gjindet përgjatë luginës së Drinit të Bardhë në një sipërfaqe rreth 60 km² dhe përkatësisht në lokalitetet Qëndresë, Gradisht, lugina e proit Rimnik, Delja, Shipi në Zadriq, Sharnica mbi Qëndresë, Drenovci, Guri i kuq, Kanzniku, etj. Thëngjilli: gjendet në lokalitetet e Hoçës së Madhe, Krushës, proit të Nagavcit, Drinasi, etj. Për të përcaktuar sasinë e rezervave dhe cilësitë kalorifike të thëngjillit duhen bërë hulumtime të thella gjeologjike.

Se fundi, sipas Komunës ekziston mundësia që të gjinden shtresa naftë mbajtëse në territorin e Komunës së Rahovecit. Vendodhja e tyre mendohet të jetë në fshatin Kramovik dhe përgjatë rrjedhjes së Drinit të Bardhë deri në Krushën e Madhe.

4.2 Relievi

Komuna e Rahovecit karakterizohet nga një plastikë dinamike, sepse lumenjtë malorë bashkë me përroje me energji të madhe kanë bërë erozionin duke formuar lugina relativisht të thella, të cilat ndajnë malet e zatriqit prej masiveve të tjera në forma të izoluar malore dhe kodrinore. Kuptohet, pamjes së tyre morfologjike të tanishme i ka paraprirë predispozicioni i lëvizjeve tektonike që ndodhën në kohën e terciarit kur mbi shtresat gëlqerore janë formuar shtresa të trasha të shkëmbinjve vullkanikë, të cilët, si rezultat i proceseve postvullkanike.

i. Hidrografia

Në komunën e Rahovecit rrjeti hidrografik është relativisht i dendur. Kjo paraqet pasurinë natyrore të komunës dhe një ndër kushtet për ekzistencën e botës bimore dhe aktiviteteve njerëzore. Rrjetin hidrografik të komunës së Rahovecit e përbëjnë disa qindra burime, puset, burime rrjedhëse dhe të qëndrueshme, si dhe projet. Burimet – janë format të rëndësishme hidrografike. Në territorin e komunës së Rahovecit ka disa qindra burime periodike dhe të përhershme. Numri i madh i burimeve janë ato burime që burojnë në luginat e prockave – projeve dhe rrëzë kodrinve. Më së shumti ka burime në luginën e Rimnikut, lumit të Hoçës, Apterushës etj. Rëndësi të madhe ekonomike kanë burimet të cilat shtrihen në shpatet e luginave dhe shtratit të lumit, pastaj burimet të cilat paraqiten në kodrat terciare të neogjenit. Hulumtimet tregojnë se më së shumti ka burime karstike periodike dhe të përhershme. Burimet e këtilla gjenden në jugperëndim, veri dhe veri-perëndim, në rrëzë të malit Shkozës, Zatriq dhe Kaznik. Shtrirja e vendbanimeve është kryesisht përgjatë ujrrjedhave si dhe burimeve ujore si: Rahoveci, Hoça e Madhe, Zaçishti, Apterusha, Zatriqi, Drenoci, Senoci, Pastasella, Kramaviku e tjerë.

Lumi Drini i Bardhë, edhe pse nuk buron në komunën e Rahovecit, të gjitha përroskat dhe lumenjtë derdhen në të. Nëpër komunën e Rahovecit, ky lum rrjedhë me një gjatësi prej 30 km dhe në pjesën më të madhe është edhe si kufi administrativ i komunave si: Prizrenit, Gjakovës, Malishevës dhe Klinës. Lumenjtë-përroskat të cilat derdhen në Drinin e Bardhë janë: lumi Ratkoc, Rimnik, Palluzhë, Hoçë etj. Për shkak të konfiguracionit të terrenit lugina e Drinit në komunën e Rahovecit është e gjerë rreth 2 deri 5 km. Ndërsa gjerësia mesatare e shtratit të lumit prej 50 deri 100 m, thellësia e shtratit të lumit është 1 deri 5 m.

Lumi Drini i Bardhë ka prerë masivin gëlqeror Gradishin, duke formuar Grykën (Kanjonin) epigjenike atraktive në gjatësi prej 450 m. Në kanjon është ndërtuar Ura e Fshenjtë e cila është e gjatë 70 metra dhe lartësia prej harkut deri te shtrati i ujit është 30 m. Lumi i Hoçës buron në fshatin Hoçë të Madhe, në lartësi mbidetare 420 m, dhe rrjedh nëpër fshatin Brestoc, por para fshatit Brestoc bashkohet me degën e Babindolit dhe disa burime, ndërsa dhe derdhet në Drinin e Bardhë.

Lumi Bellaja është dega e majtë e Drinit të Bardhë, me gjatësi 3 km, prej fshatit Fortesë deri te fshati Rogovë. Lumi Duhle buron në Rahovec dhe është i formuar nga tri burime (Duhlee, Vrellë dhe Sopot) dhe bashkohet me lumin e Rimnikut. Në harta topografike ky lum është i shënuar me emrin Gjegjoja që do të thotë për popullin e kësaj ane është i pa njohur. Lumi Rimnik buron në rrëzë të malit Gërgavicë dhe në rrjedhjen e saj i merr disa burime të tjera. Ky lum ka rëndësi të madhe ekonomike për këtë anë. Lumi Rimnik gjatë rrjedhjes së vetë bashkohet me rrjedhën Duhlllo dhe në fshatin Fortesë bashkohet me lumin e Sopniqit duke formuar kështu lumin Bellaja. Lumi Sopniq burimin e ka në rrëzë të malit të Drenocit dhe kalon nëpër fshatin Nushpal, Sopniq. Ky lum gjatë stinës së verës thahe dhe mund të quhet si lumi i Thatë. Duhet cekur se janë edhe disa lumenjprocka si: Ratkocit, Kramovikut, Palluzhës e tjera

ii. Bimësia

Në pjesën kodrinore dominojnë pyjet me mjaft lloje dhe janë të përziera. Prej drunjve dallohen pyjet gjetherënëse si: qarri (*quercus cerris*), dhe bungu me rreth 80 %, ahu (*fagus sylvatica*), shkoza (*carpinus orientalis*). Përhapje më të kufizuar kanë llojet tjera që paraqiten si të vetmuara si: brekia, bliri (*tilia kordata*), frashri, dëllinja etj. Janë prezente edhe tipet tjera që janë të ulëta, lloji i shkurreve, si: thana (*cornus mas*), murrizi (*crataegus monogyna*), kaça (*rosa canina*), manaferra e egër (*rubus fruticosus*), shtogu (*sambucus nigra*), kulumbria (*prunus spicosa*), lajthia (*corylus avellana*), në vise të larta fieri shqiponje (*pteridium aquilinum*) etj. Prej bimëve barishtore ka lloje të ndryshme, si ato që rriten në ambient të hapur pa prezencë të drunjtëve, si dhe ato që rriten brenda pyjeve. Këtu rriten edhe bimë të çajit që njihen si çaji i malit (*origanum vulgare*), kantarioni (*hypericum perforatum*), kamomili (*matricaria chamomila*), dredhëza (*fragaria vesca*) etj. Në territorin e kësaj komune ka fare pakë pyje gjethembajtëse. Hapësira e rrafshët e komunës është shumë pak e mbuluar me druj, ndërsa zakonisht rritet shëlgju (*salix alba*) në brigje të lumenjve. Bimë të ulëta ka mjaft si: lulëkuqja që rritet zakonisht në grunaja (*papaver rhoeas*), hithi (*urtia dioica*), formacionet e livadheve (tërfilli) dhe shkurre të rralla. Livadhe ka pakë në këtë komunë.

iii. Fauna

Fauna është me mjaft lloje që nuk janë karakteristike vetëm e këtyre hapësirave. Në pyje jetojnë ujku (*canis lupus*), dhelpri, lepuri (*lepus europaeus*), iriqi (*ernaceus europeus*) etj. jeton gjarpri i ujit (*natrix natrix*), gurit (*vipera ammodytes*), bollujca (*tropidonatus natrix*), kërmilli i vreshtës (*helix pomatia*), breshka e rëndomtë (*testudo bermanni*). Llojet e peshqve janë të shumtë. Në lumin Drini i Bardhë jetojnë 18, ndërsa llojet më kryesorët janë: trofta, mustaku, mlyshi, ngjala, krapa etj. Insekte ka shumë lloje si janë: fluturat, milingonat që bëjnë koloni dhe janë disa lloje, merimanga, kaçadreri (*lucanus cervus*) etj. Prej shpezëve jetojnë mjaft lloje si: trishtili kokëzi (*parus major*), zogu i malit, pëllumbi i egër (*columbia livia*), qukapikthi (*dryobates major*), laraska (*pica pica*) qyqja (*cuculus canorus*) etj. Shpezët grabitçare që jetojnë në këtë territor janë shqiponja e zezë (*aquilachyretos*), petriti (*malco tinnunculus*). Shpezët shtegtare që jetojnë janë dallëndyshja, lejleku etj. Sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve në dy sektorët është rreth 10800 ha, ku sektori privat ka rreth 1500ha dhe ai publik 9300 ha. Sipërfaqja e përgjithshme e komunës së Rahovecit është e mbuluar me pyje rreth 6065 ha, ndërsa 3205 ha janë sipërfaqe malore e zhveshur. Degradimet e pyjeve janë dukuri sikur në çdo pjesë të Kosovës, e sidomos prerjet ilegale, ku rreth 2200 ha në bazë të dhënave komunale rezultojnë si të degraduara. Pasuritë pyjore shtrihen në veri - perëndim të

komunës (Zatriq, Petkoviq, Kaznik etj.) Dallohen me formacione ahu (fagus sylvatica), qarri (quercus cerris), bungu, shkoza (carpinus orientalis), brekia, bliri (tilia kordata), frashri etj. Përhapje kanë edhe tipet tjera që janë të ulëta lloji i shkurreve si: thana (cornus mas), murrizi (crataegus monogyna), kaça (rosa canina), manaferra e egër (rubus fruticosus), shtogu (sambucus nigra), kulumbria (prunus spicosa), lajthia (corylus avellana), në vise të larta fieri shqiponje (pteridium aquilinum) etj.

4.3 Infrastruktura rrugore

Pozita gjeografike e komunës së Rahovecit në të cilën kalojnë rrugë të rëndësishme i mundësojnë komunikim të mirë dhe mjaft efikas, ku në nivel të komunës administrative të komunës janë të shtrira gjithsejtë 297.6 km rrugë të të gjitha kategorive. Nëse analizohet niveli i mbulshmërisë së sipërfaqes së komunës me rrugë të të gjitha kategorive del se ato janë të shtrira në gjithsejtë 157.1 ha. Komuna e Rahovecit karakterizohet me lidhje shumë të mira të komunikacionit rrugor të cilat ndihmojnë zhvillimin e transportit të udhëtareve dhe të mallrave. Shtrirja e rrugëve Regjionale kryesisht në pjesën qendrore dhe perëndimore të komunës ia ka shtuar rëndësinë kësaj hapësirë. Në komunën e Rahovecit ekziston niveli i katër kategorive të rrugëve (të klasifikuara në Kosovë), duke filluar prej rrugëve magjistrale e deri tek ato të pa kategorizuara. Rrjeta e rrugëve në komunën e Rahovecit përbehet nga:

- ✓ Rrugët magjistrale – M9.1 (Gjakovë - Prishtinë)
- ✓ Rrugë regjionale - (R107 Prizren-Gjakovë, R117 Rahovec-Suharekë, R111 Xerxë Ratkoc-Kramovik, R204 Rahovec- Krushë e Madhe, R110 Malishevë- Rahovec – Xerxë
- ✓ Rrugë lokale (rrugët të cilat i lidhin 34 komuna kadastrale me gjithsej 36 vendbanime, duke përfshirë edhe rrugët që lidhin lagjet më të rëndësishme të vendbanimeve)
- ✓ Rrugë të pa kategorizuara (të cilat lidhin lagjet e fshatit si dhe i lidhin të gjitha hapësirat në të cilat zhvillohen aktivitete socio-ekonomike).
- ✓


Tabela xx. Rrjeta e rrugëve në komunën e Rahovecit

	Pershkrimi	Gjatesia ne km	%
1	Rruge magjistrale	6.2	2.1
2	Rruge regjionale	64.3	21.6
3	Rruge urbane	30.6	10.3
4	Rruge lokale	114	38.3
5	Rruge e pakategorizuar	82.5	27.7
Total		297.6	100

Nga totali i përgjithshëm i rrugëve 297.6 km, sa janë në komunën e Rahovecit sipas gjatësisë, rrugë magjistrale janë 6.2 km (2.1%), rrugë regjionale 64.3 km (21.6%), rrugë lokale 114 km (38.3%), rrugë urbane 30.6 km (10.3%) dhe rrugë të pa kategorizuara janë gjithsej 82.5 km (27.7%). Duke iu referuar analizave të bëra në nivel të komunës, janë nxjerr edhe sipërfaqet e mbuluara me rrugë dhe aktivitete të tjera përcjellëse sipas kategorisë së tyre. Në tabelën në vijim do të paraqesim shtrirjen e rrugëve sipas gjatësisë në km dhe sipërfaqen e tyre në ha.

Numri i banorëve që lidhen me rrugët magjistrale e regjionale dhe kanë qasje direkt në to, është 56317/b, ose 78.7% e totalit të popullsisë së komunës d.m.th. se pjesa me e madhe e popullsisë kanë qasje në këto dy kategori të rrugëve. Kjo nga fakti se ato vendbanime që shtrihen përgjatë këtyre dy kategorive të rrugëve janë kryesisht vendbanime me numër më të madh të popullsisë në nivel komune. Nga tabela

mund të konstatojmë se rreth 78.7% e popullsisë së komunës së Rahovecit kanë qasje direkt në rrugët magjistrale dhe ato regjionale, çka do të thotë se komuna e Rahovecit ka një përparësi të veçantë në infrastrukturën rrugore.



Harta 1_Harta e infrastruktures teknike

LIDHJET HEKURUDHORE - Rrjeti hekurudhor në komunën e Rahovecit është i karakterit regjional dhe ka shtrirje në pjesën perëndimore të komunës së Rahovecit, përkatësisht i takon kategorisë së komunikacionit regjional i cili i lidhë Prizren- kalon në territorin e komunës së Rahovecit dhe e lidhë Klinen-Fushë Kosovë). Kjo linjë hekurudhore është një binarësh me gjatësi prej 10.4 km. Komunat kadastrale të cilat preken nga rrjeti hekurudhorë, përkatësisht kanë qasje direkt në këtë rrjet janë gjithsejtë 12, duke filluar nga (Mrasor, Kramovik, Çifllak, Dabidol,Dejnë, Ratkoc, Radostë, Gexhë, Xërxë, në komunën kadastrale të Bellacerkës,Celinë dhe Krushë e Madhe).

Nga tabela mund të konstatojmë se nga totali i përgjithshëm i popullsisë së komunës vetëm 23412 banorë apo 32.73% e popullsisë kanë qasje direkt në hekurudhë. Duke u nisur nga ky fakt mund të konstatojmë se rrjeti hekurudhorë i cili është mjaft i hershem në këtë komunë është edhe si indikator për zhvillimin e vendbanimeve më të rëndësishme të komunës. Rrjeti hekurudhor është i një rëndësie të veçantë, jo vetëm për komunën e Rahovecit por edhe tjerat sepse ndihmon në transportimin e mallrave dhe udhëtarëve. Linja hekurudhore për momentin nuk është në funksion dhe si rrjedhojë nuk ka qarkullim të udhëtarëve dhe mallrave përmes sajë.

4.4 Aspekti socio – ekonomik

PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIM TË AMBETURINAVE

Sipas të dhënave të Censurit të vitit 2011 popullsia rezidente e Komunës është 56.208 banorë, të shpërndarë në 34 vendbanime me një numër total të anëtarëve të familjeve rezidente prej 8221 ekonomi familjare.

Popullsia jeton në gjithsej 37 vendbanime, prej tyre 36 janë fshatra dhe vetë qyteti i Rahovecit. Këto vendbanime kanë dallime të theksuara sa i përket numrit të popullsisë. Në qytetin e Rahovecit jetojnë rreth 15892 banorë që do të thotë se rreth 29 % e popullsisë së tërësishme jeton në këtë qytet, ndërsa në të gjitha vendbanimet tjera jetojnë rreth 40316 banor apo rreth 71 %.

Në tabelën në vijim është paraqitur popullsia e Komunës së Rahovecit sipas regjistrimit të vitit 2011 (të dhënat nga ASK-ja)

Në tabelën më poshtë jepen të dhëna më të detajuara:

Tabela 2.Statistika për Komunën e Rahovecit

NJA	Nr. Popullsisë	Nr. Popullsi Urbane	Nr. Popullsi Rurale	Nr. Ek.familjare totale	Nr. Bisneseve	Nr. Institucione
Total	56,208	15,892	40,316	9,927	3000	73

Tabela 3.Shpërndarja e popullsisë sipas vendbanimeve

Nr	Vendbanimi	Nr. Banorëve	Nr	Vendbanimi	Nr. Banorëve
1	Rahovec	15892	19	Nushpal	220
2	Bellacerkë	2270	20	Opterushë	1911
3	Bërnjak	40	21	Pastasellë	1011
4	Bratotin	396	22	Pataqan I Eperm	533
5	Brestovac	1288	23	Pataqan I poshtem	1077
6	Celinë	1903	24	Petkoviq	731
7	Çifllak	1292	25	Polluzhë	808
8	Dobidol	799	26	Radostë	2346
9	Dejnë + Baboc	1757	27	Ratkoc	3791
10	Drenoc	1587	28	Retjë e Ulet	234
11	Gexhë	660	29	Retjë	771
12	Hoqe e Madhe	124	30	Sapniq	996
13	Hoqe e Vogel	1166	31	Sarosh	6
14	Kaznik	164	32	Senoc	687
15	Kramovik	1125	33	Vrajakë	838
16	Krushë e Madhe	4473	34	Xërxë	3184
17	Mrasor	191	35	Zatriq	535
18	Nagavc	743	36	Zocishtë	659
			TOTALI		56208

* të dhënat janë marre sipas databazës së ASK për numrin e popullsisë sipas vendbanimeve 2011

Pjesa më e madhe e vendbanimeve të komunës së Rahovecit kanë më tepër se 1000 banorë. Numër më të madh të popullsisë ka vet qyteti i Rahovecit (15892 b). Sa i përket vendbanimeve rurale, numër më të madh të banorëve kanë vendbanimet: Krushë e Madhe (4473 b), Ratkoc (3791 b), Xërxë (3184 b), Radost

(2346 b), Bellacërka (2270 b), Optrush (1911 b). Ndërsa vendbanimet që kanë numër më të vogël të popullsisë janë: Bërnjak (40 b), Kaznik (164 b), Mrasor (191 b), Nashpall (220 b).

Komuna e Rahovecit është komunë në zhvillim e sipër për sa l përket veprimtarisë urbaniztike dhe planit zhvillimor. Pjesëmarrja e veprimtarive prodhuese dhe shërbyese në krahasim me veprimtaritë tjera ekonomike është e konsiderueshme, duke treguar një pjesëmarrje më të madhe në biznesin privat.

Sipas statistikave, në vitin 2011 janë 3215 biznese të regjistruara në zyrën për regjistrim të bizneseve, ndër të cilat aktivitetet biznesor komercial ushtrojnë 2966 biznese në njësi territory kryesisht me fluks në zonën qendër urbane .




Figure 4.Harta shpërndarëse e opullsisë

i) Industria dhe Ekonomia

Spektori i industrisë në Komunën e Rahovecit, bazohet kryesisht në industrinë agro-industriale, përpunimin e rrushit dhe të grurit, industrinë e plastikës, ndërtimtarisë, teknologjinë përpunuese të metaleve, teknologjinë për ngrohje dhe ftohje, artizanate ,tregëti, shërbime etj. Pas luftës, ndërmarrjet e vogla kanë shfaqur tendencën për shfrytëzimin dhe përpunimin e gurit, rërës, zhavorit dhe argjilës, evidente me një shkatërim joselektiv të resurseve.

Duke e pasur parasysh nivelin e përgatitjes profesionale dhe shpirtin ndërmarrës, shumë individë kanë filluar me biznese individuale dhe familjare duke trasuar rrugën për një të ardhme dhe duke u bazur në ekonominë e tregut, si e vetmja perspektivë zhvillimore.

Rritja e bizneseve kërkon dhe qasje të re, si nga ana e themeluesve të tyre, sistemi bankar, institucionet të cilat duhet të merren më seriozisht lidhur me qasjen e përkrahjes, sidomos me infrastrukturë si dhe me

legjislacion, i cili do të jetë i favorshëm për investuesit potencial. Ruajtja e shpirtit ndërmarrës duhet të stimulohet dhe konsiderohet si vlerë për ekonominë kosovare. Për zhvillimin e ardhshëm, duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë ruajtjes dhe zgjerimit të këtij lloji të aktiviteteve ekonomike, të cilat kontribuojnë në zhvillimin ekonomik, si dhe në kualitetin e jetës urbane.

Në sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ekziston një asistencë e konsiderueshme e organizatave vendore dhe ndërkombëtare, të cilat janë përkushtuar për stabilizim dhe profesionalizim të ekonomisë. Organizatat ofrojnë asistencë për të zhvilluar prodhime të reja, si dhe tregun për to. Përkrahja gjithashtu vjen edhe nga institucionet gjegjëse të nivelit institucional me qëllim të krijimit të një mjedisi favorizues për zhvillimin ekonomik. Kjo i referohet, sikur është përmendur më parë, arsimimit profesional, çertifikimit të standardeve profesionale, standardeve për kualitet në menaxhim, prodhimtarisë, prodhimeve, etj.

Të gjitha këto aktivitete kontribuojnë në stabilizimin e NVM-ve si bazë e rëndësishme e ekonomisë së Kosovës, gjegjësisht qytetit të Prishtinës, duke sjellur sa më shumë prodhime kosovare në treg dhe duke ofruar mundësi të reja punësimi.

Gjendja ekonomike e bujqve është mjaft e rëndë. Përpos tregut të redukuar 15 , kemi të bëjmë me një import të pakontrolluar dhe joselektiv të produkteve bujqësorë gjë që i bjen prodhuesit tanë të pemeve dhe perimeve në pozitë mjaft të rëndë.

Edhe përkundër përmirësimeve të shënuara viteve të fundit dhe shenjave të ringjalljes ekonomike, komuna e Rahovecit ende nuk ka arritur t'i tejkalojë problemet e papunësisë dhe varfërisë. Papunësia është një ndër problemet me të cilën më së shumti po përballlet shoqëria kosovare. Shkalla e papunësisë në Kosovë është më e larta në rajon. Kjo shkallë e lartë e papunësisë është 44.4%. Vlerësohet se 1/3 e popullsisë së Kosovës është nën moshën 16 vjeç, ndërsa rreth 60% e popullsisë janë në moshë pune. Kjo shkallë e lartë e papunësisë prek më së shumti femrat ku ato në bazë të të dhënave statistikore të Ask 2011 numri I të punësuarve femra në Komunën e Rahovecit arrin diku rreth 11 % nga numri total I të punësuarve.

Ndërsa, pas grumbullimit të dhënave nga Qendra për Punë Sociale për numrin e popullsisë me asistencë sociale, familjeve dhe kryefamiljarëve nëna me asistencë sociale dhe analizave të bëra na paraqitet shkallë e lartë e varfërisë ekstreme. Këto të dhëna, na ndihmojnë sadopak në paraqitjen e gjendjes ekzistuese të popullsisë për secilin vendbanim të komunës.

Sipas të dhënave del se në komunën e Rahovecit ekzistojnë 2581 persona apo 590 familje që jetojnë me asistencë sociale, që nënkupton se kjo pjesë e popullsisë jeton në varfëri ekstreme. Ndërsa, varferia e përgjithshme përfshinë një përqindje më të madhe të popullsisë.




Figure 5. *Ekonomia- Industria shpërndarja*

ii) Banimi dhe zhvillimi Urbanistik:

Komuna e Rahovecit karakterizohet me vendbanime sipas shumëllojshmërisë pa ndonjë standart të caktuar urbanistik, ku sipas të dhënave ndërtimi ka marrë vull pas viteve 2000 dhe janë krijuar hapësira të reja me ndërtime banesore shumëkatëshe për arsye të rritjes së numrit të popullatës (shkalla e lartë e natalitetit, migrimi). Kjo kërkesë theksohet sidomos me shkatërrimet e bëra gjatë luftës.

Në komunën e Rahovecit janë identifikuar 10 vendbanime jo formale, një nga të cilat ndodhet në zonën urbane dhe 9 në zonat rurale. Në këto vendbanime jetojnë kryesisht banorë të komunitetit rom, ashkali, egjiptian dhe shqiptar. Karakterizohen me mungesë të infrastrukturës fizike dhe infrastrukturë sociale si dhe kanë ndikim negativ në mjedis.

Sipërfaqja e përgjithshme e Vendbanimeve jo formale në Komunën e Rahovecit është 12.2 ha. Në të gjitha këto vendbanime jetojnë gjithsej 1556, me 293 ekonomi familjare.

Vendbanimet jo formale gjenden në këto vendbanime: Një pjesë e qytetit të Rahovecit, dhe pjesë apo lagje të fshatrave Bellacërk, Xërxë, Gexhë, Radost, Ratkoc, Çifllak, Dabidol dhe dy pjesë të fshatit Drenoc.




Figure 6. Ndertime në zona të reja shtesë

iii) Bujqësia

Duke marrë parasysh kushtet e favorshme topografike⁸, klimatike dhe agro-ekologjike puna në bujqësi, vreshtari dhe verari përbën aktivitetin themelor ekonomik në Rahovec në të gjitha aspektet duke përfshirë prodhimin, burimin e të ardhurave dhe punësimin. Rreth 90% të tokës së komunës së Rahovecit përdoret si tokë punuese për bujqësi, e sidomos tokat kodrinore që përdoren si territore vreshtare. Toka e punueshme prej total cca 14000 Ha, është e mbuluar me sistem të ujitjes nga Drini i Bardhë në sipërfaqe prej 3500/Ha. Rreth 70% e popullsisë në qytet dhe fshat sigurojnë ekzistencën nga aktivitetet bujqësore si në vreshtari dhe perimtari, etj.

Tab. XX. Destinimi i sipërfaqes

Destinimi sipërfaqes	%
Pyje (5932 ha)	25.2
Kullosa (3921 ha)	14.2
Livadhe (252ha)	0.9
Degradim (403 ha)	1.5
Sip. bujqesore (12020 ha)	43.6
Vreshtat (2415 ha)	8.8
Zonat e ndertuara (1310 ha)	4.8

Lumi (193 ha)	0.7
Varrezat (104 ha)	0.4

Numri i ekonomive familjare apo fermave mendohet të jetë rreth 4815. Sasia e sipërfaqes së tokës bujqësore në pronësi të një ferme sillet prej 0.5 -2 Ha, ku kemi të bëjmë me parcelizimin e tokës, të disfavorshme për zhvillimin e një bujqësie intensive. Duke llogaritur që një familje ka mesatarisht 7 anëtarë, numri i përgjithshëm i banorëve që jetojnë vetëm nga të ardhurat nga puna në bujqësi (ekonomi për ekzistencë) rezulton të jetë rreth 33,700 banorë. Rrushi industrial blihet nga ndërmarrjet dhe minipodrumet në Rahovec përderisa rrushi i tryezës shitet në tregun e brendshëm në Kosovë si dhe jashtë saj si në Shqipëri, Mal të Zi dhe Serbi. Prodhimi i perimeve përdoret kryesisht për konsum shtëpiak dhe shitje në tregjet e Rahovecit, Prishtinës, Gjiçanit, Pejës, Mitrovicës dhe Prizrenit.

Prodhimtaria e rrushit dhe produkteve të tij ka traditë mijëvjeqare, Këto të dhëna vërtetojnë ekzistencën e kësaj prodhimtaria që në shekullin e parë të erës së re.

4.5 Gjendja e përgjithshme mjedisore

Gjendja e mjedisit në komunën e Rahovecit nuk është e mirë. Degradimi i tij është rezultat i ndërtimeve të pakontrolluara në zonat e mbrojtura të natyrës ashtu edhe jashtë tyre, infrastrukturës jo adekuate, shtimit të numrit të automjeteve dhe importimit të mjeteve motorike të vjetruara në Kosovë, importi i vajrave dhe derivateve të kualitetit të dobët (me sasi të lart të sulfurit), deponimi i joadekuat i tyre, ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, prerjes së pakontrolluar të pyjeve, akumulimit të plehrave urbane si pasojë e mos menaxhimit të mirë, mungesës së riciklimit dhe trajtimit të ujërave të zeza. Probleme të theksura janë edhe/

- Degradim i shtretërve të lumenjve
- Shfrytëzimi i pa kontrolluar i inerteve,
- Deponitë joformale të mbeturinave,
- Shkarkimi i ujërave të zeza të patrajtuara,
- Ngrohja individuale me thengjill dhe dru e objekteve, në mungesë të ngrohjes qendrore në pjesën urbane,
- Mbrojtja jo e mirë nga vërshimet dhe erozioni
- Ndërrim destinimi i tokave bujqësore në ato ndërtimore
- Shtrirja e vendbanimeve përgjat lumenjeve

Infrastruktura e ndërtuar për mbrojtje -nga rreziqet hidrometeorologjike në vitet e fundit në territorin e komunës nuk funksionojnë. Paralufte ky sistem ka funksionuar për mbrojtje nga breshëri sidomos në dy pika, ku efekti i mbrojtjes ka qenë evident. Kjo mbrojtje ka qenë kryesisht për mbrojtje nga breshëri. Mirëpo, infrastruktura e ndërtuar për mbrojtje nga vërshime nuk ka. E që për të ardhmen duhet menduar.

Problemet serioze mjedisore lidhen me shfrytëzimin joracional të burimeve natyrore të cilat pastaj shkaktojnë ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, prishin pejsazhin, kërcënojnë biodiversitetin dhe burimet natyrore.

Burim kryesor në ndotjen e ujërave sipërfaqesore dhe nëntokësore në Komunën e Rahovecit vazhdon të vijë prej mungesës së sistemit të kanalizimit për ujërat e ndotura (të zeza) në pjesën rurale të territorit komunal. Kryesisht në pjesën rurale mungon sistemi i kanalizimit dhe kullimit. Deponimi i mbeturinave industriale në afersi të lumenjve e rëndon këtë gjendje edhe më tepër në cilësinë e ujrave që gjinden në komunë.

Referuar raporteve të mëhershme lidhur me gjendjen e mjedisit në komunë, progress i konsiderueshëm që është bërë nga komuna e Rahovecit në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, si rrjedhojë e së cilës komuna ka shtrirë shërbimin e grumbullimit në nivel territorial duke shërbyer të gjitha ekonomitë familjare, bizneset dhe institucionet si dhe duke eliminuar shumicën e deponive ilegale me mbetje kryesisht të amvisërive apo të përziera. Përkundër aktiviteteve të komunës, verifikohen prezencë të deponive ilegale me përbërje të llojeve të mbeturinave kryesisht të ndërtimit dhe demolimit, apo të përziera, problematikë kjo që duhet të adresohet për zgjidhje prej komunës së Rahovecit në planifikimin dhe përcaktimin e hapësirave për trajtimin e këtyre llojeve të deponive. Deponitë ilegale të mbeturinave paraqesin rrezik permanent për banorët e Komunës, ku përmes përmes zbërthimit të materieve emetojnë lëndë toksike të dëmshme për shëndetin e njeriut duke u shpërndarë edhe në ujërat nëntokësore si pasojë e përzierjes me rreshjet e shiut (prezencë e materialit asbest tek mbetjet që derivojnë prej prishjeve të ndërtimit).

- Njeherësh është e domosdoshme zhvillimi i planeve dhe praktikave që favorizojnë menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave duke stimuluar zhvillimin e programeve të ndarjes në burim të mbeturinave të riciklueshme apo atyre organike, programe këto që duhet të fillojnë që nga mbledhja e ndarë e mbeturinave nga ekonomitë shtëpiake. Gjithashtu, në plane të saj komuna duhet të ndërrojë plane konkrete për trajtimin e mbeturinave, referuar edhe ndërtimit të qendrës për Riciklim në territorin e saj komunal. Aktualisht, sasia e mbeturinave të mbledhura në komplet territorin komunal (ton/javë dhe ton/vit) 91.65 t/javë , 4766 t/vit. rreth 0.62 kg/ditë banorë mbeturinë urbane dhe suburban, 0.5 kg/ditë banorë rurale dhe 0.4 kg/ditë banorë rurale e thellë.

5. KONTEKSTI LOKAL I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE

5.1 Situata aktuale e shërbimi të grumbullimit të mbeturinave në komunë

Aktualisht shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në komunën e Rahovecit ofrohet në tërë territorin e komunës do të thotë 100%. Operatorët e autorizuar nga komuna e Rahovecit respektivisht nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë janë Ndermarrja Publike "Ekoregjioni" me njesinë e saj "Ambienti" mbulon territorin e Rahovecit. Pjesëmarrja e komunës së Rahovecit në këtë ndërmarrje është 8%, ndërsa përveç "Ekoregjionit" në Rahovec operon edhe kompania private "Ekodrinia" e cila po ashtu mbulon një pjesë të territorit të komunës. KRM "EKO Regjioni" ofron shërbimin për 56208 banorë bazuar në të dhëna të ofruara nga komuna. Kjo kompani kryen faturimin dhe inkasimin e të hyrave nga tarifat e pastrimit nga bizneset dhe institucionet publike ndërkohë që inkasimi për ekonomi familjare kryhet prej anës së Komunës së Rahovecit. Sipas raportit të AMMK në vitin 2018 janë arketuar 91.11% kurse vitin 2019 96.35% të mjeteve. Komuna e Rahovecit ka kontratë të

rregullt sipas legjislacionit përkatës që e lejon dhe realizon pagesën e rregullt për shërbim tek KRM "EKO Regjioni" sipas vlerës vjetore **134,0000** Euro në vit.

Nga të dhënat e mundësuar nga kompania publike dhe komuna, për vitin 2020 nga komuna, shërbimi kryhet për 39,772 banorë në 3072 ekonomi familjare në zonë urbane dhe 6064 ekonomi familjare në zonë rurale, në numër total 9136 ekonomi familjare duke i përfshirë të dyja kategoritë e amvisërive. Gjithashtu shërbimi i grumbullimit të mbeturinave kryhet në të gjitha bizneset aktive dhe institucionet në tërësi territoriale ku ngarkesa e faturimit aplikohet prej KRM "EKO Regjioni".

Tabela 4. Numri i klienteve në faturim (referuar të dhënave të ASK dhe të paraqitura nga KRM "EKO Regjioni")

Komuna	Klientë gjithsej në zonën kadastrale				Klientë të faturuar = shërbyer				
Qyteti/Fshat	Ekonomi familjare ASK	Biznese	Institucione	Totali konsumatorë	Ek.fam Resident	Ek fam Joresid end	Biznes e.	Institucione	Totali në shërbim
Rahovec	3072	2000	195	16,577	11 676	2817	2000	195	16 695

Kompania e cila është e licencuar për administrimin e mbeturinave dhe punon në bazë të rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Rahovecit, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina e miratuar nga Kuvendi i Komunës. Si kompani Regionale publike punon sipas Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregëtare.

Aspektet operationale të **menaxhimit të mbeturinave në Rahovec udhëheqen nga KRM "EKORegjioni" njesia "Ambienti"**. Për të cilën aksionare kryesore me 61.8% është vetë Komuna. KRM "EKORegjioni" është kompani rajonale publike, e cila operon me vetëfinancim. Kompania shërben tri kategori të konsumatorëve, respektivisht konsumatorët e ekonomive familjare, bizneset dhe institucionet. Po ashtu kompania ofron shërbim në grumbullim të mbeturinave derë më derë dhe vetë-inkason mjetet për shërbimin e ofruar vetëm tek bizneset dhe institucionet aktive të regjistruara sipas tarifave të përcaktuara nga komuna e Rahovecit.

KRM "EKO Regjioni" me njesinë **"Ambienti"** dhe së bashku me kompaninë private **"Ekodrinia"** i dergojnë **mbeurinat ne Deponine Rajonale ne Landovice te Prizrenit me nje tarif prej 5.74 € / ton.**

Gjithashtu, kjo kompani shërbimin e saj e zhvillon duke u bazuar në Dy aktivitetet: primar (grumbullimi dhe depozitimi i mbeturinave) dhe sekondar (me kontrata të veçanta si larje fshirje, mirëmbajtje hapësirash të gjelbra etj).

Kompania nuk e bën grumbullimin e mbeturinave të ngurta ndërtimore si dhe mbeturinat të hekurit, ndersa mbetjet shtazore grumbullohen me kërkesë nga Komuna dhe me procedurë dhe kontrata të veçanta dhe gjatë groposjes ato dezinfektohen përmes gëlqerosjes.

Aktivitetet e saj, kompania i realizon përmes departamenteve operative dhe shërbimit për konsumatorë, të cilat përbëjnë tërësinë e ndërmarrjes.

Lidhur me krahasimin e të dhënave dhe raporteve mbulueshmëria e territorit të Komunës së Rahovecit me ofrimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave është 100%. Edhe perkunder mbulueshmerise totale me sherbime prap ka banore ose familje qe nuk marrin keto sherbim. Arsyet kryesore per grumbullimin jo te plote te mbeturinave lidhen me nivelin e ulet te vetedijes qytetare, kapacitete te kufizuara te Ndermarrjes Publike, pagesa e ulet e sherbimeve etj. M kete rast krijhen edhe shume deponi ilegale nga persona te papergjegjshem. Nese i referohemi raporteve të deponive ilegale sipas krahasimit të viteve referente 2019 dhe 2018, sipas këtij raporti janë gjetur 20 deponi ilegale ne komunën e Rahovecit.

Tabela 5. Numri i deponive sipas raportit të fundit i AMMK 2020 për vlerësimin e vitit kalendarik 2019

Madhësia – Sasia e deponisë		Deponitë ilegale	
		Sasia #	Përqindja
E vogël	1-5 200l qese mbeturinash / karroca dore,	11	55%
E mesme	5-20 200l qese mbeturinash / karroca dore,	6	30%
E madhe	> 20 karroca dore, dmth kamion i nevojshëm.	3	15%
Totali		20	100%
Karakteristikat e deponive		Sasia në numër	Sasia në përqindje
Mbeturina të amvisërisë (A)		6	30%
Mbeturina inerte / ndërtimore (N)		4	20%
Mbeturina industriale dhe të rrezikshme (R)		-	-
Mbeturina të vëllimshme (V)		-	-
Mbeturina të përziera (A, N, R, V)		10	50%
Totali:		20	100.00 %

Referuar karakteristikave të deponive ilegale sipas llojit të mbeturinave që gjenden në to, sipas raporteve prej kësaj komune vlerësohen se:

- 6 janë deponi me Mbeturina të amvisërisë (A)
- 4 janë deponi me Mbeturina inerte / ndërtimore (N)
- 10 me përbërje të Mbeturinave të përziera (A, N, R, V).




Fig 5: Harta e llojeve dhe përbërjes së mbeturinave sipas prezencës së deponive ilegale, Komuna e Rahovecit (verifikimi 2020)

5.2 Mbuleshmëria me shërbimin e menaxhimit të mbeturinave

Shërbimi i grumbullimit, transportit dhe trajtimit të mbeturinave realizohet nga Ndermarrja Publike "Ekoregjioni" me njësinë e saj "Ambienti" dhe kompania private "Ekodrinia".

Komuna raporton se në territorin e saj gjenerohen rreth 4,766.00 ton mbeturina në vit (2019) ose një mesatare prej rreth 91.65ton/javë që vjen si rezultat i llogaritjes nga prodhimi i gjenerimit mesatar (referuar të dhënave të ofruara nga komuna,DSHP). Shtrirja zonale e amvisërive dhe bizneseve, institucioneve (klientet), të cilët janë të përfshirë në shërbimin e menaxhimit të mbeturinave sipas kompanisë "Ekoregjioni" dhe "Ekodrinia" janë:

- Zona Urbane: e cila i takon vetëm Rahovecit si qytezë – 3072 klient
- Zona Rurale: zonat e mbetura të rrethinës – 6064 klient.

Sipas të dhënave, niveli i ofrimit të shërbimit konsiston në 69,9% vitin 018 dhe 70,8% ve vitin 2019 të territorit ku kompania publike ofron shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në 53.43 % të numrit të klientëve dhe ajo private në pjesën e mbetur.

Kapaciteti i gjenerimit sipas koeficientit të gjenerimit të mbeturinave për kokë banori, referuar raportit të ASK për menaxhim të mbeturinave gjatë vitit 2019 janë prodhuar 203,49 kg/vit ose 0,56kg/dite do të nënkuptojnë si vijon:

- Urbane dhe suburbane 0.62 kg/ditë banorë

- Rurale 0.5 kg/ditë banorë
- Rurale e thellë 0.4 kg/ditë banorë

Referuar tabelës së mësipërme sipas shpërndarjes së popullsisë, kapaciteti i gjenerimit të mbeturinave për Komunën e Rahovecit do të nënkuptojë që në nivel të zonës urbane gjenerohen rreth 3 596 ton mbeturinë në vit dhe në zonë rurale rreth 6 622 tonë mbeturinë në vit; total ky, i cili do të përkojë me kapacitetin e gjenerimit të mbeturinave për Komunën e Rahovecit në 10 218 tonë/ mbeturinë në vit.

Kompania shërben tri kategori të konsumatorëve respektivisht konsumatorët shtëpiak, bizneset dhe institucionet. Konsumatorët shtëpiak ndahen sipas mënyrës se si e pranojnë shërbimin, në konsumatorë shtëpiak të cilët pranojnë shërbimin derë më derë dhe konsumatorë të pajisur me kontejnerë. Bizneset ndahen në biznese të vogla dhe të mesme të cilat pranojnë shërbimin pa kontrata dhe bizneset të mëdha me kontrata të veçanta të shërbimit. Bizneset e vogla dhe të mesme një pjesë e tyre shërbehet me shërbimin derë më derë dhe pjesa tjetër është e pajisur me kontejnerë të veçantë. Bizneset me kontrata janë të pajisura me kontejnerë të veçantë. Institucionet janë kategori e tretë e konsumatorëve dhe hiq ndonjë zyre të vogël të OJQs, avokatie apo të ngjashme zakonisht janë me kontrata të veçantë dhe të shërbyer me kontejnerë të veçantë.

Periodha kohore e grumbullimit të mbeturinave zakonisht zhvillohet nga ora 07:00 – 14:00.

Për procedurën dhe metodologjinë e caktimit të tarifave, kompania ka aplikuar tarifat që kanë qenë sipas modelit të ZRRUM-it (2006), të ndryshuara dhe aprovuara nga Bordi i Drejtorëve në Qershor të vitit 2012, të cilat ende janë në fuqi. Mekanizmi i inkasimit për momentin në amvisëri dhe biznese të vogla bëhet përmes Inkasantëve dhe arkës ndihmëse, por ka raste që bëhet edhe nëpërmjet llogarisë rrjedhëse nga konsumatori. Kurse tek bizneset e mëdha dhe institucionet, inkasimi bëhet përmes arkës dhe llogarive rrjedhëse.

Referuar situatës së mëhershme mjedisore në komunë në disa zona periferike të qytetit dhe zona rurale ekzistojnë deponi ilegale të reja apo të vjetra. Por, edhe përkundër përpjekjeve të komunës në disa zona periferike të qytetit dhe zona rurale ekzistojnë deponi ilegale ku sipas vlerësimeve (raporti i fundit i AMMK 2020 për vlerësimin e vitit kalendarik 2019) rreth 20 deponi të ndara në 11 deponi të vogla, 6 të mesme dhe 3 të mëdha gjenden në territorin e komunës.

Për qëllime të organizimit të menaxhimit të mbeturinave është krijuar sistemi i zonimit të territorit.

Zonimi i territorit është bazuar në kriteret :

- Shpërndarja proporcionale e zonave të drejtimeve dhe linjave të operimit të menaxhimit të mbeturinave
- Shpërndarja në bazë të numrit të banorëve
- Shpërndarja në bazë të numrit të amvisërive
- Shpërndarja në bazë të numrit të objekteve

Zona e synuar për Planin Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave është e gjithë zona administrative e Komunës së Rahovecit. Zona që synohet të arrihet me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave në kuadër të Planit Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave janë disa familje të fshatrave të zonës së 2 (ngjyra e hapur) ku synohet të futen në sistem edhe 533 ekonomi familjare shtesë ku deri tash në një mënyrë apo tjetër nuk kanë qenë pjesë e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, detajet

PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

e fshatrave dhe gjenerimit të mbeturinave mund të shihen në tabelën e mëposhtme së bashku me synimin për mbulueshmëri gjatë implementimit të këtij plani :




Figure 7 Ndarja e territorit në zona të shërbimit- Komuna Rahovec

Shërbimi realizohet në ditë të caktuara sipas planit operativ të kompanisë dhe ofrohet përmes shërbimit në kontenerë të përbashkët kryesisht në zonën urbane dhe derë më derë në zonat rurale dhe në amvisëri në banim individual në shtëpi private në zonën urbane (ZONA 1).

Kategoritë /Zonimi	Zona 1	Zona 2	Total
Numri i Lokalitetit	14	22	36
Mesatarja ne km	7.90	15.64	24
Sipërfaqja në km ²	144	132	276
Numri i ekonomive lokale	6282	2394	8676
Nr. e ekon. fam. /ofrohen sher. MM	6282	1861	8143
Shkalla e mbulimit me sherb. MM	100%	77.7%	93.9%
Numri i Popullates	34658	21550	56208
Numri i popullates ne %	61.7%	38.3%	100%
Gjen. mbetu. në vit	7099	3512	10611

PLANI KOMUNAL PER MENAXHIM TE MBETURINAVE

Gjen. mbetu. në vit në %	66.9%	33.1%	100%
--------------------------	-------	-------	------

Kategoria	Popullata	%	Sip. km ²	%	Mbeturinat	%
Urbane	15892	28.3%	49	17.8%	3596	33.9%
Para Urbane	4205	7.5%	39	14.0%	952	9.0%
Rurale	21670	38.6%	102	37.0%	3955	37.3%
Rurale e Thellë	14441	25.7%	86	31.2%	2108	19.9%
Totali	56208	100%	276	100%	10611	100%

Tabela 6- Tabelat përmbledhëse e veçorive te zonës –KK Rahovec

Zona	Nr. lokali	Mesa, km	Sip. km ²	Nr. ban. Pam.	Nr. i popullatës	Gjen. i mbet. në vit
Urbane	14	7.90	144	6282	34658	7099
Para Urbane	22	15.64	132	2394	21550	3512
Totali	36		276	8676	56208	10611

**Zonat e përcaktuara për Menaxhimin e Mbeturinave –KK
Rahovec**

Zona 1	Zona 2	Total
Nr.Lokalitetet 14 38.9%	Nr.Lokalitetet 22 61.1%	Nr.Lokalitetet 36 100.0%
Popullata 34,658 61.7%	Popullata 21,550 38.3%	Popullata 56,208 100.0%
Sipërfaqja km² 144 52.2%	Sipërfaqja km² 132 47.8%	Sipërfaqja km² 276 100.0%
Ekon.Familjare 6,282 72.4%	Ekon.Familjare 2,394 27.6%	Ekon.Familjare 8,676 100.0%
Ofrohen sher.MM- Ekon.Familjare 6,282 77.1%	Ofrohen sher.MM- Ekon.Familjare 1,861 22.9%	Ofrohen sher.MM- Ekon.Familjare 8,143 100.0%
Mbulimit me Sher.MM 100.0%	Mbulimit me Sher.MM 77.7%	Mbulimit me Sher.MM 93.9%

Tabela 7- Zonat përcaktuar e MM e bazuar ne km²

Kategoria	Zona 1	Zona 2	Total	Ne %
Urbane	49	-	49	17.8%
Para Urbane	31	8	39	14.0%
Rurale	55	47	102	37.0%
Rurale e Thell	10	76	86	31.2%
Total	144	132	276	100.0%
Ne %	52.2%	47.8%	100.0%	

Tabela 8- Zonat përcaktuar e MM e bazuar gjenerimin e përlogaritur te mbeturinave

Kategoria	Zona 1	Zona 2	Total	Ne %
Urbane	3,596	-	3,596	33.9%
Para Urbane	592	359	952	9.0%
Rurale	2,764	1,191	3,955	37.3%
Rurale e Thell	147	1,962	2,108	19.9%
Total	7,099	3,512	10,611	100.0%
Ne %	66.9%	33.1%	100.0%	

Tabela 9- Shpërndarja e ekonomive familjare e bazuar ne zonat e përcaktuara dhe kompanitë ofruese te shërbimeve

Operatori	Zona 1	Zona 2	Total	Ne %
Ekodrinia	540	1,861	2,401	29.5%

PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

NJP "Ambienti	5,742	-	5,742	70.5%
Total	6,282	1,861	8,143	100.0%

Zona 1- e bazuar ne kriteret e përcaktuara te zoonimit

Nr.	Zona	Rurale-Urban	Zona	Distanca KM	Rangu km.	Nr. Banorëve	Nr. fonde familjare të Komuna	Gjenerimi MM
1	Rahovec	Urbane	Zona 1	1.0	0-3	15,892	3,072	3,596
2	Krushë e Madhe	Rurale	Zona 1	10.0	9-12	4,473	779	816
3	Xërxë	Rurale	Zona 1	9.3	9-12	3,184	288	581
4	Bellacrkë	Rurale	Zona 1	7.0	6-9	2,270	252	414
5	Opterushë	Rurale	Zona 1	8.1	6-9	1,911	332	349
6	Celinë	Rurale	Zona 1	11.8	9-12	1,903	357	347
7	Brestovc	Para Urbane	Zona 1	4.3	3-6	1,288	265	291
8	Hoçë e Vogël	Para Urbane	Zona 1	5.5	3-6	1,166	224	264
9	Retijë	Rurale e Thell	Zona 1	12.9	12-40	771	124	113
10	Nagavc	Rurale	Zona 1	7.5	6-9	743	158	136
11	Zoçishtë	Rurale	Zona 1	7.1	6-9	659	165	120
12	Reti e Ulët	Rurale e Thell	Zona 1	16.4	12-40	234	124	34
13	Hoçë e Madhe	Para Urbane	Zona 1	4.8	3-6	124	60	28
14	Bërnjak	Para Urbane	Zona 1	4.9	3-6	40	-	9
Total						34,658	6,200	7,099

Zona 2- e bazuar ne kriteret e përcaktuara te zoonimit

Tabela 10- Zona 2- e bazuar ne kriteret e përcaktuara te zoonimit

Nr	Zona	Rurale-Urban	Zona	Distanca KM	Rangu km.	Nr. Banorëve	Numi fekon. familjare të Komuna	Gjenerimi MM
1	Drenoc	Para Urbane	Zona 2	5.7	3-6	1,587	161	359
2	Pataçan i Ulët	Rurale	Zona 2	11.0	9-12	1,077	103	197
3	Pastasellë	Rurale	Zona 2	9.2	9-12	1,011	83	185
4	Sapniq	Rurale	Zona 2	9.7	9-12	996	90	182
5	Polluzhë	Rurale	Zona 2	11.2	9-12	808	162	147
6	Senoc	Rurale	Zona 2	7.2	6-9	687	101	125
7	Gexhë	Rurale	Zona 2	11.6	9-12	660	165	120
8	Zatriq	Rurale	Zona 2	10.3	9-12	535	42	98
9	Pataçan i Epërm	Rurale	Zona 2	6.2	6-9	533	52	97
10	Nushpal	Rurale	Zona 2	7.0	6-9	220	32	40
11	Ratkoc	Rurale e Thell	Zona 2	17.0	12-40	3,791	380	553
12	Radostë	Rurale e Thell	Zona 2	12.3	12-40	2,346	206	343
13	Dejnë + Baboc	Rurale e Thell	Zona 2	19.0	12-40	1,757	116	257
14	Çifllak	Rurale e Thell	Zona 2	23.0	12-40	1,292	104	189
15	Kramovik	Rurale e Thell	Zona 2	25.5	12-40	1,125	93	164
16	Vrajakë	Rurale e Thell	Zona 2	20.0	12-40	838	72	122
17	Dabidol	Rurale e Thell	Zona 2	20.9	12-40	799	138	117
18	Petkoviq	Rurale e Thell	Zona 2	28.3	12-40	731	183	107
19	Bratotin	Rurale e Thell	Zona 2	20.7	12-40	396	58	58

PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

20	Mrasor	Rurale e Thell	Zona 2	32.0	12-40	191	28	28
21	Kaznik	Rurale e Thell	Zona 2	13.0	12-40	164	24	24
22	Sarosh	Rurale e Thell	Zona 2	23.3	12-40	6	2	1
Total				15.6		21,550	2,394	3,512

5.3 Forma e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave

Shërbimi i mbledhjes dhe grumbullimit të mbeturinave konsiston në mbledhjen e mbeturinave urbane të depozituara nga qytetarët, bizneset dhe institucionet brenda kontenerëve publikë dhe atyre individuale si dhe rreth tyre, dezinfektimi i kontenerëve dhe vendit përreth, transportimi i mbeturinave urbane me makinën teknologjike deri në pikën përfundimtare të depozitimit, në deponinë rajonale te Prizrenit e cila gjendet në distancë rreth 27 km prej qendrës së qytetit të Rahovecit.

Ky shërbim që ofrohet gjatë gjithë vitit (7 ditë në javë për grumbullimin e mbeturinave dhe 1 herë në muaj për dezinfektimin e kontenerëve publikë) përfshin gjithë zonën e administrimit komunal (100%).

Sistemi aktual i pikave të grumbullimit mbeturinave (PGM) përbëhet nga kontenerë metalik apo plastikë me rrota me volum 1.1m³, të pozicionuar në anë të rrugëve në 66 pika të përbashkëta publike të miratuara paraprakisht nga autoritet komunale sipas planit për riorganizimin e zonës qendër në komunën e Rahovecit. Largësitë mesatare midis PGM variojnë sipas dendësisë së popullsisë me frekuencë 100-150 m distancë, në zonën e qendrës ku është e përqendruar pjesa më e madhe e bizneseve, institucioneve dhe banorëve si dhe zonat e tjera të qytetit të Rahovecit, në 200-400m.

Njëkohësisht ekzistojnë dhe lokacione të përbashkëta individuale/kolektive ku kontenerët janë të pozicionuar brenda territoreve të institucioneve apo subjekteve private si dhe disa pika të lokacioneve me përbërje të kontenerëve nëntokësorë dhe që janë jashtë shërbimi ku pranë tyre janë pozicionuar kontenerë 1.1 shtesë.

Gjendja aktuale PGM paraqitet e mirë, megjithëse ekziston një seri problemesh si përsa i përket dëmtimeve të kontenerëve dhe higjenës si pasojë e sjelljes qytetare. Në zonën urbane ky shërbim kryhet në nivel të kënaqshëm dhe vërehet që PGM janë të pastra dhe desinfektuara pothuajse rregullisht nga ndërmarrrja e pastrimit.

KRM "EKO Regjioni" dhe "EKODRINIA" ofrojnë shërbimin e grumbullimit të mbeturinave për ekonomitë familjare (amvisëritë) dhe për institucionet e bizneset e komunës. Konkretisht kompania zhvillon këtë sistem të grumbullimit të mbetjeve sipas kategorizimeve:

Grumbullimi i mbeturinave në ekonomitë familjare (amvisëritë) duke përdorur dy sisteme për grumbullimin e mbeturinave:

- **Sistemi derë më derë, i cili aplikohet në amvisëritë me banim individual, ku mbeturinat hidhen në konteinerë plastikë me kapacitet 120-240litra, dhe grumbullohen 1 herë në javë nga kompania;**
- **B.Sistemi i grumbullimit të mbeturinave me konteiner 1.1 m3, i cili aplikohet në ato njësi ekonomike familjare me banim kolektiv (ndërtesa shumëkatëshe) apo në koncentime të institucioneve publike, apo bizneseve të vogla, ku shërbimi ofrohet nga kompania dhe realizohet një herë -3 herë në ditë në banesa kolektive në zonën 1; Nëpër institucione/ biznese shërbimi kryhet varësisht zbrazjeve me frekuencë 1-2 herë në javë.**

Kryesisht gjendja fizike e kontenierëve është e mirë dhe vendlokalitetet e pikave të grumbullimit janë të organizuara mirë dhe me rrethojat estetike (gjithsej **66** lokacione të grumbullimit të mbeturinave me prezencë prej 2- 7 kontenierë 1.1m3).

Aktualisht shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve ofrohet **në 43** fshatra të komunës së Rahovecit (100%) Në këto fshatra shërbimi është i plotë dhe kryhet 4 herë në muaj.

5.4 Përmbledhje e gjetjeve në menaxhim të mbeturinave

Në tabelën e mëposhtme do të përmbledhen të dhëna të përgjithshme të mjedisit që lidhen drejtpërdrejt me menaxhimin e mbeturinave në Komunë.

Tabela 11. Të dhëna mbi çështjet mjedisore lidhur me menaxhimin e mbeturinave

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME	KOMUNA RAHOVEC
MATJE MBI PËRBËRJEN E MBETURINAVE?	JO
PIKA TË DEPONIVE ILEGALE TË GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE	20
VENDE TË AUTORIZUARA TË DEPOZITIMIT TË MBETURINAVE (PGM)	66
VENDE TË PA AUTORIZUARA PËR DEPOZITIMIN E MBETURINAVE	20
VENDDEPOZITIME ILEGALE QË JANË ELEMINUAR	27
VEND I CAKTUAR PËR DEPONIMIN E MBETJEVE INERTE	PO
% E MBETJEVE QË SHKOJNË NË DEPONINË E RAHOVECIT	100% MBETURINE AMVISËRIE
% E MBETJEVE NË VENDDEPOZITIME ILEGALE PRANË LUMENJVE	NUK KA TË DHËNA
SISTEM PER NDARJE NE BURIM	JO
SASIA E MBETURINAVE E MBLEDHUR DHE E PËRPUNUAR (TON/VIT)	DEPONUAR 8093 t/vit
% E MBETJEVE R TË MBLEDHURA DHE TË PËRPUNUARA	3,2%
A KA NISMA PËR KOMPOSTIM?	JO
A KA NISMA PËR RIKIKLIM?	PO
A KA LOKACION PER AKTIVITET RIKIKLIMI	3 FABRIKA E RIKIKLIMIT

Në bazë të këtyre të dhënave në Komunën e Rahovecit:

- Gjenden rreth **66** pika të grumbullimit të mbeturinave të plotësuar me infrastrukturë me konteniere;
- Gjenden gjithsej 27 Vende të pa autorizuar për depozitimin e mbeturinave, kryesisht të natyrës së mbetjeve inerte, të përziera dhe voluminoze. Referuar të dhënave **prej 27 në total, 27** deponi ilegale janë pastruar dhe 27 janë aktive të parehabilituara sipas perberjes 4 deponi të amvisërisë, 9 inerte dhe 14 të përziera;

- Mbeturinat komunale deponohen në deponinë komunale të Rahovecit menaxhuar nga KRM "EKO Regjioni";
- Komuna posedon një vend të caktuar për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve inerte, në zonën e qytetit megjithatë është në fazë të funksionalizimit.
- Komuna posedon kapacitete për zhvillimin e Aktivitetit të Riciklimit në tërësi territoriale pasi që ka të ndërtuar Fabrikë të Riciklimit jo aktive për momentin
- Komuna ka nisur nisur të ndarjes në burim sipas fraksioneve të mbeturinave në disa zona të caktuara

5.5 Riciklimi i mbeturinave

Sektori i riciklimit në Kosovë është në hapat fillestarë të zhvillimit. Në komunën e Rahovecit përqindja më e madhe e mbetjeve janë ato organike biodegraduese të amviserisë. Karakteristike të mbetjeve biodegraduese në rahovec janë mbetjet nga krasitje e hardhie dhe mbetjet nga perpunimi i rrushit të cilat mund të riciklohen dhe nga to të prodhohen plehera organikë shumë të nevojshëm për bujqesinë. Edhe mbetjet tjera plastike apo metalike janë me rëndësi që të riciklohen. Aktualisht kjo industri është e lokalizuar në biznes të vogël që kryesisht merren me sortimin e materialit të riciklueshëm dhe shitjen e tij për tregun vendor apo të jashtëm. Tregu i shitjes së materialit të riciklueshëm kryesisht është i fokusuar në materialet e riciklueshme si: metal/alumini, plastika sipas disa llojeve të plastikës, letra dhe kartoni. Çmimi i shitjes varion në treg sipas bursës internacionale dhe ku çmimet kryesisht shkojnë sipas fraksioneve: letra 3-4cent/kg; plastika 8-15cent/kg, alumini/hekur deri në 70cent/kg. Për momentin aktiviteti i grumbullimit realizohet kryesisht prej veprimtarisë joformale të mbledhësve joformalë në formë jo të organizuar, përderisa ai i paketimit dhe presimit prej bizneseve të vogla lokale.

Në Rahovec në momentin ekzistojnë tri kompani private Toni, Korenica dhe Pista Ecoplast të cilat bëjnë grumbullimin dhe perpunimin e mbetjeve të plastikës për prodhimin e arkave të plastikës për perime, ulëse për palestër dhe gypa lenda e për kryesisht sigurohet nga importi, por një sasi grumbullohet edhe si mbetje. Është mirë që komuna në partneritet publiko privat të shqyrtoj mundësinë e riciklimit të mbetjeve të plastikës duke organizuar ndarjen e plastikës në burim të cilën kompanitë e lartcekura do ta përdornin si lëndë të parë me plotësime teknologjike që do ta mundësonin këtë.

Në biznes vërehet që ka aktivitete të ndarjes së materialit të riciklueshëm i cili grumbullohet kryesisht prej mbledhësve joformalë të grupeve të komuniteteve të marginalizuara.

Në komunë ka veprimtari të bizneseve që merren me sortim dhe ambalazhim të mbeturinave të riciklueshme dhe komuna sipas regjistrimit të saj regjistron mbi 20 mbledhës joformalë të paorganizuar.

Në çdo rrethanë, komuna duhet të hartojë politikë që adresojnë ndarjen në burim dhe riciklimin e mbeturinave si pjesë e objektivave për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave komunale dhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave të depozituara në deponinë regjionale në Prizren.

5.6 Kompostimi

Në Komunën e Rahovecit nuk shihet ndonjë nisje për kompostim. Nëse shiqohet llojet e fraksioneve të mbeturinave që mbi 60 përqind janë organike, dhe nëse dihet se komuna e Rahovecit i takon komunave me zhvillim bujqësor, atëherë kompostimi është një operacion i domosdoshëm që duhet të zhvillohet.

Shpresojme se në planifikimin e saj, komuna synon zgjerimin e këtij sistemi edhe në zona tjera kryesisht në zona rurale ku potenciali i gjenerimit të fraksionit organik është më i lartë.

5.7 Administrimi i mbeturinave të vëllimshme dhe rrymave tjera


Një faktor tjetër që ndikon në aspektin estetik dhe shëndetsor për qytetarët e komunës së Rahovecit është edhe hedhja pa kriter e mbeturinave voluminoze, kryesisht inerte, mbeturinave të vëllimshme, të papranueshme për sistemin e mbledhjes së mbeturinave. Mbeturinat nga prishja e ndërtimeve apo të ashtu quajturat mbetje të ngurta janë mbetje si gurë, dhe, beton, tulla, etj., që mbeten nga veprimtaritë e ndërtimit, rindërtimit, riparimit dhe prishjes së ndërtesave, shtëpiave dhe strukturave të tjera. Shpesh këto mbetje hidhen të përziera me mbetje urbane duke impaktuar cilësinë dhe efektivitetin e shërbimeve apo edhe hidhen në mënyrë të pakontrolluar duke krijuar prezencë të deponive të egra ilegale të dëmshme për mjedis dhe shëndetin e banorëve. Momentalisht nuk ka ndonjë sistem të instaluar prej komunës apo kompanisë së "EKO Regjioni" për grumbullimin e tyre të veçantë (mbeturinat e vëllimshme). Komuna i ka të përcaktuar disa lokacione/gropa natyrore për mbushje me material inert, por funksionalizimi i tyre nuk është në nivelin e duhur. Komuna në disa raste ka bashkëpunuar me operatorë privatë të interesuar për pranimin e materialit inert për mbushje të hapësirave të caktuara, megjithatë në të gjitha situatat është e nevojshme ngritja e një sistemi të mirëfilltë për deponimin e sigurtë dhe trajtimin e mbetjeve inerte prej prishjeve dhe ndërtimeve.

Referuar organizimit të veçantë të grumbullimit për mbetjet prej eshtrave, sipas informatave posedohet një organizim i veçantë apo trajtim i kësaj kategorie të mbetjeve të rrezikshme megjithatë ky sistem ka nevojë të përmirësohet dhe të jetë më efikas.

Mbetjet tjera të rrezikshme duke përfshirë mbetje spitalore prej klinikave të mjekësive familjare shpeshherë bashkohen me rrymën e mbeturinave të përgjithshme dhe dërgohen në deponi pa trajtim të veçantë. Krijimi i sistemeve të integruara të mbeturinave dhe organizimi i shërbimit referuar llojit të mbeturinave të gjeneruara kërkon angazhim të të gjithë akterëve në proces me rëndësi të veçantë edhe inspektoriatin. Komuna në planët e saj duhet të parashohë trajtimin e mbeturinave referuar rrymës që i përkasin si dhe krijimin e qendrave të ndarjes në njësi komunale duke i bashkërenduar me zhvillimin e fushatave të informimit për qytetarë.

5.8 Deponimi i mbeturinave

Shërbimi i deponimit të mbeturinave për komunën e Rahovecit ofrohet nga kompania regjionale për mbeturina "EKO Regjioni", përmes deponisë regjionale të Prizrenit e ndërtuar në vitin 2003 (financuar nga KE), ka filluar të oproi në vitin 2004, për të pasur kapacitet prej 2 600 000 m³ ose kapacitet 3500 ton në muaj, me kohezagjatje deri në 15 vite (te mbyllet 2020 por KMDK ka shtyrë deri në vitin 2025), e cila gjendet në Landovicë në afërsi të Prizrenit në distancë prej 27 km me qendrën e qytetit të Rahovecit. Deponia i plotëson kërkesat ligjore për deponim bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 01/2009 mbi kushtet për selektimin e deponive të mbeturinave bazuar në Nenin 33 të Ligjit mbi Mbeturina.



Mirembajtjen e deponisë e realizon KMDK dhe trajtimi dhe deponimi bëhet në forma të thjeshta pa standarde adekuate për deponim final të mbeturinave. Kjo deponi i shërben edhe komunave tjera të këtij rajoni përfshi Prizrenin, Suharekën, Malishven, Mamushë dhe Gjakovës.

Sipas një raporti të AMMK të qershorit 2021, vizita e bërë në këtë deponi e datës 23.02.2021 tregon se gjendja mjedisore e deponisë është konstatuar se nuk është e mirë. Në rënd të parë infrastruktura rrugore brenda deponisë duhet të jetë më e rregulluar dhe e shtruar me zhavor, për faktin se rruga në brendi është e mbuluar me baltë. Pra, kërkohet të vëhet një shtresë e mirëfillt me zhavor. Pjesa e poshtme e deponisë (ana perëndimore) është e mbushur me mbeturina, dhe e cila nuk mbulohet me dhe sipas proporcionit të mbushjes. Në pjesën lindore të deponisë vazhdon deponimi i mbeturinave me një proporcion të shpërndarë. Në të njëjtën kohë në këtë pjesë bëhet shtyrja dhe ngjeshja me makineri e rëndë të përcaktuar për këtë operim. Po ashtu, në këtë pjesë të deponisë para disa viteve është hapur një sipërfaqe e re e cila është dedikuar për zgjerimin e deponisë, por e cila akoma nuk është në operim. Përgjegjësi i deponisë, z. Asllan Shehu ka deklaruar se është duke punuar në menaxhimin e deponisë përkundër vështirësive që kanë me mjetet dhe infrastrukturën. Ndër të tjera përgjegjësi theksoi se ngjeshja e mbeturinave bëhet në mënyrë të rregullt, por se mbulueshmëria e saj me dhe është duke shkuar ngadalë për shkak të mungesës së kapaciteteve për mbulim.

Në pjesën e poshtme të deponisë (lagunës) është hasur ujërrjedhje e vogël e deponisë, e cila shkakton probleme të metutjeshme mjedisore në kontaminimin e tokës bujqësore dhe livadheve që shtrihen në anën e poshtme. Gjithashtu, ujerjedha e deponisë shkakton ndotjen edhe të lumit të Landovicës, e cila shkarkohet pas një distance prej 700 m të qarkullimit.



Kostot e deponimit të mbeturinave në këtë deponi është 5,74 euro për ton.

Mungesa e aktiviteteve të riciklimit e cila synon reduktimin e sasisë dhe volumit, si rrjedhojë reduktimin e kostove të transportit për njësitët e KRM "EKORegjioni", adreson kërkesën e ngarkesës shtesë me kosto financiare referuar kosto të transportit, deponimit të sigurtë, amortizimit të pajisjeve dhe eficiencës në kohë.

5.9 Shërbimet e pastrimit të rrugëve dhe shërbime tjera mirëmbajtjeje

Përpos organizimit të sistemit efikas për menaxhim të mbeturinave, impakt në aspektin mjedisor, estetik dhe shëndetësor të një komune, rëndësi kanë edhe shërbimet e mirëmbajtjes së hapësirave publike. Referuar të dhënave, KRM "EKO Regjioni" përmes aktivitetit sekondar të kompanisë publike që bazohet në kontratë të veqanta me komunën e Rahovecit është përgjegjëse sipas kushteve kontraktuale për:

- Kontrata largje fshirje të rrugëve (kontratë tri vjeçare)

Vlera e përafërt e kontratës për shërbime sekondare të kontraktuara (zbatuara), kontrata largjefshirje rrugesh 8.868,12€/muje, 62.080,34 €/vjetore. Kontrat me operator publik/privat: Publike lot-I- 43.971,34€, Privat lot -II- 18.109,00 €. Vlera e kontratës për mirëmbajtje të hapësirave publike rreth 4900 €/Mujore 68.713,66€(loto I,II,III).

5.10 Mjetet për ofrimin e shërbimit

Mjetet për ofrimin e shërbimit sipas të dhënave do të përmblihen në:

Kontenierë për grumbullim

Të dhënat paraqesin se, Komuna e Rahovecit ka të shpërndarë në territorin e saj gjithsej sipas shërbimit dërë më derë 2570 shporta 120 dhe 240 l apo nëpër pika të përbashkëta grumbullimi 205 Konteneire 1.1 m³ dhe 2 kontejner 7 m³. E gjithë kjo infrastrukturë është në **pronësi të komunës dhe në shfrytëzim të kompanisë publike.**

PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

Në tabelën më poshtë jepet lloji dhe numri i konteinerëve që operojnë në Komunën e Rahovecit:

Tabela 12 Logjistika e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave

Nr.	Lloji i konteinerëve	Kapaciteti	Nr. Konteinerëve 2020	Viti i fillimit të përdorimit	Gjendja e tyre
1	Plastik	240 litra	600	2018	x
2	Plastik	120 litra	2000	2019-2020	E mire
3	Plastik	1.1 m³	150	2019	E mire
4	Metalik	1.1 m³	50	2019	E mire
5	Metalik (arkë)	7m³	7	/	

Kamionë

Në bazë të të dhënave të mbledhura, KRM EKO Regjioni operon më 9 kamione për mbledhjen e mbeturinave komunale, të cilat janë kryesisht me motorrikë të vjetëruar 3t, /6.38t/7.22t/10.20t dhe 34 tone/dite/tur. Llojet e kaminave Kompaktore 3 Isuzu/1Mitsubishi/1Iveco dhe 2 traktora dhe asetet për shërbim Kamionete Cistern/Traktor per bore dhe kiper per bore.

Tabela 13 Logjistika e operimit për grumbullimin e mbeturinave

Regjistrimi	Prodhuesi	Tipi (Aseti)	Viti i prodhimit	Masa e lejuar bartëse(kg)
02-771-FR	Isuzu	Kompaktor		
072-36-16	Hino	Kompaktor		
072-37-16	Hino	Kompaktor		
072-38-16	Hino	Kompaktor		
072-39-16	Hino	Kompaktor		
04-254-HA	Mitsubishi	Kompaktor		
01-730-FR	Isuzu	Kompaktor		
01-735-FR	Isuzu	Kompaktor		
04-362-HI	MB	Kiper		
04-994-MA	MB	Kiper		
04-886-BU	MB	Cistern		
04-238-VA	Tra	Fendi		
Traktor 539	Trak	Traktor 539		
Traktor 539	Trak	Traktor 539		
04-392-DQ	MB	Xhip ML		

5.11 Financat dhe të hyrat financiare

Aktualisht **Komuna e Rahovecit** realizon inkasimin apo vjeljen e tarifës së shërbimit për të gjitha ekonomitë familjare në territorin e komunës . Operatori, në këtë rast KRM “EKO Regjioni” paguhet ne baze te rregullores komunale per mbeturina sipas marëveshjes me komunën e Rahovecit si aksionere e kompanisë **me 61.8% të** aksioneve. Ndërkohë që KRM “EKO Regjioni” realizon inkasimin tek subjektet komerciale dhe institucionet brenda territorit të Komunës së Rahovecit. Sfidat e komunës në vjeljen e inkasimit prej ekonomive familjare vazhdojnë, dhe sipas të dhënave te fundit nga Raporti i Menaxhimit te Mbeturinave Komunale ne Kosove te AMMK 2020 per vitin raportues 2018\19, **96.35% është inkasimi prej ekonomive familjare ndërkohë që pjesën e mbetur e subvencionon komuna me mjetet vetanake** të saj.

Aplikimi i tarifave të përcaktuara në Rregulloren komunale për mbeturina me Nr. 032016 dhe ndahet sipas kategorive të klientëve ku tarifat e aplikuar janë:

- Në kategorinë e konsumatorëve shtëpiakë aplikohet tarifa fikse 4.50 € në muaj;
- Në kategorinë e konsumatorëve komerciale tarifa varion:
- Veprimtaritë e vogla zejtare dhe shërbyese, 6.00 € për llojin e shërbimit 1.1 m3 dhe 120 L,
- Subjektet e mesme deri të mëdha me kosto të ulët të shërbimit, 10,52€ për llojin e shërbimit 1.1 m3 dhe 240 L,
- Subjektet e mesme deri të mëdha me kosto të moderuar të shërbimit 18,10€ për llojin e shërbimit 1.1 m3 dhe 240 L,
- Subjektet e mesme deri të mëdha me kosto të lartë të shërbimit, 24.60 € për llojin e shërbimit 1.1 m3 dhe 240 L,
- Konsumatorët me kontrata të veçanta, 12.3 € për llojin e shërbimit 1.1 m3 dhe 47.20 € për llojin shërbimin 7.1m3,
- Taksa për Institucionet Publike dhe institucione tjera. 12.3 € për llojin e shërbimit 1.1 m3 dhe 47.20 € për llojin shërbimin 7.1m3.

Të hyrat nga taksa për mbeturina inkasohen në kod të veçantë të DMMP-së, të cilat do të përdoren për nevoja eksplicite të funksionimit të sistemit të mbeturinave dhe mbrojtjes së mjedisit. Operatori i zgjedhur KRM" EKO Regjioni" dhe i licencuar nga MMPH, pahuhet nga komuna e Rahovecit për shërbimin e ofruar dhe është i obliguar nga kushtet kontraktuale me komune sipas rregullave ndër të tjerash:

- Duhet të zbatojë planin operativ për menaxhimin e mbeturinave të hartuar nga komuna,
- Të realizojë grumbullimin, transportimin, deponimin e mbeturinave, në bazë të kushteve të përcaktuara nga MMPH, Komuna dhe në licencë;
- Marëveshja lejon qasje të lirë organit kompetent që të inspektojë dhe mbikëqyrë dhe të kontrollojë dokumentacionin sipas rregullave të menaxhimin të vendosura nga komuna;
- Komuna autorizon personin e kualifikuar për kryerjen e punëve profesionale në sektor;
- Komuna mban dhe ruan evidencën në regjistrin për mbeturinat në pajtim me dispozitat e ligjit për mbeturina ;

Të dhënat mbi aspektet financiare të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në Komunen e Rahovecit janë paraqitur në dy tabelat në vijim, të cilat grupojnë përkatësisht (i) çështje të tarifës, faturimit dhe mbledhjes së të ardhurave nga subjektet pagues dhe (ii) të koston së dhënies së shërbimit e buxhetimit të tij.

(i) Çështje të tarifës, faturimit dhe mbledhjes së të ardhurave nga subjektet pagues

Së pari, të dhënat e mbledhura tregojnë një diferencë të theksuar midis numrit të subjekteve të cilëve ju faturohet tarifa e shërbimit dhe kanë realizuar pagësen e fatures, diferencë kjo e cila reflekton buxhetin e komunës për realizimin e këtij shërbimi (inkasimi për amvisëri 42 %, mbulimi me shërbim 98%). Sipas të dhënave të ofruara prej komunës dhe kompanisë inkasimi prej vitit 2019 është në rritje si efekt i shtrirjes së shërbimit në nivel territorial dhe referuar të dhënave të ofruara për vitin 2019 vlerësuar me numrin e bizneseve në faturim të koston së dhënies së shërbimit në vitin 2019 dhe inkasimit të tij.

Tabela 14. Të dhëna lidhur me inkasimin për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave

Inkasimi i të hyrave	2019	2020	% Inkasimit (6 mujore)
----------------------	------	------	---------------------------

PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

Amvisëri	96253550 € pa tvsh	6 ek residente
Biznes	121646 € pa tvsh	
Institucione	20301 € pa tvsh	
Të tjera	68,713.66 €	Sekondare
TOTAL:	464,210.66	

Duhet të merret në konsideratë që komuna ka bërë shtrirjen e shërbimit në nivel territorial dhe ka marrë përsipër borxhet e akredituara prej subjekteve të cilët nuk e paguajnë shërbimin e ofruar. Megjithatë përlllogaritja e kostove.

Tabela 15 *Kostot potenciale të të ardhurave*

Qyteti/FKRMt	Ekonomi familjare	Kliente totale (të dhëna prej komunes)	
		Bisnese	Institucione
Rahovec	14,500	2000	195
Të hyra të inkasuara prej shërbimit (vjetore dhjetor 2020)	447978.96 €	314309.3 €	1120344 €
Të hyra të planifikuara prej shërbimit 100% (vjetore)	765,600 €	*€	€
% e inkasimit të tarifës së shërbimit 2020	65 %	85 %	100%
% e inkasimit të tarifës së shërbimit në gjashtëmujorin e vitit 2021	%	%	100%

*Numri ekonomive familjare sipas të dhënave nga komuna

Shuma potenciale e të ardhurave nga niveli aktual i shërbimit, sipas tarifave që zbatohen aktualisht për subjektet pagues është përlllogaritur në bazë të numrit të familjeve që marrin shërbim të rregullt të menaxhimit të mbetjeve, numrit gjithsej të bizneseve, si dhe numrit gjithsej të institucioneve në Komunën e Rahovecit.

Sipas të dhënave të raportuara inkasimi për vitin **referent 2020 sipas** shërbimit vetëm në klientët ku ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbeturinave është rreth 90% për amvisëri residente, për biznese dhe për institucione 100%, sipas raportimit krahasues Arketimi për shërbim për ekonomi familjare (viti 2019) të hyrat janë rreth **347,548.31** euro ndërkohë në 2020 është **302,323.45** euro, e cila tregon një përqindje të mirë të rritjes së shkallës së inkasimit. Njëherësh komuna sipas kontratave të ndryshme për aktivitetet sekondarë që ofrohen prej kompanisë publike ofron pagësë konform buxhetit (viti 2019) sipas kontratës menaxhimi dhe mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve për tri vite 130.000 €. Sipas të dhënave të ofruara prej zyrtarëve komunalë aktiviteti primar për grumbullimin e mbeturinave prej komunës në kompaninë EKO Regjionit arrin koston 707,548 Euro në vit, ndërkohë që ai sekondar i kontraktuar prej komunës në kompaninë EKO Regjionit është në vlerë financiare rreth 39.600 euro në vit (2020 vit referent).

Fuqia punëtore është kategoria kryesore e shpenzimeve me pjesëmarrje prej 67.7%, pasuar nga karburantet me 15.4% dhe mirëmbajtja me 16.1%

Shumica e fondeve shpenzohen për mbledhjen e mbeturinave, 80.8%, pasuar nga deponimi i mbeturinave, 16.5%, dhe shërbimet e kontraktuara komunale, 2.7%.

Shpenzimet operative të ndërrmarjes për ofrimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave janë të kategorizuara sipas shpenzimeve ku rreth 67.7% është kostoja për fuqinë punëtore, pasuar nga karburantet me 15.4% dhe mirëmbajtja me 16.1%. Shumica e fondeve shpenzohen për mbledhjen e mbeturinave, 80.8%, pasuar nga deponimi i mbeturinave, 16.5%, dhe shërbimet e kontraktuara komunale, 2.7%.

5.12 Përmbledhje e gjetjeve kryesore nga vlerësimi i gjendjes fillestare

Duke Konsideruar si bazë reference vitin 2019-2020. Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në Komunën e Rahovecit ka një kosto gjithsej prej mbi **707,548** euro/vit pa llogaritur kostot kapitale.

- Shërbimi ofrohet përafërsisht për 100% të popullsisë.
- Shpeshtësia (frekuenca) e mbledhjes së mbetjeve urbane është çdo ditë / javë për zonën urbane të qendrës së qytetit dhe 1 herë në javë për zonat rurale ku përfshihen të gjitha njësitë e tjera administrative.
- Me riorganizimin territorial të shërbimit referuar efektivitetit dhe eficiencës objektivi strategjik i komunës për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve është plotësimi me infrastrukturë të grumbullimit për 2% amvisëri në territorin e saj referuar politikave të mëparshme të komunës për pajisje dhe unifikim të mjeteve të kryerjes së shërbimit.
- Me shtrirjen e shërbimit në komplet territorin dhe referuar mjeteve motorike të vjetëruara komuna duhet të adresojë ceshtjen për përmirësimin e kapaciteteve të operimit për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave.
- Deri me tani, Komuna ka përmbyshur objektivin e saj strategjike për shtrirje të shërbimit në njësi territoriale të territorit komunal.

5.13 Nevojat dhe prioritetet

Gjenerimi i mbetjeve në territorin e komunës ka efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, i cili është prioriteti kryesor i komunës së Rahovecit nga pikepamja ekonomike si dhe në integritetin e zonave të pasterta dhe miqësore me mjedisin.

Nevojat të cilat duhen marrë parasysh në zbatimin e planit në harmoni dhe me planin komunal për menaxhim të mbeturinave të komunës janë renditur si me poshtë:

- Rehabilitimi i zonave me ndotje prej deponive të ilegale dhe revitalizimi i tyre duke i kthyer në zone të gjelbra me vlerë rekreative për qytetin, të tjerat në përputhje me normat e sigurisë;
- Inventarizimi dhe diagnostikimi i vend-depozitimeve, si dhe përcaktimi i prioritetëve, planifikimi dhe raportimi;
- Zhvillimi i infrastrukturës së pershtatshme për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave dhe ndarje në burim;
- Aprovimi i një buxheti të mjaftueshëm për menaxhimin e mbeturinave referuar planeve dhe objektivave;
- Hartimi i programeve vetëdijesuese për ndarje në burim të mbeturinave;
- Funkcionalizimit/operimit të qendrës për riciklim;

Funksionalizimi i sistemit për grumbullim të veçantë dhe për trajtimin e mbetjeve të ngurta komunale duke përfshirë, mbetjet voluminoze, kompostimin dhe selektimin e mbetjeve të riciklueshme;

- Krijimi i kushteve të duhura për donatorët ndërkombëtarë për të financuar infrastrukturën e nevojshme;
- Plotësimi me kapacitete njerëzore i sektorit për menaxhim të mbeturinave në komunë;

• Forcimi i mekanizmave për mbledhje më të mirë të tarifave dhe zbatim i sanksioneve dhe monitorimi i shërbimit në përgjithësi.

Sipas qëllimeve të vendosura në planin për menaxhim të mbeturinave komunale, objektivat primare në menaxhim të mbeturinave komunale janë fokusuar në marrjen e masave emergjente për të ndryshuar situatën, përmirësimin e performancës komunale për mbledhjen, transportin dhe depozitimin e sigurtë të mbeturinave komunale si dhe rritjen e efijencës dhe efikasitetit të shërbimeve të ofruara.

Kjo do të përfshijë zbatimin e skemave për shtrirjen e shërbimit bazik në nivel të komplet territorit(100%) dhe popullsisë së shërbyer dhe aktivitete tjera që rrisin performacën për ofrimin e shërbimeve bazike, zbatimin e programeve të minimizimit të mbeturinave përfshirë ndarjen në burim për riciklim dhe kompostimin për të reduktuar në mënyrë progresive sasinë e mbeturinat për deponim final në deponi si dhe trajtimin adekuat të mbeturinave me qëllim zvogëlimin e rrezikut që shkaktojnë në mjedis. Në të njëjtën kohë do të synojë rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe përmirësimin e financave komunale për menaxhimin e mbeturinave.

Objektivat janë strukturuar duke marrë parasysh qëllimet e përcaktuara prej komunës së Rahovecit, duke analizuar objektivat e vendosura dhe duke analizuar gjendjen ekzistuese të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave në komunë. Krahas saj, vlerësimi i gjendjes ekzistuese të sektorit rishikojnë përmbushjen e objektivave të përcaktuara në planin paraprak dhe nevojën për plotësime shtesë apo rishikimin e tyre.

Përsa i përket vendosjes së objektivave sipas PKMM 2022-2026, në mënyrë të përmbledhur ato në disa qëllime dhe do të konsistojnë në:

1. Të optimizojë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në mënyrë të unifikuar në nivel territorial.
2. Të sigurojë grumbullimin në masën maksimale të sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe të garantojë eliminimin e të gjitha depozitimeve të përkohëshme të pakontrolluara brënda territorit të komunës.
3. Të sigurojë në mënyrë graduale infrastrukturën dhe zbatimin e skemës optimale të nevojshme për ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar të tyre për të përmbushur objektivat kombëtare të reduktimit dhe ripërdorimit të mbeturinave.
4. Të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për destinacionin final si shkak i aktivitetit të riciklmit dhe kompostimit.
5. Të realizojë në mënyrë graduale dhe në përputhje me parimin “ndotësi paguan” mbulimin e kostos së shërbimit nga të ardhurat prej tarifës duke marrë në konsideratë mundësitë dhe vullnetin e banorëve, bizneseve dhe institucioneve për të paguar.

6. PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

6.1 Planifikimi strategjik dhe vizioni

Politikat e nivelit qendror dhe lokal në Kosovë në menaxhim të mbeturinave parashtrojnë si domosdoshmeri zhvillimin e alternativave të qëndrueshme përmes praktikave të trajtimit të mbeturinave sipas llojit të tyre. Vazhdimi i sistemit aktual të deponimit të mbeturinave nuk konsiderohet të jetë një opsion i qëndrueshëm si rezultat i zvogëlimit të kapacitetit të deponive vijuar me politikat sociale, ekonomike dhe mjedisore.

Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturina kanë përcaktuar 2 periudha të rëndësishme kohore: faza e parë dhe e dytë (2013-2017 dhe 2017-2022) ku synohet përparimi drejt standardeve të BE dhe arritja e standardeve dhe objektivave të BE. Në këtë kuadër, politikat nacionale synojnë progresin gradual drejt përmirësimit të situatës aktuale drejt standardeve kombëtare e ndërkombëtare.

Referuar politikave të nivelit lokal, PKMM synon të adresojë zgjidhje efikase dhe me kosto efektive për të zvogëluar sasinë e mbeturinave të deponuara, për të menaxhuar në mënyrë efektive mbetjet e ngurta dhe për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

Vizioni i planit Komunal të menaxhimit të mbeturinave të komunës së Rahovecit mori formë si një proces i analizimit të situatës aktuale dhe mundësive për hartimin e objektivave që synojnë menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave komunale.

Në fund, duke iu referuar statusit aktual të menaxhimit të mbeturinave, prioritetëve të përgjithshme si dhe pritshmërive për zhvillimin e këtij sektori, vlerave dhe normave qytetare, nevojës për ndryshim, u përcaktua vizioni i komunës i cili synon të jetë:

“Rahoveci, një komunë e pastër dhe që motivon përdorimin e mbeturinave si burim për ekonominë e gjelbër, me përfitime mjedisore për të gjithë”

Objektivi kryesor i planit bazohet në objektivat kombëtare për menaxhim të mbeturinave lidhur me ndërmarrjen e masave përmes së cilave, Komuna do të duhej të zvogëlojë sasinë e mbeturinave që aktualisht krijohen me qëllim ngritjen e sistemit të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale.

Në harmoni me këto politika, Komuna e Rahovecit do të planifikojë objektiva specifike duke u fokusuar në:

- Zvogëlimin e krijimit të sasisë së mbeturinave në burim si dhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që duhet të deponohen;
- Ngritjen e infrastrukturës për ndërtimin e sistemit të integruar në menaxhimin e mbeturinave (Zvogëlim - Ripërdorim - Riciklim), pra për të krijuar kushtet për funksionim më efektiv të sistemit;
- Zvogëlimin e rrezikut nga mbeturinat;
- Kontributin për ngritjen e punësimit në vend;
- Ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave;
- Përmirësimi i shërbimit për mbledhjen e mbeturinave komunale (përmirësimi e sistemit aktual, zgjerimi/plotësimi i zonave të grumbullimit, ekzamenimi dhe harmonizimi i kapaciteteve për deponimin e mbeturinave).
- Edukimin e publikut, ngritja e vetëdijes dhe ndërgjegjësimit
- Rishqyrtimin e rregulloreve për menaxhimin e mbeturinave;

Në këtë kontekst, objektivat e PKMM për Komunën e Rahovecit janë:

1. Të optimizojë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në mënyrë të unifikuar në nivel territorial.
2. Të sigurojë grumbullimin në masën maksimale të sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe të garantojë eliminimin e të gjitha depozitimeve të përkohëshme të pakontrolluara brënda territorit të komunës.
3. Të sigurojë në mënyrë graduale infrastrukturën dhe zbatimin e skemës optimale të nevojshme për ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar për të përmbushur objektivat kombëtare të reduktimit dhe ripërdorimit të mbeturinave.
4. Të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për destinacionin final si shkak i aktivitetit të riciklimit dhe kompostimit.
5. Të realizojë në mënyrë graduale dhe në përputhje me parimin “ndotësi paguan” mbulimin e kostos së shërbimit nga të ardhurat prej tarifës duke marrë në konsideratë mundësitë dhe vullnetin e banorëve, bizneseve dhe institucioneve për të paguar.

Zbatimi i këtij Plani do të shtrihet në planin kohor 5 vjeçar 2021 – 2025. Treguesit dhe buxheti i zbatimit të Planit monitorohen dhe rishikohen çdo vit në kuadër të procesit të përgatitjes së paketës fiskale dhe buxhetit vjetor të komunës.

6.2 Objektivat dhe Rezultatet e PKMM

Përcaktimi i objektivave shërben për të përcaktuar dhe menduar se çfarë do të jetë më e rëndësishme për Komunën e Rahovecit, si dhe për të marrë një vendim përfundimtar mbi zhvillimin e shërbimit të pastrimit, grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave. Paraqitja e rezultateve ndihmon për të bërë zgjedhjet e duhura me fokus në përmirësimin e shërbimit dhe monitorimin e performancës së komunës së sektorit.

Për të përmbushur objektivat e këtij plani, Komuna e Rahovecit ka vendosur këto tregues për objektivat që do të realizohen nga zbatimi i Planit.

Objektivi 1: Të optimizojë shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve në mënyrë të unifikuar që garanton optimizimin e kostove dhe shërbimit në komunën e Rahovecit.

Tabela 16. Objektivi I sipas PKMM

Objektivi 1: Të optimizojë shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve në mënyrë të unifikuar që garanton optimizimin të kostove dhe shërbimit në komunën e Rahovecit.							
Komuna Rahovec		Mbulimi me infrastrukturë të unifikuar për shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbeturinave					
Rezultati	# Zona	Viti bazë 2020	2021	2022	2023	2024	2025
Zona është e mbuluar 100 % me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave.	Zona I	100%	100%	100%	100%	100%	100%
	Zona II	90%	95%	100%	100%	100%	100%
Totali	Komuna	88.5%	100%	100%	100%	100%	100%

Referuar numrit të amvisërive në komunë, në total janë 13148 amvisëri (sipas ASK regjistrimi I popullsisë 2011).

Referuar Sistemi i grumbullimit të mbeturinave i cili përbëhet me infrastrukturën si në vijim:

- Shtëpitë individuale me kontejner 120l (në të gjithë zonën e shërbimit urbane dhe rurale);
- Banimet kolektive me kontejner 1.1 m³;
- Bizneset në zonën rurale dhe periurbane me kontejner 120 l;
- Bizneset në zonën urbane me kontejner 1,1 m³;

Komuna do të duhet të të planifikojë buxhet për blerjen e 6000 kontejnerëve 120 l të nevojshëm për shërbim dhe të bëjë shpërndarjen e tyre në çdo amvisëri (tek amvisëritë residente), duke mbuluar në këtë mënyrë infrastrukturë të njëjtë të grumbullimit në nivel territori (në fundt të afatit kohor 2025).

Objektivi 2: Ndarjen e mbetjeve në burim për grumbullimin e diferencuar dhe reduktimi i mbetjeve nëpërmjet riciklimit dhe kompostimit

Në këtë drejtim kjo objektivi e caktuar synon të sigurojë në mënyrë graduale infrastrukturën dhe zbatimin e skemës optimale të nevojshme për ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar për të përmbushur objektivat kombëtare për reduktimin e mbetjeve.

Për të arritur këtë objektiv, Komuna e Rahovecit do të synojë ofrimin e këtij shërbimi në dy standarde sipas ndarjes territoriale në dy zonat e shërbimit.

1. Zona e I-rë:
 - Zona Urbane Rahovec: procesi i reduktimit nëpërmjet riciklimit planifikohet të fillojë në vitin 2021;
 - Qyteti i Rahovecit: procesi i reduktimit nëpërmjet riciklimit planifikohet të fillojë në vitin 2021, në të gjitha institucionet shkollore dhe lagje pilot 300 amvisëri dhe zonë urbane 2 lokacione .
2. Zona e II-të
 - Në Zonën e II-të, procesi i reduktimit nëpërmjet riciklimit planifikohet të fillojë nga viti 2022;
3. Zona e III-të
 - Në zonën e III-të procesi i reduktimit nëpërmjet riciklimit planifikohet të zgjerohet përgjatë vitit 2022-2025.
4. E gjithë komuna
 - Përsa i përket riciklimit në zonat rurale të komunës së Rahovecit do të fillojë pilotimin e mbledhjes derë me derë të mbetjeve të riciklueshme 1 herë në javë në zona të cilat do të përzgjidhen nga komuna gjatë vitit 2021.
 - Gjate viteve 2021-2023 shërbimi do të shtrihet në 50% të territorit të komunës.

Tabela e rezultateve dhe tregueseve të indikatorëve për Objektivin 3 paraqitet në mënyrë të përmblodhur si më poshtë:

Tabela 17. Objektivi II sipas PKMM i ofrimit të shërbimit për ndarje në burim

Objektivi 2: Ndarjen e mbetjeve në burim për grumbullimin e diferencuar dhe reduktimi i mbetjeve nëpërmjet riciklimit dhe kompostimit.

PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIM TË MBETJURINAVE

Komuna Rahovec		Mbulimi me shërbimin e grumbullimi të diferencuar dhe ndarjen në burim					
Rezultati	# Zona	Viti	2021	2022	2023	2024	2025
Në qytetin e Rahovecit është vendosur një sistem efektiv për mbledhjen e diferencuar të mbetjeve të riciklueshme	Zona I	0%	10%	20%	35%	45%	50%
	Zona II	0%	10%	20%	35%	45%	50%
Në qytetin e Rahovecit është vendosur një sistem efektiv për mbledhjen e diferencuar të mbetjeve për kompostim	Zona I	0%	0%	15%	20%	25%	35%
	Zona II	0%	0%	15%	20%	25%	35%
Rezultati Komuna Rahovec Riciklim		0%	10%	20%	35%	45%	50%
Rezultati Komuna Rahovec kompostim		0%	0%	15%	20%	25%	35%

Objektivi 3: Të garantoje grumbullimin në masën maksimale të sasisë së mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës

Referuar objektivës së caktuar Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në deponi përmes aktivitetit të (ndarjes në burim) të fraksionit të thata –riciklueshme dhe organike për zbatimin e aktivitetit të kompostimit.

Në këtë mënyrë parashikohet që në të gjithë territorin e komunës në fund të afatit të këtij plani sasia e mbetjeve që depozitohen në deponi do të reduktohen me rreth 27%.Në këtë masë nuk llogaritet mbetjet e tjera të cilat trajtohen në forme të veçantë.

Tabela 18.Objektivi i III sipas PKMM

Objektivi 3: Të garantoje grumbullimin në masën maksimale të sasisë së mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës	
Komuna Rahovec	Reduktimi i mbetjeve

PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIMI TË MBETURINAVE

Rezultati	# Zona	Viti bazë 2020	2021	2022	2023	2024	2025
% mbetjeje të reduktuara prej rrymës së mbeturinave	Zona I	0%	2%	9%	17%	22%	27%
	Zona II	0%	2%	9%	17%	22%	27%
Totali	Komuna Rahovec	0%	2%	9%	17%	22%	27%

Objektivi 4: Të realizojë Grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvogimit të sasisë që përfundon në deponi

Për të realizuar këtë objektiv, komuna duhet të organizojë sistem të:

O.4.1 Grumbullimi dhe transportimi i veçantë i mbeturinave shtazore

O.4.2 Grumbullimi dhe transportimi i veçantë i mbeturinave medicinale

O.4.3 : Menaxhim i qendrueshëm i mbeturinave ndërtimore

O.4.4 Grumbullimi dhe transportimi i veçantë i mbeturinave të vëllimshme

O.4.5 Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave të riciklueshme-fraksioni të thata

O.4.6 Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave organike për kompostim -fraksioni organike

Komuna do të vendosë një sistem tarifor i cili do të mbulojë kostot e ofrimit të shërbimit të largimit të këtyre mbetjeje dhe trajtimit të tyre:

Tabela 19. Objektivi i IV sipas PKMM

Objektivi 4: Të realizojë Grumbullimin, transportimin dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvogimit të sasisë që përfundon në deponi							
Komuna Rahovec		Reduktimi i mbetjeje					
Rezultati	# Zona	Viti	2021	2022	2023	2024	2025
% mbetjeje shtazore të grumbulluara të cilat janë eliminuar nga rryma e mbeturinave të përbashkëta.	Bisnese		80 %	90 %	95 %	95 %	95 %
% mbetjeje medicinale të grumbulluara të cilat janë eliminuar nga rryma e mbeturinave të përbashkëta.	Komplet territori	0%	20%	40%	60%	80%	95%
% e deponive ilegale të egra të eliminuara	Komplet territori	20%	80%	100%	100%	100%	100%

PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

% e mbeturinave inerte të depozituara në deponinë inerte	Komplet territori	50%	90%	100%	100%	100%	100%
% e mbeturinave të vëllimshme të depozituara në qendrën e grumbullimit	Komplet territori	0%	50%	100%	100%	100%	100%
Totali	Komuna Rahovec	35%	52%	76%	84%	92%	98%

Tabela: Objektivi 4 i ofrimit të shërbimit grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta.

Objektivi 5: Të realizojë në mënyrë graduale dhe në përputhje me parimin “ndotësi paguan” mbulimin e kostos së shërbimit nga të ardhurat prej tarifës.

Për të realizuar këtë objektiv, komuna do të vendosë një sistem tarifor i cili do të mbulojë kostot e ofrimit të shërbimit të largimit të mbetjeve të ngurta urbane nga territori i komunës.

Gjithashtu norma e mbledhjes së tarifave do të planifikohet e njëjtë pavarësisht zonave të shërbimit. Kjo për arsye se llogaritja e kostove është ndarë sipas kategorive të prodhuesve të mbeturinave .

Në lidhje me koston (5.1) dhe të ardhurat (5.2):

Tabela 20.Objektivi 5.1 sipas PKMM

Objektivi 5.1 : Mbulimi i kostos nga të ardhurat prej tarifës së shërbimit dhe trajtimit të mbeturinave							
Indikatorët e Rezultatit 2021 - 2025							
Rezultati	# Zona	Viti bazë 2020 (gjashtë mujori vjetor)	2021	2022	2023	2024	2025
Kosto e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave mbulohet nga të ardhurat prej tarifës së këtij shërbimi	Ekonomi Familjare		80 %	85 %	95 %	95 %	100 %
	Institucione		100 %	100%	100 %	100%	100 %
	Bisnese	18%	85%	90%	90 %	95%	100 %

Tabela 21.Objektivi 5.2 sipas PKMM

Objektivi 5.2 : Rritja e mbledhjes së të ardhurave prej tarifës së shërbimit/Arkëtimit	
Indikatorët e Rezultatit 2022 - 2026	

PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

Rezultati	# Zona	2021	2022	2023	2024	2025
Tarifa e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave nga familjet mbledhet në të gjithë komunën	Ekonomi Familjare					
	Institucione					
	Bisnese					
TOTAL Arketim (Euro)						

7. VLERËSIMI DHE ANALIZA E PËRBËRJES SË MBETURINAVE KOMUNALE

7.1 Kriteret për planifikim

Në bazë të legjislacionit ekzistues, PKMM do të fokusohet në planifikimin e programeve për minimizim dhe trajtim të sigurtë të mbeturinave sipas potencialit gjenerues të fraksioneve të mbeturinave komunale të gjeneruara, për të cilën Komuna e Rahovecit është drejtperdrejtë përgjegjëse. Përgjegjësia e komunës duke u referuar kompetencave të komunave në pajtim me Ligjin për Mbeturina do të bazohet ndër të tjerash në:

- Hartimin dhe miratimin e planeve lokale për menaxhimin e mbeturinave;
- Përcaktimet e lokacioneve, bazuar tek plani hapësor, sipas nevojave përkatëse për menaxhimin e mbeturinave komunale;
- Përcaktimin e tarifave për shërbimet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale;
- Caktimin dhe mbikqyrjen e zbatimit të standardeve të shërbimit për ndërmarrjet e kontraktuara për grumbullimin e mbetjeve.

Krahas saj, një planifikim i programeve efikase të komunës në menaxhim të mbeturinave do të bazohet në kapacitetin gjenerues dhe të mbeturinave komunale, sipas përbërjes dhe mënyrës së menaxhimit të mbeturinave, mbeturinat komunale do të klasifikohen në:

- Mbeturina urbane (mbeturina të amvisërisë),
- Mbeturina të veçanta urbane (mbetje inerte e ndërtimore, mbeturina të vëllimshme: pajisje elektrike dhe mobiljesh, etj.) që prodhohen nga familjet apo njësitë tregtare;
- Mbeturina të rrezikshme që prodhohen brenda territorit të komunës.

Në lidhje me burimet e gjenerimit të mbeturinave, Mbeturinat urbane ndahen në dy rryma, sipas burimit të origjinës: (MF) Mbeturinat e prodhuara nga familjet, (MB) Mbeturinat e prodhuara nga bizneset dhe industritë, ku përbërja e mbeturinave nuk ndryshon nga karakteristikat e mbeturinave urbane. Ndërkohë, rryma të tjera të mbeturinave do të klasifikohen si mbeturina masive, mbeturina të ngurta (inerte) që prodhohen në familje dhe që do të trajtojmë si 'mbeturina të veçanta' për të cilat Komuna duhet t'i ofrojë alternativa të përshtatshme për grumbullimin dhe transportin e tyre, megjithëse largimi i tyre është përgjegjësi direkte e prodhuesit.

Një element kryesor i planifikimit të menaxhimit të integruar të mbeturinave është "identifikimi dhe shqyrtimi i alternativave" të qëndrueshmë duke ju referuar analizës së potencialit të gjenerimit të mbeturinave sipas fraksioneve dhe planifikimin e programeve për trajtimin e tyre. Planifikimi i programeve do të shqyrtojë mundësitë e ndryshme teknike dhe strategjike për menaxhimin e mbeturinave sipas planit të objektivave, vlerësimit të shkallës së zbatimit të tyre, avantazheve dhe disavantazheve ekonomike, ligjore, mjedisore, sociale si dhe teknologjive në dispozicion për këto alternativa.

7.2 Gjenerimi i mbeturinave

Për të parashikuar se si do të menaxhohen mbeturinat në të ardhmen për Komunën e Rahovecit, duhet të vlerësohet gjenerimi aktual i mbeturinave që të parashikojmë ecurinë e tyre për një periudhë afatmesme (3-5 vite). Të dhëna të sakta për gjenerimin e mbeturinave nevojiten për planifikimin e një shërbimi të ri apo ndryshime në shërbimin ekzistues të grumbullimit të mbeturinave, për projektimin e tarifave lokale për konsumatorët, për hartimin e planit (për vlerësimin e gjendjes ekzistuese dhe përcaktimin e objektivave mbi fraksionet e mbeturinave) si dhe për procesin e monitorimit të zbatimit të planeve. Gjithashtu, ka rëndësi të përcaktohen cilat fraksione të mbeturinave janë nën përgjegjësinë e komunave dhe cilat jo, të klasifikohen mbeturinat sipas burimit të origjinës dhe të jepen zgjidhje për trajtimin e tyre, ku sipas burimit të klasifikohen nëse janë të dëmshme (të rrezikshme) apo jo dhe në lidhje me kushtet e trajtimit/përpunimit të mbeturinave dhe metodat për tu aplikuar që disponohen apo do duhet të sigurohen në të ardhmen prej komunës së Rahovecit.

Një nga pengesat kryesore në komuna në Kosovë është mungesa e të dhënave statistikore lidhur me sasinë dhe llojet e mbeturinave të gjeneruara në burim për nivel territorial sipas komunave ku përgatitet planifikimi. Me qëllim parashikimin e administrimit të mbeturinave në të ardhmen në Komunën e Rahovecit, është e rëndësishme llogaritja e prodhimit aktual të mbeturinave si dhe parashikimi për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë i shkallës së rritjes së tyre, në varësi me trendet e sjelljes konsumatore.

Këto të dhëna janë të rëndësishme për hartimin e planeve të sakta dhe mundësojnë llogaritjen e situatës aktuale dhe përcaktimin e objektivave si dhe procesin e monitorimit në periudhë kalimtare apo të vazhdueshme. Në mungesë të këtij informacioni, komuna rekomandohet që gjatë përgatitjes së planeve strategjike t'i referohen normave dhe të dhënave kombëtare sipas Strategjisë të Republikës së Kosovës për Mbeturinat dhe Planit të Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave ku përllogaritet gjenerimi 0.9 kg/banorë/ditë për zonat urbane dhe gjenerim 0.4 kg/banorë/ditë për zonat rurale, apo mesatarisht 0.78 kg/banorë/ditë, si edhe njeherësh t'i referohen raporteve mbi sasinë totale të deponimit të mbeturinave.

Gjatë periudhës 2019- 2020, prej zyrtarëve të kompanisë KRM."EKO Regjioni" u grumbulluan të dhënat të nevojshme lidhur me sasinë e mbeturinave të grumbulluara në nivel komunal. Në bazë të këtyre të dhënave, duke iu referuar matjeve sipas metodave përkatëse dhe studimeve sipas raporteve të

grumbulluara për këtë Komunë janë gjeneruar rezultate të besueshme për të ndërtuar strategjitë e ardhshme për menaxhimin e mbeturinave sipas rrymave të fraksionit të tyre.

Sipas të dhënave të grumbulluara, sasia totale e mbeturinave të grumbulluara për vitin 2020 janë depozituar rreth 8093 ton mbeturina në deponinë regjionale të Landovicës prej kompanisë "EKO Regjioni". Shprehur në muaj rreth 674,5 ton në muaj janë grumbulluar prej shërbimit në komunën e Rahovecit apo 22,5 ton në ditë mbeturina janë gjeneruar prej banorëve në komunë.

Duke marrë në konsideratë që grumbullimi i mbeturinave kryhet me shtrirje 100% mbulueshmëri shërbimi si edhe duke konstatuar prej informatave të kompanisë ku 70% e sasisë së mbeturinave të deponuara janë mbeturina të amvisërisë (edhe pse nuk ka ndonjë matje të saktë, andaj në konsideratë do të merret sasia totale he banorët resident në këtë periudhë të matjes), kryesisht prej amvisërive residente (8221 ekonomi familjare residente apo 56 208 banorë) referuar situates do të konsiderojmë që, përafrojmë që rreth 0.56 kg në ditë është norma mesatare e gjenerimit për kokë banori në Komunën e Rahovecit.

Përlllogaritja e normes së gjenerimit të mbeturinave për kokë banori është variabël i ndryshueshëm që varet prej sjelljes së konsumatorit dhe faktorë të tjerë andaj rekomandohet komuna që analizën e gjenerimit të mbeturinave ta zhvillojë në kampione të caktuar në ekonomi familjare, biznese apo institucione në zona urbane dhe zona rurale.

Analiza e saktë e gjenerimit të mbeturinave për kokë banorë është indikator përcjellës i të gjitha analizave të rrymave sipas fraksioneve në planin e menaxhimit të integruar të mbeturinave komunale.

Tabela 22 Gjenerimi i mbeturinave për banor në komunë të Rahovecit referuar sasisë së deponimit (periudhë gjashtë mujore)

Numri i amvisërive totale ASK	Numri i popullsisë ASK 2011	Numri i amvisërive të shërbyera residente	Numri i përafërt banorëve në ekonomi familjare residente të Rahovecit	Sasia totale e mbeturinave amvisëri, biznese dhe institucione Periudha e llogaritjes 6 mujore (ton)	Sasia mesatare e gjenerimit të mbeturinave për kokë banori		
					Ditë kg/ditë	Muaj kg/muaj	Vit kg/muaj
8221	56208	5817	39772	4047	0.56	16.8	201,6

Referuar këtyre të dhënave sasia e mbeturinave të gjeneruara për kokë banori në muaj për vitin 2020 është 201,6 kg, ndërsa për ditë është rreth 0.56 kg. Krahasimi i këtyre rezultateve me normën mesatare të përlllogaritjes të ofruar prej nivelit qëndror sa i përket shkalles së gjenerimit të mbeturinave për tërë Kosovën (mesatarja e llogaritur sipas agjensionit 0.78 kg mbeturinë/ditë/banorë, zona rurale 0.4 kg në ditë) ka dallim duke marrë në konsideratë karakterin gjysëm urban të komunës duke gjeneruar 0.220.56 kg me pak mbeturinë në ditë për kokë banori.

Kjo përlllogaritje merr në konsideratë vetëm llojin e mbeturinave të amvisërisë të grumbulluara dhe raportuara prej KRM "EKO Regjioni", grumbullimi i së cilës konsiston vetëm për rrymën e mbetjeve të amvisërisë (jo rryma tjera të mbeturinave si psh mbetje voluminoze, prishjeve etj).

7.3 Përbërja e mbeturinave në komunën e Rahovecit

Analiza e përbërjes së mbeturinave (analiza mercologjike / analiza e fraksioneve) komunale shërben kryesisht për të përcaktuar përbërjen e mbeturinave komunale dhe më konkretisht duke përcaktuar sasinë (peshën ose %) e fraksioneve të mbeturinave të riciklueshme, të kompostueshme apo mbeturinave të llojeve të tjera që gjenden brenda rrymës së mbeturinave komunale.

Përmes këtyre të dhënave do të mund të përcaktohet potenciali i mbeturinave komunale që mund të reduktohet, ripërdoret, kompostohet apo të trajtohet me teknika të tjera për përfitim energjie sipas skenarëve dhe opsioneve praktike, ekonomike për trajtimin dhe menaxhimin e mbeturinave të ngurta urbane sipas objektivave zhvillimore.

Aktualisht nuk ka asnjë matje të rrymave të mbeturinave sipas llojit që gjenerohen në territorin e kësaj komune. Studime të mëparshme të kryera në zona3 me tipologji të përafërt mund të na japin një pamje të përafërt të gjenerimit të këtyre rrymave edhe për Komunën e Rahovecit.

Sipas analogjisë, Vlerësimi i sasisë së mbeturinave në përgjithësi dhe sasisë sipas fraksioneve, të cilat gjenerohen është bazuar mbi të dhënat e Komunës së Rahovecit si dhe rezultatet e matjeve dhe të analizës së mbeturinave që janë organizuar nga GIZ në vitin referent 2012 në komunën e Prishtinës. Gjatë studimit të përbërjes së mbeturinave të marrura në burim, kampionët e analizuar të mbeturinave janë marrë në zona të caktuara dhe kohë të caktuara.




Figure 8. Diagrama e përbërjes së mbeturinave (raporti GIZ 2012/ AMMK 2014)

Duke u bazuar në rozen e përbërjes së mbeturinave (raporti GIZ 2011), përbërja mercologjike e mbetjeve është paraqitur në tabelën që vijon:

Tabela 23. Përbërja e mbeturinave në komunën e Rahovecit sipas gjenerimit

Mbeturina	%	Sasia ditore sipas fraksionit	Sasia ditore	Sasia vjetore Komuna Rahovec
-----------	---	-------------------------------	--------------	------------------------------

PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

		~	Gjenerimi i mbeturinave për (muaj /banorë)	(ton/vit/2020)
Totali mbeturina	100.00%	0.56 kg/ditë	~16,8 kg/muaj	8093.00
Teinjoma	40.87%	~ 0.71	6,87kg	3307,60
Të riciklueshme ¹	33.24%	~ 0.59	5,95kg	2690
Te tjera	25.89%	~ 0.46	~4,34kg	2095

Sasia e biodegradueshme organike është në përqindje më të lartë duke çuar drejt mundësisë së prezantimit të skemave të kompostimit të mbeturinave, kryesisht në zonat me shtëpi private apo në zonat rurale me kapacitet më të lartë për kompostim. Duhet të marrim në konsideratë që ky fraksion i mbeturinave (mbeturina organike) duke përfshirë edhe mbeturinat e gjelbra dhe të kafta prej hapësirave të gjelbëruara mund të variojë prej 41-70 % të përbërjes së mbeturinave totale komunale që gjenerohen në vit.

Tabela 24.Përbërja e mbeturinave të fraksionit të thata/të riciklueshme

Mbeturina	%	Sasia ditore sipas fraksionit	Sasia ditore	Sasia vjetore Komuna Rahovec
		~	Gjenerimi i mbeturinave për (muaj /banorë)	(ton/vit/2020)
Totali mbeturina	100.00%	0.56 kg/ditë	~16,8 kg/muaj	8093.00
Të riciklueshme ²	33.24%	~ 0.18	5,58kg	2690
Leter / Karton	12.83%	0.07	2,15kg	1038
Plastike	14.78%	0.08	2,48kg	1196
Qelq	4.45%	0.02	0,74kg	360
Metale	1.18%	0.006	0,19kg	95,5

Për sa i takon mbeturinave të riciklueshme, letra, karton, plastika, qelqi përfaqësojnë një përqindje të konsiderueshme duke krijuar mundësinë e prezantimit dhe aplikimit të skemave për grumbullimin e ndarë të tyre dhe konsolidimin e një pikë të sortimit të mbetjeve të riciklueshme në komunën e Rahovecit. Gjithësesi lind nevoja që periodikisht (1-2 herë në vit) këto matje të ribëhen për të pasur një pasqyrim më të qartë dhe të përditësuar të gjenerimit në përqindje të rrymave të mbeturinave, veçanërisht për të konstatuar Mbeturinat e rrezikshme, si Mbeturinat spitalore apo industriale që hyjnë në rrjedhën e mbeturinave në nivel lokal, me qëllim trajtimin e çeshtjes nga autoritetet lokale dhe qendrore.

PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

Lidhur me mbeturinat inerte, nuk posedohet ndonjë matje sasiore e saktë për përlogaritjen e tyre, andaj kjo sasi nuk merret në konsideratë në përlogaritjet e mësipërme. Referuar raportimit vjetor të komunës së Rahovecit pranë AMMK, Komuna e Rahovecit ka eliminuar në vitin referent 2019 rreth 20 deponi ilegale të dimensioneve të ndryshme, megjithatë prezente janë 13 deponi sepse janë eliminuar gjatë gushtit 2021 rreth 7 sosh. Kryesisht sasia e deponive ilegale varion sipas madhësisë dhe do të ndahet në:

Tabela 25. Karakteristikat e përbërjes së deponive ilegale në komunën e Rahovecit

Karakteristikat e deponive	Sasia në numër	Sasia në përqindje
Mbeturina të amvisërisë (A)	6	30
Mbeturina inerte / ndërtimore (N)	4	20
Mbeturina industriale dhe të rrezikshme (R)	-	
Mbeturina të vëllimshme (V)	-	
Mbeturina të përziera (A, N, R, V)	10	50.00 %
Totali	20	100.00 %

7.4 Projektioni i rritjes së sasisë së mbeturinave 2022 – 2026

Parashikimi i prodhimit të mbeturinave në të ardhmen lidhet ngushtë me rritjen e numrit të popullsisë në të shkuarën (Norma vjetore e rritjes në të shkuarën e llogaritur duke iu referuar tendencës së rritjes së popullsisë) si dhe prirjet për prodhimin e mbeturinave në të ardhmen.

Bazuar në dokumentet zyrtare të Republikës së Kosovës, indeksi i rritjes së popullsisë parashikohet të jetë afërsisht 1% ku merret parasysh rritja e natyrshme por edhe migrimi dhe emigrimi. Në tabelën më poshtë parashikohet një trend i rritjes së popullsisë dhe sasisë së mbeturinave komunale në Komunën e Rahovecit gjatë 10 viteve të ardhshme.

Tabela 26. Rritja e popullsisë dhe sasisë së mbeturinave komunale në Komunën e Rahovecit gjatë 5 viteve të ardhshme

Viti	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Projeksi i rritjes së popullsisë								
Gjerimi për banor kg/dite			0.83					
Projeksi i rritjes së sasisë së mbeturinave % (viti referent 2020)				0.01	0.013		0.064	

Tabela 27. Gjenerimi i mbeturinave

PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

Viti		2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Gjerimi për banor kg/dite	2% rritje në kokë/banor			0.83	0.84				0.88
Gjerimi për banor kg/vit	2% rritje në kokë/banor			302.9	306.6				321.2

Nga tabela më lart vërejmë që parashikimet për rritje të sasisë së mbeturinave për vitin 2021 do të jenë 306.6 kg/vit dhe 0.84 kg.ditë për kokë banorë, ndërsa në vitin 2025 sasia do të arrijë kuotën prej 321.2 kg/vit apo përafërsisht 0.88kg/ditë për kokë banori.

Bazuar në potencialin e rritjes së popullsisë, në normat e rritjes së gjenerimit të mbeturinave dhe kapacitetit të gjenerimit të mbeturinave, do të mund të bëhet një llogaritje e sasisë totale sipas rrymës së gjenerimit të mbeturinave në nivel komunal:

Tabela 28.Llojet e mbeturinave vjetore të gjeneruara në Komunën e Rahovecit

		2020	2021	2022	2023	2024	2025
Projeksi i rritjes së popullsisë	Nr popullsisë	x					
Potenciali i gjenerimit të sasisë totale të mbeturinave	ton/vit						
Koeficienti i gjenerimit të mbeturinave për kokë banori		0.83					
Fraksioni Organik	~ 0.41						
Fraksioni të thata	~ 0.33						
Fraksioni të tjera	~ 0.26						




Figure 9. Rritja e sasisë së mbeturinave deri 2025 sipas fraksioneve të gjeneruara në Komunën e Rahovecit

Të paraqitura në diagram vërejmë tendencën e rritjes së sasisë së mbeturinave të riciklueshme sipas fraksioneve, dhe potencialin përbërës së mbeturinave totale që mundën të ofrojnë në industrinë e riciklimit.

Nga parashikimi (tabela më poshtë) pritët që të rritet sasia e letrës, plastikës, dhe e mbeturinave të jo-degradueshme (p.sh. metali dhe qelqi). Nga ana tjetër, këto rritje mund të rrisin vlerën kalorifike dhe potencialin riciklues të këtij fraksioni të mbeturinave të prodhuara. Në të njëjten kohë, sasi të relative të gjethëve, mbetjeve drusore kanë gjasa të jenë të vlerave më të mëdha duke marrë në konsideratë tipologjinë e komunës me prezencë të lartë të hapësirave të gjelbra të cilat në mënyrë konstante kërkojnë përkujdesje në pastrimin e rregullt të tyre.

Tabela 29. Përbërja vjetore e mbeturinave të amvisërisë (2020)

Mbeturina	%	Sasia ditore sipas fraksionit	Sasia ditore	Sasia vjetore Komuna Rahovec (ton/vit/2020)
		~	Gjenerimi i mbeturinave për (muaj/banorë)	
Totali mbeturina	100.00%	0.83 kg/ditë	~1 kg/muaj	3317286.26
Organike	40.87%	~0.41	7.8 kg	
Të riciklueshme ³	33.24%	~0.33	6.27 kg	
Letër / Karton	12.83%	0.13	2.47 kg	
Plastike	14.78%	0.15	2.85 kg	
Qelq	4.45%	0.04	0.76 kg	
Metale	1.18%	0.01	0.19 kg	
Të tjera	25.89%	~0.26	~4.93 kg	




Figure 10.Fraksionet e mbeturinave në vit (2020)

8. PLANI FINANCIAR I SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE

8.1 Kosto e shërbimit 2022-2026

Kosto e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave ndahet sipas llojit të shpenzimit dhe veprimtarisë së shërbimit që kryhet përmes tij, në zërat e mëposhtëm:

A. *Kosto operative*

- a. Kostot e mirëmbajtjes: mjete të shërbimit
- b. Kostot e grumbullimit: karburant i përdorur gjatë shërbimit
- c. Kosto transporti: karburant i përdorur gjatë shërbimit
- d. Kosto depozitimi: shpenzimet për trajtimin e mbetjeve në deponi
- e. Kosto personeli: shoferë dhe punëtorë
- f. Kosto amortizimi: mjete të shërbimit
- g. Kosto larje dhe dezinfektim: për kontenerët

B. *Kosto kapitale*

- a. Kosto e blerjes së mjeteve të shërbimit

Në realizimin e shërbimit marrin pjesë, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, dhe drejtues e nëpunës specialistë të bashkisë, shpenzimet për të cilët vlerësohen në masën 8 % të koston operative dhe përfshihen në zërin:

C. *Kosto administrative*

Referuar kostove indirekte dhe administrative përfshijnë pagat indirekte të KRM EKO Regjioni, shpenzimet administrative si dhe kostot e tjera për aktivitete profesionale për nevoja të kompanisë (fushatave vetëdijësuese etj). Duke u bazuar në situatën referente se KRM EKO Regjioni ka të angazhuar një staf të madh administrativ referuar parallogaritjeve, për rrjedhojë plani nuk parasheh ngritje të mëtejme të kostove administrative përgjatë periudhës planifikuese si në regrutimin e stafit të ri ashtu edhe në shpenzimet përcjellëse.

D. *Të ardhurat net të planifikuara*

Të hyrat e shërbimit i referohen të hyrave nga grumbullimi i mbeturinave, shërbimeve sekondare dhe shërbimeve tjera sipas kontratave të veçanta dhe këto të hyra realizohen përmes KRM EKO Regjioni.

E. *Kosto e menaxhimit të mbeturinave*

Llogaritja e kostove të mësipërme është në përputhje me metodën e Llogaritjes së Kostos së Plotë dhe në zbatim të Planit Teknik dhe Operacional të realizimit të shërbimit për menaxhim të mbeturinave. Këtu përfshihen të gjitha kostot e menaxhimit të mbeturinave përfshi kostot e grumbullimit, pastrimit dhe deponimit që barten nga KRM EKO Regjioni si dhe kostot e ndarjes, riciklimit dhe procesimit të mbeturinave që mbarten nga Komuna apo palë të treta të kontraktuara.

8.2 Kosto operative të shërbimit

Kostot operative vjetore të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave për vitet 2020-2025, me TVSH, paraqiten në tabelën në vijim, duke marrë si referent planifikimet financiare deri më tani dhe shpenzimet operative të ndërmarrjes në periudhë gjashtë mujore të vitit kalendarik 2019.

Tabela 30.Shpenzime operative

	Kosto derivate	Kosto direkte indirekte dhe administ.	Kosto administrative	Kosto mirëmbajtje	Kosto deponim	Totali kosto operative
Planifikimi i shpenzimeve 2019	x	116,235 €	6,975	15,266	12,720 €	200,169.00
Shpenzime referent 01.07.2019-31.12.2019	17,130.55	71,713.15	5,681.21	10,736.60	9,696.13	114957.64
Shpenzime vjetore sipas vlerave të kompanisë	37 686***	143,426.3**	11,362.42	21,473.2	12 720*	213,948.00
						224,645.4****

*duke marrë në konsideratë shtrirjen e menjëhershme të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në fund të vitit 2019

**Rritja e kostove indirekte varion sipas kontrateve sekondare të kompanisë me komunë

***10% e totalit të kostos referente shpenzime të derivateve të paraqitur prej KRM EKO Regjioni e shtuar në përlogaritje

****5% mbi kosto totale, kjo vlerë ka për qëllim të korrigjojë vlerat në vite të zërave të kësaj kostoje, llogaritur mbi bazën e çmimeve aktuale, me inflacionin mesatar vjetor të mundshëm, si dhe me shumën e një fondi rezervë i cili duhet të mbulojë shpenzime të papritura ose në rritje për arsye të tjera të paparashkueshme

Referuar kostove bazë referente në tabelën më poshtë parashihet projeksioni i kostove operative për periudhë kohore 2020-2025.

8.3 Kosto kapitale

Kosto kapitale përfaqëson investimin në automjete dhe pajisje ku respektivisht për Komunën e Rahovecit do të përfshijnë kostot për:

- Realizimin e shërbimit të bartjes së mbeturinave, të cilat përfshijnë kontenierë, kamionë që do të përdoren për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave.
- Realizimin e infrastrukturës për deponinë inerte
- Realizimin e infrastrukturës për qendrën e grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme
- Realizimin e infrastrukturës për përcjellëse për qendrën e reduktimit dhe riciklimit të mbeturinave
- Sigurimin e kontenierëve për ndarje në burim, përfshirë enët kompostuese (sipas sistemit të decentralizuar)

Kostot investive për realizimin e shërbimit të bartjes së mbeturinave

KRM EKO Regjioni posedon gjithsej 9 kamionë, të janë në gjendje të amortizuar dhe sit ë tillë duhet të parashihen të zëvendësohen ndër vitet në vijim. Plan i investiv është bazuar në nevojat e përlogaritura sipas nevojave të KRM EKO Regjioni dhe kapacitetit të punës së kamionëve ekzistues. Sipas situatës së paraqitur, do të nevojiten 3 kamionë ndër të cilët një me kapacitet 16 ton dhe 2 të tjera me kapacitet 10 ton.

Kostot investive për Sigurimin e kontenierëve për unifikim të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave

Aktualisht KRM EKO Regjioni posedon infrastrukturë në gjendje të mirë për zbrasjen e mbeturinave në kontenierë si rezultat i ndihmës financiare prej anës së donatorëve dhe komunës për sigurimin me infrastrukturë për realizimin e shërbimeve të zbrazjes së mbetjeve. Megjithatë me qëllim unifikimin e sistemit të grumbullimit komuna dhe kompania duhet të planifikojnë sigurimin e 6000 kontenierëve 120 l për grumbullim të mbeturinave, shpërndarja e të cilave do të bëhet sipas planeve për plotësim me infrastrukturë për shërbim të grumbullimit të mbeturinave.

Kostot investive për Realizimin e infrastrukturës për deponinë inerte

Në këtë kosto do të përfshihen kostot e investimit në funksionalizimin e lokacionit të planifikuar për deponimin e përkohshëm të mbeturinave inerte, lokacion ky i cili duhet të përshtatet me kushtet bazike për operim të sigurtë. Duke qenë se komuna parasheh të marrë përsipër këtë kosto, kjo nënkupton që ndarja e kostove mund të variojë sipas mundësive investive prej anës së komunës respektivisht buxhetit të sektorit.

Kostot investive për Realizimin e infrastrukturës për qendrën e grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme dhe të riciklueshme

Në këtë kosto do të përfshihen kostot e investimit në funksionalizimin e lokacionit të planifikuar për deponimin dhe trajtimin e përkohshëm të mbeturinave të vëllimshme. Funksionalizimi i një pike grumbulluese të përkohshme për mbeturinat voluminoze mund të planifikohet në një fazë të parë të bëhet pranë deponisë inerte për tu ndërtuar dhe plotësuar më tutje në qendrën për reduktim dhe riciklim të mbetjeve. Duke marrë parasysh se komuna synon të nisë programet e riciklimit, relativisht në koston e investimit do të planifikohet edhe infrastruktura bazike për zhvillimin e aktivitetit të sortimit dhe paketimit të mbeturinave të riciklueshme përfshirë këtu edhe investimin në mjet grumbullues.

Kostot investive për Realizimin e infrastrukturës përcjellëse për qendrën e reduktimit dhe riciklimit

Referuar politikës nacionale sipas Strategjisë për menaxhim të integruar të mbeturinave, planifikimet e komunës sipas zërave të kostove do të adresohen në ndërtimin e infrastrukturës përcjellëse që ndihmojnë në ngritjen e sistemeve të qëndrueshme të trajtimit të mbeturinave sipas llojeve. Këtu do të parashihen kostot e investimit për ndërtimin e qendrës për reduktim dhe riciklim të mbeturinave sipas planifikimit të detajuar për zbatimin e tij. Shpërndarja e kostove do të bëhet sipas fazave bazuar në kapacitetet komunale për investim të tillë.

Kostot investive Sigurimin e kontenierëve dhe infrastrukturës për ndarje në burim, përfshirë dhe enët kompostuese

Në këtë kosto do të përfshihen kostot e investimit të infrastrukturës përcjellëse për zbatimin e ndarjes në burim sipas programeve të riciklimit dhe kompostimit përmes sistemeve të decentralizuara në nivel

komunal. Sipas linjave të investimit do të përlogariten kostot e sigurimit të shportave për ndarje në burim dhe enëve kompostuese.

Sic projeksiioni i investimeve do të zhvillohet me synim të përgatitjes së Komunës për nisjen dhe zbatimin e politikave nacionale për reduktim riciklim të mbeturinave, duke synuar trajtimin adekuat të mbetjeve sipas llojit të tyre. Kjo do të nënkuptojë që deri në vitin 2025 synimet e Komunës së Rahovecit do të paraprijnë procesin duke krijuar infrastrukturën përcjellëse për trajtimin e mbetjeve inerte, mbetjeve të vëllimshme, të riciklueshme sipas fraksioneve duke përfshirë dhe kompostimin central të mbetjeve organike. Kjo do të nënkuptojë që përtej peridhës kohore prej vitit 2025 komuna posedon potencial infrastrukturor që të harmonizojë dhe zgjerojë planet e reduktimit dhe riciklimit të mbeturinave në njësi territoriale dhe të zhvillojë potencial dhe për mundësinë e bashkëpunimit me komunat përreth përmes qendrës të riciklimit dhe kompostimit.

Kosto shtesë

Përkrah koston së shërbimit të menaxhimit të mbeturinave, një buxhet shtesë është i nevojshëm të parashikohet për disa shpenzime mbështetëse të cilat kanë për qëllim përmbushjen e objektivave të qëndrueshmërisë financiare. Këto shpenzime mbështesin veprimtaritë e komunës si më mëposhtë:

1. Ndërgjegjësim dhe edukimi i banorëve për mbrojtjen e mjedisit

Kjo veprimtari planifikohet të mbështesë rritjen e efektivitetit të mbledhjes së të ardhurave të shërbimit nga subjektet pages, në masën e përmbushjes së objektivave të vendosur në këtë drejtim, të paraqitur si më sipër. Plani i veprimit parashikon shpenzime vjetore shtesë gjatë gjithë periudhës 2021 - 2025, të cilat mund të shtrihen dhe në periudha të mëvonshme, në varësi të objektivave të mëtejshme të komunës së Rahovecit.

2. Ngritja e bazës së të dhënave të subjekteve pages

Një bazë të dhënash mbi subjektet gjeneruese të mbetjeve, në formatin e një programi kompjuterik, është një instrument i domosdoshëm për vënien në zbatim të sistemit të tarifimit të shërbimit të menaxhimit të tyre dhe rritjes së efektivitetit të mbledhjes së të ardhurave nga tarifa. Një identifikim i saktë i këtyre subjekteve: vendndodhjes së tyre, madhësisë e gjendjes financiare të tyre, llojit të aktivitetit në rast biznesi etj. i mundëson autoriteteve vendore ndjekjen e rasteve të subjekteve që nuk paguajnë dhe zbatimin efektiv të masave shtrënguese. Edhe në këtë rast, KRM EKO Regjioni dhe komuna e posedojnë një system të databazës sipas të dhënave të adresave, baza e të dhënave duhet t'i shërbejë drejtpërdrejt përmbushjes së objektivave të vendosur për rritjen e % së mbledhjes së të ardhurave të shërbimit, me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë financiare.

Baza e të dhënave duhet të përditësohet çdo vit kalendarik dhe mund të përdoret për ndërlidhjen e listave të klientëve dhe tarifimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, në rast të përshtatshëm.

8.4 Kostot investive për realizimin e PKMM

Tabela 31. Tabela përmbledhëse e investimit

Investimet e parapara në PKMM, për vitin 2021 - 2025					
Investimi i planifikuar	Nr. i	Kostoja njësi	Kostoja totale	Qëllimi i investimit	Përputhshmëria sipas objektivave të PKMM
Kosto e investimeve për kontenierë 120l plastikë	6000	18	108,000	Sipas skemës së shërbimit derë më derë, sigurimi i kontenierëve i referohet planit të komunës për unifikim dhe plotësim të sistemit të grumbullimit referuar politikave komunale për rritje të shkallës së pagesës dhe nr të kontratave.	O1: Të optimizojë shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve në mënyrë të unifikuar që garanton optimizim të kostove dhe shërbimit në komunën e Rahovecit.
Kosto për kamionë për grumbullim me kapacitet 7-10 ton	2	Cmim variabël		Bazuar në gjendjen fizike dhe vjetërsisë të kamionëve me të cilët operon KRM EKO Regionit, rekomandohet që kjo kompani të zëvendësojë apo plotësohet me 3 kamionë për operim. kjo do të synojë të ngrisë cilësinë e shërbimit sipas operimit të rregullt dhe të reduktojë kostot operative dhe të mirëmbajtjes. Sipas praktikës prej komunës, çmimi në kosto parasheh furnizim me kamionë të përdorur.	O1: Të optimizojë shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve në mënyrë të unifikuar që garanton optimizim të kostove dhe shërbimit në komunën e Rahovecit.
Kosto kamion mbeturina riciklueshme me kapacitet 16 ton	1			Të sigurojë në mënyrë graduale infrastrukturën për zbatimin e skemës për ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar për të përmbushur objektivat kombëtare për reduktimin e mbetjeve. Sipas praktikës prej komunës, çmimi në kosto parasheh furnizim me kamionë të përdorur.	O3: Të garantojë grumbullimin në masën maksimale të sasisë së mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës O4.5 Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave të riciklueshme
Kontenierët për riciklim dhe ndarje në burim/sistem parësor 240 l ngjyrë e verdhë	500	25	12,500	Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në deponi përmes aktivitetit të (ndarjes në burim) të fraksionit të thata -riciklueshme dhe organike për zbatimin e aktivitetit të kompostimit. Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në deponi përmes aktivitetit të riciklimit në 500 ekoriomi familjare/bisnese	O3: Të garantojë grumbullimin në masën maksimale të sasisë së mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës

PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

Kontenierët për riciklim dhe ndarje në burim/sistem dytësor Rrjetë metalike/kontenie të posaçëm për riciklim				Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në deponi përmes aktivitetit të (ndarjes në burim) të fraksionit të thata -riciklueshme dhe organike për zbatimin e aktivitetit të kompostimit. Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve në 5 institucione edukative dhe në 5 lokacionet e pikave të grumbullimit në qytet	Q3: Të garantojë grumbullimin në masën maksimale të sasisë së mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës
Funksionalizimi i Qendrës Për ndarje,grumbullim dhe riciklim				Bazuar në menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave sipas objektivave të parapara në strategjinë kombëtare për Menaxhim të integruar të mbeturinave dhe zgjidhjes së problematikës së komunës për mbetjet e vëllimshme dhe objektivave të komunës për zbatimin e programeve për reduktim dhe riciklim të mbetjeve,zvogëlim të ndotjes dhe kostove të deponimit, me qëllim që sistemi të jetë i qëndrueshëm komuna duhet të parashohë trajtimin e mbetjeve të vëllimshme dhe të riciklueshme. Njësia për mbetje të vëllimshme do të ndihmojë në krijimin e një sistemi të integruar për banorët e komunës. Përmes këtij investimi realizohet ndërtimi i pjesshëm i qendrës(mbulesës dhe dhomat e magazinimit). Ky investim nuk përfshin kosto të tokës pasi që lokacioni parashihet në pronë komunale dhënë në shfrytëzim KRM EKO Regjioni.	Q4: Të realizojë grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimin të veçantë dhe zvogëlimin të sasisë që përfundon në deponi O.4.4 Grumbullimi dhe transportimi i veçantë i mbeturinave të vëllimshme O.4.5 Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave të riciklueshme
Deponia e materialeve inerte (punime ndërtimi,infrastruktur dhe shtrim i rrugës)		Çmime sipas njësive të kostove		Bazuar në menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave,objektivave kombëtare sipas Strategjise për menaxhim të integruar të Mbeturinave dhe zgjidhjes së problematikës së komunës për mbetjet inerte,komuna do të parashohë ndërtimin e lokacionit për deponi inerte dhe funksionalizimin bazik të tij,bazuar legjislacionit për lokacionet/deponitë ndër të tjerash lokacioni duhet ti përmbajë kriteret e përcaktuara dhe të ketë qasje rrugore për funksionim. Kosto e investimeve pra nuk përfshin kostot e tokës por kostot për ndërtimin e rrugës për në deponi dhe kosto të ndërtimit të deponisë.	Q4: Të realizojë grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave sipas llojit me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimin të veçantë dhe zvogëlimin të sasisë që përfundon në deponi
Programi për vetedijësim dhe ngritje të kapaciteteve					

PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIMI TË MBETURINAVE

Totali 2022 - 2025					
Investimet e parapara në PKMM për vitin 2022 - 2025					
Investimi i planifikuar	Sasia	Kostoja njësi	Kostoja totale	Qëllimi i investimit	Përputhshmëria sipas objektivave të PKMM
Kontenerët për riciklim dhe ndarje në burim/sistem parësor 240 l ngjyrë e verdhe	600	25	15,000	Sipas objektivave dhe strategjisë nacionale, Komuna Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në deponi përmes aktivitetit të (ndarjes në burim) të fraksionit të thata – riciklueshme. Zbatimi i skemës së riciklimit të fraksionit të thatë do të zgjerohet në 500 anvisëri shtesë sipas zgjerimit gradual të skemës së riciklimit.	Q3: Të garantojë grumbullimin në masën maksimale të sasisë së mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës
Kontenerët për riciklim dhe ndarje në burim/sistem dytësor Rrjetë metalike/konteniere të posaçëm për riciklim	20	200	4,000	Sipas objektivave dhe strategjisë nacionale, Komuna Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në deponi përmes aktivitetit të (ndarjes në burim) të fraksionit të thata – riciklueshme. Zbatimi i skemës së riciklimit të fraksionit të thatë do të zgjerohet në 20 institucionet edukative në komunë.	Q3: Të garantojë grumbullimin në masën maksimale të sasisë së mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës
Ndërtimi i qendrës për ndarje të mbetjeve të vëllimshme dhe aktivitete për riciklim		Cmime sipas njësive të kostove	100 000	Bazuar në menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave sipas objektivave të parapara në strategjinë kombëtare për Menaxhim të integruar të mbeturinave dhe zgjidhjes së problematikës së komunës për mbetjet e vëllimshme dhe objektivave të komunës për zbatimin e programeve për reduktim dhe riciklim të mbetjeve, zvogëlim të ndotjes dhe kostove të deponimit, me qëllim që sistemi të jetë i qëndrueshëm komuna duhet të parashohë trajtimin e mbetjeve të vëllimshme dhe të riciklueshme. Njësia për mbetje të vëllimshme do të ndihmojë në krijimin e një sistemi të integruar për banorët e komunës. Përmes këtij investimi realizohet ndërtimi i pjesshëm i qendrës (mbulesës dhe dhomat e magazinimit). Ky investim nuk përfshin kosto të tokës pasi që lokacioni parashihet në pronë komunale dhënë në shfrytëzim KRM EKO Regjioni.	Q4: Të realizojë grumbullimin, transportimin dhe ndarjen e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimin të veçantë dhe zvogëlimin të sasisë që përfundon në deponi Q4.4 Grumbullimi dhe transportimi i veçantë i mbeturinave të vëllimshme Q4.5 Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave të riciklueshme
Pajisje për përpunim të mbetjeve inerte		Cmime sipas njësive të kostove		Plotësimi me infrastrukturë operative në deponinë për inerte ku do të bëhet trajtimi i materialit inert me qëllim rishfrytëzimin e materialeve ndërtimore dhe uljen e impaktit mjedisor prej deponimit të tyre në lokacion. Në këtë qendër KRM EKO Regjioni do të zhvillojë aktivitetin e selektimit dhe presimit të mbetjeve të riciklueshme.	Q4: Të realizojë grumbullimin, transportimin dhe ndarjen e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimin të veçantë dhe zvogëlimin të sasisë që përfundon në deponi Q4.3 : Menaxhim i qëndrueshëm i mbeturinave

PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

					ndërtimore
Totali Kosto Investive në 2022					
Investimet e parapara në PKMM për vitin 2023					
Investimi i planifikuar	Sasia	Kostoja njësi	Kostoja totale	Qëllimi i investimit	Përputhshmëria sipas objektivave të PKMM
Kontenerët për riciklim dhe ndarje në burim/sistem parësor 240 l ngjyrë e verdhë				Sipas objektivave dhe strategjisë nacionale, Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në deponi përmes aktivitetit të (ndarjes në burim) të fraksionit të thata – riciklueshme. Zbatimi i skemës së riciklimit të fraksionit të thatë do të zgjerohet në 1400 amvisëri shtesë	O3: Të garantojë grumbullimin në masën maksimale të sasisë së mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës
Ene për kompostim shtëpiak (sistem i decentralizuar)	150	50	7,500	Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në deponi përmes aktivitetit të (ndarjes në burim) të fraksionit organike për zbatimin e aktivitetit të kompostimit. Zbatimi i skemës së kompostimit të fraksionit të thatë do të nisë në 500 amvisëri në zonë urbane dhe rurale ku synohet rreth 40% e gjenerimit ditor në këto amvisëri të reduktohet, duke nënkuptuar reduktim të kostove operative dhe të deponimit.	O3: Të garantojë grumbullimin në masën maksimale të sasisë së mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës O.4.6 Grumbullimi dhe trajtimi i veçantë i mbeturinave organike për kompostim fraksioni organike
Qendra për ndarje dhe riciklim		Crime sipas njësive të kostove		Plotësimi me infrastrukturë operative në qendrën e grumbullimit dhe magazinimit. Në këtë qendër KRM EKO Regionit do të zhvillojë aktivitetin e selektimit dhe presimit të mbetjeve të riciklueshme.	O4: Të realizojë grumbullimin, transportimin dhe ndarjen e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvogëlimin të sasisë që përfundon në deponi O.4.4 Grumbullimi dhe transportimi i veçantë i mbeturinave të vëllimshme O.4.5 Grumbullimi dhe trajtimi i veçantë i mbeturinave të riciklueshme

PLAN KOMUNAL PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

Pajisje për përpunim të mbetjeve inerte		Crime sipas njësive të kostove	Nga donacionet	Plotësimi me infrastrukturë operative në deponinë për inerte ku do të bëhet trajtimi i materialit inert me qëllim rishfrytëzimin e materialeve ndërtimore dhe uljen e impaktit mjedisor prej deponimit. Në këtë qendër KRM EKO Regjioni do të zhvillojë aktivitetin e selektimit dhe presimit të mbetjeve të riciklueshme. Kjo kosto përfshin vetëm kosto të pajisjeve për zhvillim të aktivitetit në deponi.	O4: Të realizojë grumbullimin, transportimin dhe ndarjen e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvogimit të sasisë që përfundon në deponi O4.3 : Menaxhim i qendrueshëm i mbeturinave ndërtimore
Programi për vetedijësim dhe ngritje të kapaciteteve				Do të organizohet në periudha të rregullta, aktivitete vetedijësuese në shkollë dhe komunitet në bashkëpunim me shoqërinë civile.	
Totali Kosto Investive në 2023					
Investimet e parapara në PKMM për vitin 2024					
Investimi i planifikuar	Sasia	Kostoja njësi	Kostoja totale	Qëllimi i investimit	Përputhshmëria sipas objektivave të PKMM
Konteneri për riciklim dhe ndarje në burim/sistem parësor 240 l'ngjyre e verdhë				Sipas objektivave dhe strategjisë nacionale, Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në deponi përmes aktivitetit të (ndarjes në burim) të fraksionit të thata – riciklueshme. Zbatimi i skemës së riciklimit të fraksionit të thatë do të zgjerohet në 1400 amvisëri shtesë.	O3: Të garantojë grumbullimin në masën maksimale të sasisë së mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës
Enë kompostuese				Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në deponi përmes aktivitetit të (ndarjes në burim) të fraksionit organik për zbatimin e aktivitetit të kompostimit. Zbatimi i skemës së kompostimit të fraksionit të thatë do të nisë në 680 amvisëri në zonë rurale (fshatrat më në largësi) ku synohet rreth 40% e gjenerimit ditor në këto amvisëri të reduktohet; duke nënkuptuar reduktim të kostove operative dhe të deponimit.	O3: Të garantojë grumbullimin në masën maksimale të sasisë së mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës O4.5 Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave organike për kompostim - fraksioni organik

PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

Ndërtimi i qendrës për kompostim lokalitet/deponi		Crime sipas njësive të kostove	Nga donacionet	Krijimi i qendrës për reduktim, riciklim dhe kompostim të mbeturinave do të ndihmojë komunën që të zvogëlojë deri në 70% të sasisë së mbetjeve të deponuara njëherësh trajtimi i mbeturinave përmes aktivitetit të qendrës synon të krijojë të hyra shtesë (përmes shitjes nga riciklimi apo kompostimi) për operatorin (KRM EKO Regionit) me çrast rritjen e efikasitetit dhe performancës së shërbimit. Megjithatë Rahoveci ka hapësira të gjelbra kjo ofron material për kompostim gjatë aktivitetit të pastrimit të tyre kompostim mund të përdoret për qytetarët e komunës për aktivitete bazike të kultivimit. Kjo kosto do të përfshijë investimin bazik për qendrën për kompostim duke u bazuar në investimet në ndërtim dhe pajisjet bazike për zhvillimin e aktivitetit të kompostimit.	04: Të realizojë grumbullimin, transportimin dhe ndarjen e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimin të veçantë dhe zvogëlimin të sasisë që përfundon në deponi 0.4.6 Grumbullimi dhe trajtimi i veçantë i mbeturinave organike për kompostim - fraksion organike
Programi për vetedijësim dhe ngritje të kapaciteteve					
Totali Kosto Investive në 2024 x					
Investimet e parapara në PKMM për vitin 2025					
Investimi i planifikuar	Sasia	Kostoja njësi	Kostoja totale	Qëllimi i investimit	Përputhshmëria sipas objektivave të PKMM
Erie kompostuese	x			Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në deponi përmes aktivitetit të (ndarjes në burim) të fraksionit organike për zbatimin e aktivitetit të kompostimit. Zbatimi i skemës së kompostimit të fraksionit të thatë do të nisë në 291 amvisëri në zonë rurale (fshatrat më në largësi) ku synohet rreth 40% e gjenerimit ditor në këto amvisëri të reduktohet; duke nënkuptuar reduktim të kostove operative dhe të deponimit.	02: Rritja graduale e mbulueshmërisë me shërbime në tërë territorin e komunës së Rahovecit me qëllim të mbulimit të plotë deri në fund të vitit 2019.
Ndërtimi i qendrës për kompostim				Plotësimi i qendrës me pajisje operative për aktivitetin e kompostimit respektivisht, mjete motorrike, pajisje për kosiqe masive dhe për pastrim të hapësirave pyjore, pajisje grumbuese, sita sipas dimensioneve etj.	04: Të realizojë grumbullimin, transportimin dhe ndarjen e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimin të veçantë dhe zvogëlimin të sasisë që përfundon në deponi 0.4.6 Grumbullimi dhe trajtimi i veçantë i mbeturinave organike për kompostim - fraksion organike

PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

Kontenierë për grumbullim të mbetjeve organike 3-5 ton				Me qëllim të furnizimit të njësisë për kompostim me material organik prej mbetjeve të fruta perimeve, komuna parashih vendosjen e kontenierëve të mëdhenj në tregun e fruta perimeve apo në biznes që ka gjenerim të kësaj kategorie të mbeturinës. Kjo ndihmon në aktivitetin e kompostimit dhe përfitimit të plehut cilësor si produkt final.	O4: Të realizojë grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvoglimit të sasisë që përfundon në deponi O4.6 Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave organike për kompostim - fraksioni organike
Shkalla e natalitetit në komunën e Rahovecit është 17.5 promil apo 1.75 %. Shkalla e mortalitetit është 2.3 promil apo 0.29 %. Në bazë të këtyre shkalleve të natalitetit dhe mortalitetit del se shtimi natyror i popullsisë në komunë është 14.6 promilë apo 1.46 %..

8.2.7 Jetëgjatësia

Statistikat tregojnë se popullsia kosovare jeton mesatarisht diku rreth 76.7 vite (REKOS 2011) derisa parashikimet për vitin 2021 ishin rritje në rreth 80 vite.

8.2.8 Migrimi

Të dhënat dhe statistikat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës tregojnë se në komunën e Rahovecit ekziston një rritje e vazhdueshme e migrimit kombëtar dhe ndërkombëtar.

Numri i personave që kanë migruar jashtë Komunës në Komunat fqinje si Gjakovë, Prizren dhe Prishtinë është i madh. Ndërsa numri i emigrantëve që kanë emigruar jashtë vendit si në vendet e Evropës Perëndimore, Amerike dhe Australi është rreth 7500(që nga paslufta). Shkaku kryesor i emigrimit është për të siguruar një jetë më të mire dhe ndihmuar familjet e tyre. Por një pjesë e tyre janë emigruar në rrugë ilegale dhe fatkeqësisht ka filluar kthimi i tyre (deri me sot janë kthyer 15 familje).

Tabela në vazhdim tregon seriozitetin e migrimit e që përveç punësimit shumica e të migruarve kanë si arsye të dytë pamundësinë e arritjes së sigurimit të banimit.

Tabela 4. Bilanci i migrimit ne Rahovec⁶

Migrimi sipas viteve	2017	2018	2019
Bilanci i migrimit	-902	-1,711	-2,128

18.3. Punësimi

Në komunën e Rahovecit veprojnë 1000 biznese private, dhe veprimtaria e tyre është prodhuese, industriale, shërbyese dhe tregtare. Problemi i nivelit të lartë të papunësisë në nivel të Kosovës, reflektohet edhe në Komunën e Rahovecit. Të punësuar në subjektet ekonomike janë 3.501 apo në 1.000 banorë të aftë për punë rreth 110 të punësuar në ekonomi. Duhet shtuar këtu që Rahoveci është vend me bujqësi mirë të kultivuar edhe atë rrush, misër e drithëra por edhe specat e perime tjera. Është tanimë i njohur biznesi gratë e Krushës që me përkrahje financiare u rrit biznesi në fabrikë për përpunimin e produkteve bujqësore.

Në sektorin publik janë 1072 të punësuar, 10 në PTK, 70 në "Ambijenti", 847 punonjës janë në Arsim, Në sektorin e Shëndetësisë punojnë 145 punëtorë shëndetësorë.

Numri i personave kontributdhënës në Trustin pensional në vitin 2019 ishte 8,668. Rreth 12.8% më shumë se në vitin paraprak.

⁶ Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal e Komunës së Rahovecit 2021-2025




Figura 2. Punësimi dhe papunësia në Komunën e Rahovecit

Burimi: ASK, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2020, fq.15

18.4. Papunësia

Tregu i të papunëve realë në Rahovec është rreth 24.2%⁷. Statistikat ndryshojnë kur vien tek raportimi nga autoritetet komunale të cilët raportojnë që papunësia është në mes 30 deri 50%. Kur themi që 76% e popullsisë është aktive për punë kuptohet që nevoja për vende pune është e madhe. Meqë Rahoveci është vend i përshtatshëm për kultivimin e bujqësisë, mund të pritët që një pjesë e madhe e popullsisë të gjejnë punën me kultivimin e bujqësisë.

18.5. Gjendja Sociale

Në komunën e Rahovecit në vitin 2021 ndihmë sociale kanë përfituar 667 familje me 2,790 anëtarë. Llogaritur me numrin zyrtarë të banorëve, del se rreth 5 % e popullsisë përfiton asistencë sociale. Shikuar në tri vitet e fundit ky numër ka variuar në atë numër përafërsisht.

⁷ ASK, Vjetari statistikor i Republikës së Kosovës 2020, fq 15

Tabela 5. Numri i familjeve përfituese të asistencës sociale për tri vite të fundit

Nr. i familjeve përfituese të asistencës sociale	
Periudha	Numri i familjeve
2021	667
2020	671
2019	620

Në aspektin gjinor të bartësve të asistencës sociale sa i përket vitit 2021, nga 667 familjet përfituese 535 janë bartës meshkuj derisa 132 familje me bartëse femra që do të thotë 80% meshkuj dhe 20% bartëse familjare femra.

Tabela 6. Raporti gjinor i bartësve të asistencës familjare

Viti	Numri i familjeve	Bartës-Meshkuj	Bartës-femra
2021	667	535	132
2020	671	551	120
2010	620	505	115

Sikur edhe në punësim ashtu edhe tek bartësit e të drejtës për asistencë sociale shihet që shumica janë meshkuj, kjo ngaqë shumica e familjeve kryesohen nga meshkujt.

18.6. Të Ardhurat

Në Kosovë, paga mesatare neto në vitin 2020 ishte 416 Euro ku në ndërmarrjet publike, paga mesatare neto, në vitin 2020 arrinte në 680 Euro, sektori publik kishte një pagë mesatare prej 552 Eurosh dhe sektori privat kishte një pagë mesatare neto 342 Euro.

Sektori i industrisë në Komunën e Rahovecit, bazohet kryesisht në industrinë agro-industriale, përpunimin e rushit dhe të grurit, industrinë e plastikës, ndërtimtarisë, teknologjinë përpunuese të metaleve, teknologjive për ngrohje dhe ftohje, artizanate, tregëti, shërbime etj. Pas luftës, ndërmarrjet e vogla kanë shfaqur tendencën për shfrytëzimin dhe përpunimin e gurit, rërës, zhavorit dhe argjilës, evidente me një shkatërim joselektiv të resurseve.

Meqë shumica e punonjësve vie nga sektori privat mund ti referohemi pagës mesatare në sektorin privat e që është 342 eu.

9. Planifikimi Hapësinor dhe Infrastruktura

Komuna e Rahovecit ka të miratuar PZHK-në 2018-2026. Komuna e Rahovecit ka një sipërfaqe prej 275.89 km², në të cilin territor shtrihen 34 fshatra me 2 vendbanime dhe me vetëm një qendër urbane.

Territori i komunës së Rahovecit ndahet në 34 zona kadastrale, dhe të gjitha vendbanimet (fshatrat) janë me nga një zonë kadastrale, me përjashtim të 3 zonave: Retije që në vete përfshinë dy vendbanime (Retijë dhe Retijë e ulët), zona kadastrale Çifllak që përfshinë edhe vendbanimin e Saroshit si dhe zona kadastrale Denjë që në vete përfshinë edhe vendbanimin e Babocit.

Pjesa më e madhe e ndërtimeve, janë ndërtime të ulëta deri në dy kate, ndërsa zona me ndërtime relativisht të larta shtrihet përreth rrugës kryesore të qytetit duke formuar bërthamën urbane të qytetit. Etazhiteti mesatar është P+3.

Sikur edhe në tërë Kosovën, kërkesat e mëdha për banim dhe funksionet përcjellëse, e kanë gjetur të papërgatitur qeverisjen lokale nga ana urbanistike, gjë që ka sjell rritjen e problematikës lidhur me zhvillimin urban të qytetit. Përveç lëvizjes së lirë të njerëzve, që solli si pasojë dyndjen e njerëzve nëpër qytete, të cilët, për të siguruar kushtet e nevojshme të jetesës, kryen ndërtime të jashtëligjshme pa kritere urbanistike, duke krijuar kështu zona joformale,

Komuna e Rahovecit është në fazë të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal me Hartën Zonale Komunale sipas legjislacionit në fuqi. Sipas PZHK 20018-2026, Rahoveci është ndarë në zonat në vijim sipas të cilave bëhet menaxhimi i mbeturinave.

Tabela në vijim tregon që zona më e madhe është rurale me 28.6% popullsi dhe 37% të territorit.

Tabela 7. Zonat në Rahovec për menaxhimin e mbeturinave sipas PZHK 2018-2026

Kategoria	Popullsia	%	Sip. km ²	%
Urbane	15,892	28.3%	49	17.8%
Para Urbane	4.205	7.5%	39	14.0%
Rurale	21,670	38.6%	102	37.0%
Rurale e Thellë	14,441	25.7%	86	31.2%
Totali	56,208	100%	276	100%

Me draft Planin Zhvillimor Komunal PZHK 2018-2026, sipërfaqja e përgjithshme e komunës është vlerësuar prej 27,589 ha. Në tabelën në vazhdim po paraqesim të dhënat e sipërfaqeve.

Tabela 8. Sipërfaqja e përfshirë në plane urbane^a

Nr.	Kategoria hapësimore	Sipërfaqe në ha	në%
1	Pyje	7293.24	26.4
2	Infrastrukturë Bujqësore	12,556.98	45.5
3	Zonat e ndërtuara	1,239.2	4.5

^a PZHK dhe PZHU, sipas legjislacionit të vjetër

4	Varrezat	67.77	0.2
5	Livadhe	710.25	2.6
6	Kullosa	3,299.73	12.2
7	Vreshta	2,225.61	8.1
	Gjithsej	27,589.40	100

SHFRYTËZIMI I TOKËS		
1	Sipërfaqja e tokës ndërtimore	1,239.2 ha
3	Sipërfaqja totale e banimit	Rreth 1,100.00ha (rreth 4%)

MBULUESHMËRIA ME PLANE		
1	Sipërfaqja e përgjithshme e komunës e përfshirë në PZHK	27.592ha
3	Mbulueshmëria me Plane Rregulluese ⁹	/
4	Nr. i Vendbanimeve Joformale në Komunë	8

Të dhënat hapësonore të nevojshme për këtë plan do të përmblihen në tabelën në vijim

Tabela 9. Tabela përmbledhëse

Nr. i popullsisë [ban]	56.208
Zonat rurale [ban]	40.316
Zonat urbane [ban]	15.892

⁹ Ende përdoren planet e vjetra- planet gjenerale urbanistike të viteve 1985-1987 si dhe vendimet në bazë të katër planeve

Nr. i fshatrave/nr i lagjeve			35
Banimi individual	9867		3050
	13.502		2040
	P+1		P+1
			95.25
Banimi në ndërtesa shumë-banesore	Para 1999	Nr. Objekteve	19
		Nj. Banimi	223
	Pas 1999	Nr. Objekteve	6
		Nj. Banimi	75
	Etazhiteti mesatar		P+4
	Sipërfaqja mesatare për njësi banimi (banesë) [m²]		44.27
Statusi pronësor (banim në ndërtesat shumëbanesore) para 1999		Privat [nj. banimi]	Privatizuar shumica nga 223
		Shoqëror [nj. banimi]	NA
Raporti banim individual/banim shumë-banesor në [%]			2.2% me 97.8%
Kryje në infrastrukturë të objekteve të banimit në [%]			92%
Nr. i objekteve të pabanuara			26.6%
Nr. i objekteve me vlerë kulturore historike që shfrytëzohen për banim			3
Aplikimi i masave termo-izoluese në objektet e banimit në [%]			25%
Ndërtimet ilegale	Ndërtimet pa leje		14,786
	Shtesat në ndërtimet me leje		NA
	Mbindërtimet		NA
Numri i kërkesave për zgjidhjen e çështjes së banimit			50
Lokacionet (sipërfaqja e tokës) për programet e veçanta të banimit			
Nr. i objekteve/nj. banimi e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe Donatorët			95 (13 në pronësi komunale)
Nr. i objekteve/nj. banimi me qira nga dhe vlera mes. e qirasë			2.2%, vlera nuk dihet
Nr. i objekteve/nj. banimi të disponueshëm për qira të ulëta të tregut			NA

Nr. i objekteve/nj. banimi ne pronësi te Komunës që mund të adaptohen	Nuk ka
Qendrat e përkohshme kolektive (QPK)	Nuk ka
Planet rregulluese - sa janë bërë dhe sa janë që duhet të bëhen	Punohet me plane detaje të para luftës

Nga tabela 9 dëshmohej që Rahoveci me 97.8% është mbuluar nga shtëpi individuale dhe vetëm 2.2% me ndërtesa shumëbanesore. Ky trend do të ndrojoj në favor të ndërtesave shumëbanesore ngaqë PZHK si dhe HZK që janë në proces, synojnë të bëjnë denzifikimin dhe derisa Rahoveci si edhe komunat tjera është i rrezikuar në aspekt të përdorimit të tokës, do të synohet orjentimi kah ndërtimet në kate.

Sa i përket kërkesave për banim në Rahovec aktualisht janë 50 kërkesa që do të elaborohen më poshtë në grupe specifike.

Sa i përket aplikimit të masave efçiente përqindja konsiderohet shumë e ulët me 25% derisa kyqja në infrastrukturë 92% e ndërtesave të banimit konsiderohet si e kënaqshme.

18.1. Vendbanimet joformale dhe ndërtimet pa leje

Në komunën e Rahovecit janë identifikuar 9 vendbanime jo formale, një nga të cilat ndodhet në zonën urbane dhe 8 në zonat rurale. Në këto vendbanime jetojnë kryesisht banorë të komunitetit rom, ashkali, egjiptian dhe shqiptar. Karakterizohen me mungesë të infrastrukturës fizike dhe infrastrukturë sociale si dhe kanë ndikim negativ në mjedis.

Sipërfaqja e përgjithshme e Vendbanimeve jo formale në Komunën e Rahovecit është 12.2 ha. Në të gjitha këto vendbanime jetojnë gjithsej 1556 banorë me 293 ekonomi familjare.

Vendbanimet jo formale gjenden në këto vendbanime: Një pjesë e qytetit të Rahovecit, dhe pjesë apo lagje të fshatrave Bellacërk, Xërxë, Radost, Ratkoc, Çifllak, Dabidol dhe dy pjesë të fshatit Drenoc.

Me legjitimimin e pronësisë së këtyre vendbanimeve, ndërtimit të infrastrukturës së nevojshme ose ofrimit të banimit social për familjet e pa proma mund të arrihet në formalizimin e këtyre vendbanimeve,



Republika e Kosovës
Rahovec





Figura 3.Vendbanimet joformale në Rahovec

10. ANALIZË E GJENDJES EKZISTUESE TË BANIMIT SOCIAL

Analiza e gjendjes ekzistuese sa i përket banimit social do të orientohej në elaborimin e ofrimit të zgjidhjeve nga ana e Komunës së Rahovecit ndaj kërkuessve të ndihmës për banim.

Kërkesat për banim social janë në bazë të shpalljes së Komunës për aplikim. Ky numër jo që pasqyron situatën reale për banim duke pasur parasysh që rreth 60% e popullsisë është nën moshën 35 vjeçare dhe se realisht ishte dashur që trajtim me banim të kenë edhe familjet e reja, por në pamundësi komunat të përballen me kërkesën reale për përkrahje, është krijuar edhe opinioni që komunës ti drejtohen për ndihmë vetëm familjet që skanë strehë dhe s'mund të arrijnë deri tëk banesa pa përkrahje shtetërore.

Në vijim do të trajtohen kërkesat aktuale për banim.

18.1. Kërkesat aktuale për banim social

Kërkesat aktuale janë në proces të regjistrimit në platformën digjitale për banim. Këto kërkesa janë në bazë të shpalljes së fundit të Komunës për aplikim për banim social (40) dhe për ndërtim të shlepive(10) dhe të kategorizuara janë si vijon:

Tabela 10. Kërkesat aktuale për banim social

	Kategoritë	Kërkesa për banim
1.	Me asistencë sociale- (të gjitha komunitetet)	50
2.	Kategoritë e dala nga lufta Familjet e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe martirëve	/
3.	Te kthyerit	/
4.	Të riatdhesuarit	/
5.	Të moshuarit	/
6.	Të rinjtë	/
7.	Të punësuarit nga buxheti shtetëror	/
8.	Minoritetet-komunitetet Romë, Ashkalinjë, Egjiptianë	8
9.	Viktimat nga dhuna në familje	
10.	Familjet me femra kryefamiljare	
11.	Nënat e vetmuara	
Gjithsej		50

18.2. Kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit kriteret e përparësisë për sigurimin e banimit për kategoritë e cekura në pikën 7.1 janë:

- Statusi i banimit;
- Lartësia e të ardhurave;
- Gjendja shëndetësore;
- Invaliditeti;
- Struktura e familjes.

Pasur parasysh që mundësitë e Komunës janë të kufizuara derisa kërkesat janë të mëdha, është e patjetrueshme që të bëhet prioritetizimi i familjeve në bazë të këtyre kriterëve sipas akteve nënligjore në fuqi.

Komuna e Rahovecit nuk ka Profilin e Banimit ku do të evidentoheshin kërkesat reale për banim dhe në mungesë të modaliteteve evidentohen kërkesat për zgjidhje emergjente të banimit e që zgjidhjet Ad- hok janë konsideruar si të pjesshme dhe jo të mjaftueshme, nganjëherë jo të pëlqyera nga përfituesit.

18.3. Objektet komunale të dedikuara për banim social

Edhe pse shumë donatorë kanë përkrahur zgjidhjen e çështjes së banimit për këto kategori, konsiderohet barrë për Komunën e Rahovecit ngaqë Banimi sikur edhe konsiderohet nga njohës të fushës nuk mund të konsiderohet vetëm kulm mbi kokë, ngaqë nëse nuk përcillet me punësim, arsim dhe funksione tjera përcjellëse këto familje do të jenë raste sociale e që Rahoveci si komunë s'mund ti përballojë dot.

Në komunën e Rahovecit ndihma në banim kryesisht është bërë me ndërtimin e shtëpive individuale si në vazhdim:

Numri i shtëpive	Lokacioni	Viti i realizimit	Burimet financiare
3	Rahovec	2000-2005	UNDP
4	Fshatra	2000-2005	UNDP
5	Rahovec	2006-2013	MKK
3	Fshatra	2006-2013	MKK
22	Hoçë e Madhe	2008-2012	MKK
16	Rahovec	2008-2012	MKK
34 (serbë)	Zoçishtë	2005-2008	MKK
4 (shqiptarë)	Zoçishtë	2005-2008	MKK

9	Rahovec	2014-2016	MKK
2	Rahovec	2012	Komuna
1	Rahovec	2012	Shoqata Nënë Tereza
3	Rahovec	2012	Qeveria



Figura 4. Foto nga shtëpitë e realizuara ne Komunën e Rahovecit

Shtëpitë e realizuara shumica janë të paizoluara dhe mund të konsiderohen si zgjidhje emergjente.

Shtëpitë e realizuara për kthimin e komunitetit serb janë të realizuara me kualitet më të lartë-shih foton e fundit në figurën 4. Edhe pse të realizuara me kualitet më të mirë këto familje nuk janë kthyer dhe shtëpitë po dëmtohen ashtu nga koha si të pabanuara fare.

Ligji parasheh banesa sociale me qira joprofitabile e cila do të përdoret për mirëmbajtjen e tyre por skema e qirasë nuk u zbatua në asnjë komunë të Kosovës ku ka ndërtesa me banesa

sociale. Në Rahovec është ndërtuar një ndërtesë e banimit social në vitet 2015-2016, me 18 njësi banesore. Ndërtesa ende nuk është lëshuar në përdorim pra nuk ka ende sistem për mbledhje të qirasë joprofitabile dhe ende nuk faturohet nga komuna.



Figura 5. Ndërtesa e banimit social me 18 njësi banimi

18.4. Familjet e ndihmuara deri tani për zgjidhje të çështjes së banimit

Familjet e përkrahura për banim në një mënyrë apo tjetër do të përmbliidhen në tabelën 8.

Tabela 11. Familjet e përkrahura për banim deri në vitin 2021

	Mënyra e ndihmës	Numri i ndërtesave	Numri i familjeve të ndihmuara	Koha e realizimit	Vlera e qirasë/ndihma financiare (€)
1	Banesat e ndërtuara nga Komuna	1	Në proces	2015-vazhdon	567,754.94€ / ende në proces
2	Banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit;	6 banesa me qira	6 familje	2017-2022	100-150 euro/ muaj për familje
3	Banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim;				
4	Shtëpi individuale të ndërtuara nga donatorë të huaj;	104	104	2000-2016	NA

	Shtëpi individuale të ndërtuara nga Komuna dhe donatorë vullnetarë vendorë e diaspora si dhe për të riatdhesuar nga MMPH;	13	13		NA
5	Renovime/riparime	Material ndërtimor dhe masa për efijencën në ndërtesa	63 për vitet 2020-2021		

11. Kategoritë e synuara

Tri kategoritë e mëdha të definuara me ligj që mund të përfitojnë nga programet e banimit janë:

- Familjet që nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale
- Kanë mbetur pa shtëpi si pasojë e dëmtimeve të shtëpive gjatë luftës së fundit
- Familjet që posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike.

Nëse i radhisim me radhë të përparësisë do të radhiteshin si në vazhdim:

1. Rastet sociale
2. Kategoritë e dala nga lufta dhe ish të përmdjekurit politik;
3. Të riatdhesuarit
4. Komunitetet Romë, Ashkalinjë, Egjiptianë (Minoritetet)
5. Të rinjtë, të punësuarit nga buxheti shtetëror
6. Viktimat e dhunës në familje
7. Të kthyerit
8. Refugjatët

Specifikimi rregullohet sipas bazës ligjore duke i definuar balancën ndërmjet kategorive të synuara nëpër vite të aplikimit sipas të cilit do të përcaktohen kriteret e caktuara për familjet përfituese të cilat do të kenë për bazë: karakteristikat sociale dhe ekonomike të familjeve që presin ndihmën nga autoritetet komunale për të zgjidhur problemet e banimit. Meqë komunitetet Romë, Ashkalinjë e Egjiptianë konsiderohen si grupet më të rrezikuara duhet të sigurohet që së paku 10% e të përzgjedhurve për përkrahje në banim të jenë nga këto komunitete dhe të sigurohen që janë njoftuar kurdo që shpallen programe banimi.

Programe të suksesshme konsiderohen kombinimi i përfituesve nga të gjitha kategoritë duke

pasur parasysh edhe përzierjen e kategorive sa i përket moshës - të rinj dhe të moshuar.

Projektet e ndërtimeve të Banimit Social në zona të ndara nga zonat tjera të banimit nuk janë konsideruara si adekuate. Objektet e Banimit Social të ndara kanë dëshmuar këtë dhe në të ardhmen si në nivelin qendror edhe lokal duhet të hulumtojmë në zgjidhje më të përshtatshme edhe për familjet që përkrahen, kulturën e banimit të tyre por edhe integrimin e tyre në shoqëri duke e përfshi edhe banimin.

12. PLANIFIKIMI KONKRET PËR NDIHMË PËR BANIM SOCIAL

Programet trevjeçare të banimit të Komunës së Rahovecit janë hartuar për periudhën 2022-2025. Konsulentja e angazhuar nga OJQ "VOICE OF ROMA, ASHKALI, EGYPTIAN" ka bërë analizë të gjendjes ekzistuese dhe ka përgatitur propozime konkrete për të ndihmuar qytetarët e komunës së Rahovecit që nuk kanë mundësi të zgjidhin çështjen e banimit me forca vetanake. Përpos ndihmës konkrete për qytetarët e vet, brenda kësaj periudhe tre-vjeçare, zhvillimin e fushës dhe mirëmbajtjen e relacioneve me institucione qendrore dhe organizata ndërkombëtare për çështje të banimit do ta ndihmonte krijimi i sektorit të banimit në kuadër të komunës së Rahovecit.

Pra, Programi i prezantuar Tre-Vjeçar për Banim i ka dy objektiva:

O1. Funksionalizimin e të dhënave për banim nga zyrtarja për banim

O.2.Sigurimin e banimit për rreth 88 familje;

18.1. O1. Funksionalizimi i databazës për banim

Komuna e Rahovecit ka emruar një zyrtarë për banim që është parakusht për zhvillimin e programeve të banimit. Për strukturën për banim nuk janë paraparë implikime buxhetore ngaqë është propozuar që të angazhohet një prej zyrtarëve aktual si për fillim dhe në vitet në vijim të planifikohet zhvillimi i strukturës varësisht prej mundësive buxhetore. Zyrtarja për banim ka filluar të plotësojë databazën për banim me informatat e nevojshme.

18.2. O2. Sigurimi i banimit për rreth 88 familje

Prioritet kryesor i këtij programi është që në periudhën tre vjeçare Komuna e Rahovecit të jetë në gjendje të i ndihmojë rreth 88 familje duke ju siguruar Banim Social.

Kjo do të bëhet në përputhje të plotë me Ligjin për Financimin e Programeve Tre-Vjeçare për Banim. Sipas këtij ligji, sigurimi i banimit bëhet përmes financimit të programeve të veçanta të banimit me qira, ku përfshihen:

- Banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe donatorët të cilat jepen me qira;
- Banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me
- Qira për familjet që posedojnë bonus të banimit;
- Banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim.

• O.2.1. Funksionalizimi i Objektivit me Banim Social për 18 familje

Komuna e Rahovecit ka të ndërtuar Objektivin e Banimit Social me 18 njësi banesore e cila ende nuk është përfunduar e që me zgjidhjen e problemeve të kompanisë ndërtimore mund të

funksionalizohet kjo ndërtesë. Propozohet të sigurohet një buxhet shtesë për funksionalizimin e tij.

- **O.2.2. Përkrahjen për ndërtimin e shtëpive individuale edhe për 20 familje**

Meqë tradicionalisht familjet kosovare duan të kenë banim në pronësi individuale dhe posedojnë troje, komunat konsiderojnë si masë për përkrahje për banim edhe ndërtimin e shtëpive në troje private. Kjo masë edhe pse nuk parashihet në programet sipas Ligjit për programet e veçanta të banimit komunat e shohin si masë që duhet ndërmarrë andaj edhe komuna e Rahovecit do të vazhdojë me këtë masë në përkrahje të donatorëve vendorë dhe diaspora.

- **O.2.3. Pagesa e bonus banimit për 20 familje**

Këto projekte kanë filluar së realizuari andaj mbeten projekte që synohen të përfshihen në Programet trevjeçare të banimit. Ky dokument parasheh programin me Bonus banimi ku Komuna paguan gjysmën e qirasë më të ulët të tregut e përfituesit paguajnë gjysmën e qirasë derisa Kuvendi komunal mund të merr vendim të subvencionimit edhe më shumë se gjysmën e qirasë joprofitabile. Propozohet të përkrahen 20 familje për vit.

- **O.2.4. Riparimet eventuale në ndërtesat e banimit në pronësi private**

Në bazë të Ligjit nr. 02/L-17 për shërbimet sociale dhe familjare u mundëson komunave që në raste të veçanta të përkrahin punët ndërtimore për të siguruar banimin familjeve. Propozohet të përkrahen 30 familje për tri vite.

- **O.2.5. Mirëmbajtja e Objektivit të banimit social dhe krijimi i skemës së qirasë, fillimi i shpërndarjes së fletëpagesave të qirasë të shfrytëzuesve të banimit social**

Parashihet edhe buxhet për mirëmbajtjen në ndërtesat ekzistuese për banim social dhe funksionalizimin e skemës së qirasë.

Në vazhdim do të definohen këto projekte me planifikim të përafërt buxhetor

Tabela 12. Plani i Veprimit me projektet potenciale

SYNIMI			
<i>Krijimi i kushteve për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në harmoni me standardet dhe normat evropiane të banimit, me qëllim që të mundësohet zgjidhja e nevojave për banim për grupe të caktuara të cilat nuk kanë forcë ekonomike që këtë problem ta zgjidhin sipas parimeve të tregut.</i>			
Objektivi 2		Sigurimi i banimit për 88 familje	
O.2.1.	Projekti	Ndarja e njësive të reja të banimit të cilat do të jepen me kontratë qiraje - qira joprofitabile	
Përshkrimi		Funksionalizimi i Objektit të Banimit social për akomodimin e 18 familjeve. Vlera e kalkuluar: 50,000.00€ Viti i realizimit të projektit fund 2022	
Burimi financiar		Buxheti komunal 100%	Donatorët
O.2.2.	Projekti	Përkrahja në ndërtimin e shtëpive në prona private për familjet me asistencë sociale	
Përshkrimi		Ndërtimi i 20 njësive të banimit- shtëpi individuale. Njësitë e banimit për familje min.5 anëtarë, sipërfaqje e njësive përafërsisht 65m ² - 80 m ² - bruto. Vlera e kalkuluar: 20,000.00 x 20= 400,000.00€ Koha e realizimit të projektit: 2022-2025	
Burimi financiar		Buxheti komunal 30%	MFTL+MKK+Zyra për Komunitete Donatorët 40%
O.2.3.	Projekti	Përkrahja e 20 familjeve me Bonus banimi	
Përshkrimi		Përkrahja e 20 familjeve duke ia paguar gjysmën e qirasë minimale në treg nga pronarë privat. Vlera e kalkuluar: 20 x 150 x 12=36,000.00€ /1 vit Koha e realizimit të projektit: 2022-2025	
Burimi financiar		Buxheti komunal 60%	MFLT 40%
O.2.4.	Projekti	Përkrahja e 30 familjeve për renovim/ material ndërtimor	
Përshkrimi		Përkrahja e 30 familjeve për renovim /material ndërtimor Vlera e kalkuluar:30 x 2,000.00 =60,000.00 € Koha e realizimit të projektit: 2022-2025	
Burimi financiar		Buxheti komunal 50%	Donatoret 50%
O.2.5	Projekti	Menaxhimi administrimi dhe realizimi i projekteve për përmirësimin e kualitetit të banimit	
Përshkrimi		Realizimi i projekteve për përmirësimin e kushteve të banimit në objektet ekzistuese të banimit kolektiv dhe individual në bashkëpunim me pronaret. Krijimi i skemës së mbledhjes së qirasë joprofitabile që do të shërbente për mirëmbajtjen e objekteve ekzistuese sociale Vlera e kalkuluar: 5,000.00€/ në vit derisa të fillojë inkasimi i qirasë joprofitabile Koha e realizimit: 2022 e tutje	
Burimi i		Komuna në bashkëpunim me OJQ të për banim	

financave



Republika e Kosovës
Rahovec



13. PLANIFIKIMI BUXHETOR PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT

Për realizimin e Programit Tre-Vjeçar për Banim në komunën e Rahovecit duhet që të bëhet planifikim buxhetor në bazë vjetore. Siç është cekur më lartë, përmes këtij programi komuna e Rahovecit planifikon të ndihmojë 88 familje të cilat nuk janë në gjendje që me financim vetanë të sigurojnë banimin.

Nga komuna e Rahovecit kërkohet që për nevoja të këtij programi në periudhën 2022-2025 të siguron buxhet në vlerë **219,800.00 Euro** nga totali 623.000.00 Euro. Sikur është definuar në tabelat lartë pjesa tjetër e mjeteve financiare do të kërkohen nga niveli qendror dhe donatorët. Në formë tabelore kjo ndarje duket si në vijim:

Tabela 13. Buxheti i nevojshëm për realizimin e Programeve trevjeçare të banimit nga ana e Komunës së Rahovecit

Mënyra e ndihmës	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Totali
Funksionalizimi i ndërtesës për banim social me qira jo profitabile për strehimin e 18 familjeve;	50,00.00	0	0	50,00.00
Ndërtimi i 20 shtëpive individuale	0	60,000.00	60,000.00	120,000.00
Bonus-Banimi (pagesa e gjysmës së qirasë për familjet në nevojë për banim. Në këtë formë do të ndihmohen nga 20 familje për 3 vite;	21,600.00	21,600.00	21,600.00	64,800.00
Shpërndarja e materialit ndërtimorë për 30 familje	10,000.00	10,000.00	10,000.00	30,000.00
Menaxhimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave për banim social	5,000.00	0	0	5,000.00
Totali për vite:	36,600.00	91,600.00	91,600.00	219,800.00

Tabela 11, prezanton Buxhetin e planifikuar për banim social për vitet 2022-2025 i cili për tu realizuar duhet përkrahur nga Qeveria nëpërmjet ministrive gjegjëse si dhe donatorëve.

Duhet prezantuar faktin që edhe Qeveria aktuale në programin e saj një prej synimeve dhe prioriteteve është edhe zgjidhja e problemit të banimit për familjet që nuk mund të arrijnë vet duke stimuluar edhe familjet e reja dhe shërbyesit civil.¹⁰

¹⁰ Programi qeveritar- Banimi social i përballueshëm

14. Buxheti i Komunës Rahovecit

Planifikimi buxhetor i komunës Rahovecit është paraqitur si pjesë e Ligjit për Buxhetin e vitit 2022.

Me kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe me përgatitjen vjetore të tij do të parashihen projektet e planifikuara me këtë dokument.

Pershkrimi	Stafi	Paga dhe Shërbim	Materiet dhe Shërbimet	Shpenzimet Komunalet	Subvencionet dhe Transferimet	Shpenzimet Kapitale	Rrezerva	Total 2022	Total 2023	Total 2024
Total Shpenzimet	1,153	7,372,843	1,731,800	279,000	380,000	4,122,813	130,000	13,653,456	14,813,281	15,757,000
Grantet Qeveritare	1,153	7,372,843	1,623,000	279,000	380,000	3,422,350	105,000	12,793,111	14,354,878	15,245,894
Te Hyrat Vetëkalo			108,800		380,000	700,463	65,000	1,394,263	1,438,401	1,632,100
Financimi i Jashtëm										
Financimi nga Mëmëvija										

Buxheti i Komunave për vitin 2022										
Struktura e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve										
Niveli i A (Komuna) të cilat e kanë aprovuar buxhetin në Kuvendin Komunal sipas Ligjit buxhetor me QD 2022/91 dhe QD:										
Komuna	Fondi burime	Stafi	Paga dhe shërbim	Materialet dhe shërbimet	Shpenzimet Komunalet	Subvencionet dhe Transferimet	Shpenzimet Kapitale	Rrezerva	Total	
Rahovec	Total	1,154	7,372,843	1,731,800	279,000	380,000	4,122,813	130,000	13,653,456	
	Grant	1,153	7,372,843	1,623,000	279,000	380,000	3,422,350	105,000	12,793,111	
	FIN				110,000		150,000	700,463	65,000	1,348,526

Buxheti për zyren për komunitete dhe kthim

Pershkrimi	Stafi	Paga dhe Shërbim	Materiet dhe Shërbimet	Shpenzimet Komunalet	Subvencionet dhe Transferimet	Shpenzimet Kapitale	Rrezerva	Total 2022	Total 2023	Total 2024
Total Shpenzimet	8	61,541	15,300			20,000		61,541	61,700	60,000
Grantet Qeveritare	8	56,541	14,300			0		71,300	71,700	60,000
Te Hyrat Vetëkalo						20,000		20,000	20,000	20,000
Financimi i Jashtëm										
Financimi nga Mëmëvija										

Buxheti për shërbime sociale

Pershkrimi	Stafi	Paga dhe Shërbim	Materiet dhe Shërbimet	Shpenzimet Komunalet	Subvencionet dhe Transferimet	Shpenzimet Kapitale	Rrezerva	Total 2022	Total 2023	Total 2024
Total Shpenzimet	13	100,730	10,000	4,000				114,730	115,294	115,230
Grantet Qeveritare	13	100,730	10,000	4,000				114,730	115,294	115,230
Te Hyrat Vetëkalo										
Financimi i Jashtëm										
Financimi nga Mëmëvija										

Figura 15-1. Informata nga Korniza afatmesme e shpenzimeve të K. Rahovecit për vitet 2022-2025

15. ANALIZA SËOT

Në vazhdim do të paraqitet analiza SËOT për Komunën e Rahovecit:

PËRPARËSITË	DOBËSITË
• Ekzistimi i dokumenteve planore (në proces të finalizimit) • Vullneti politik në nivel qendror dhe lokal për të përkrahur familjet për të zgjidhur problemin e banimit • Ekzistimi i iniciativave për PPP në fushën e ndertimeve -banimit • Infrastruktura në zonat urbane dhe rurale • Subjektet e ekonomike shfrytëzues • Nevoja për zona të reja të banimit • Ekzistimi i zonave rezervë të planifikuara për banim • Ligjet nga fusha e banimit • Burimet njerëzore autoritetet komunale të përkushtuara për kategoritë e rrezikuara • Regjistrimi i popullsisë • Të dhënat për kërkuesit • Mbulueshmëria me infrastrukturë • Strategjitë komunale • Ndërtimi i objekteve me këtë karakter • Interesimi i qytetarëve për pjesëmarrje në këto programe	• Parcela të vogla • Mungesa e hapësirave për shërbime • Oferta dhe kërkesa jo të harmonizuara • Kosto e lartë e paësjes me inf. Adekuate • Ndertimet pa leje • Kosto e lartë e banimit dhe kualiteti i ndërtimit jo adekuat • Legalizimi me mungesa të zgjidhjeve në raste të shumta • Kapacitete jo të mjaftueshme komunale për zhvillimin e banimit social • Masa jo të mjaftueshme që ndërmerren për kategoritë e caktuara • Mungesa e interesimit të disa grupeve për pjesëmarrje në diskutim të dokumenteve planifikuese sidomos të rinjtë • Analiza e banimit nuk është gjithëpërfshirëse në mungesë të informatave • Mirëmbajtja e objekteve të banimit kolektiv jo e organizuar.
MUNDËSITË	RREZIQET
• Ligjet dhe Programet shtetërore për banim • Strategjitë komunale dhe qendrore • Formimi i strukturës për banim • Skemat garantuuese • Programet në nivel komunal • Stimulimet për grupet e caktuara, • Programet në nivel qendror në mbështetje në nivel lokal nga fusha e ndërtimit/banimit. • Ligjet përkatëse të inkurajojnë zhvillimin e banimit (Ligji PPP)	• Kriza ekonomike dhe Pandemia • Mungesa e fondeve në nivel lokal • Kontroll jo i mjaftueshëm nga fusha e ndertimeve, • Ndotja e ambientit.

- Linja te favorshme të bankës, kredite per banim
- Mbështetje për ndërtimet ne pronësi private – procedurat përmirësimin e tyre.
- Programe mbështetëse nga partner kombëtarë dhe ndërkombëtarë në fushen e banimit.

16. ARSYETIM I VEPRIMEVE DHE SHPJEGIMIN E REZULTATEVE TE PRITSHME

Programi për banim i Komunes së Rahovecit mbulon periudhën 2022-2025. Komisioni ka përgaditur propozimet për projektet prioritare zbatimi i të cilave rezulton në arritjen e Synimeve zhvillimore të përcaktuara në fushat kyqe, detyrimet akviteve, bartësit kryesor, afatin kohor të implementimit, përgaditjes dhe koordinimit të aktiviteteve të përgjithshme për implementimin e projekteve.

Në mënyrë që të sigurojë zbatimin e projekteve të planifikuara komuna do të funksionalizojë databazën e banimit dhe përkrahë punën e zyrtari/ res për banim që do të jetë përgjegjës për koordinimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara.

Struktura për banim është një organ i përhershëm që ka për qëllim monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të projekteve dhe detyrave nga Programet i banimit, si:

- Rishikimin e programeve dhe Planit të Veprimit
- Mbështetjen e Kryetarit të Komunës për marrjen e Vendimeve që lidhen me zhvillimin e banimit dhe programet lokale që mbështesin fushën e banimit.

Procesi i monitorimit do bëhet nga vetë Komuna dhe MMPHI nëpërmjet raportit vjetorë që Komuna obligohet të përcjellë në MMPHI e që do të përfshijë këto aktivitete:

- Shkalla e suksesit te Programit në krahasim me Planin e Veprimit nëpërmjet projekteve
- Planifikimi i fondeve nëpërmjet rishikimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve ngaqë Komuna e Rahovecit duhet paraparë mjete për banim dhe harmonizimi i tyre në raport me afatet kohore të planifikuara me këtë dokument
- Ndryshimet e mundshme të cilat mund të ndikojnë në realizimin e projekteve (individët, organizatat)
- Ndryshimet e jashtme që mund të ndikojnë në Planin e Veprimit, si dhe propozimet për alternativat e zgjidhjeve të ndikuara nga faktoret tjerë- harmonizimi.

Hapat e ardhshëm

Që dokumenti të jetë valid nevojitet të kalojë nëpër hapat:

1. Drafti të dakordohet me komisionin dhe të përgatitet për diskutim me publikun (të kihet kujdes të organizohet diskutim publik me shtresat më të rrezikuara që mund të mos

arrijnë deri te informata për diskutim publik të dokumentit, mund të përkrahet nga OJQ-të aktive me këto grupe);

2. Rishikimi dhe kompletimi i dokumentit në bashkëpunim me MMPHI;
3. Miratimi nga Kuvendi Komunal;
4. Përcjellja në komisionin për verifikim të ligjshmërisë.

Pas miratimit dokumenti bëhet publik derisa zyrtarët komunal mund të përgatisin menjëherë projektpropozime për përkrahje financiare në minsitritë përkatëse. Përshkrimi i projekteve është pjesë e planit të veprimit me projekte specifike.

17. MUNDËSITË DHE KAPACITETE NJERËZORE DHE MATERIALE TË KOMUNËS

Komuna e Rahovecit ka nevojë për kapacitete njerëzore dhe profesionale andaj duhet të planifikohet staf shtesë në nivel të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Kadastrit ashtu që përpos Banimit mund të ndihmojë edhe në trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe monitorimin e zbatimit të këtij dokumenti.

Spektori ka nevojë të bëhet më transparent me plotësimin e platformës digjitale ku do të ishin publike kërkesat për banim dhe zgjidhjet si dhe menaxhimi i skemës së qirasë e cila do të ndihmonte në mirëmbajtjen e ndërtesave të banimit social por edhe mbulimin e bonuseve të banimit sipas mundësisë.

18. PËRPUTHJA E PROGRAMEVE ME PLANET ZHVILLIMORE DHE POLITIKAT QENDRORE

18.1. Harmonizimi me planet zhvillimore urbane

Ky dokument është hartuar në frymën e PZHK dhe HZK për Komunën si dhe Strategjisë për zhvillim Socio-Ekonomik lokal.

Në dokument janë përfshirë edhe objektivat e përcaktuara të dokumenteve planifikues të deritanishëm si dhe janë harmonizuar me orjentimet e synuara me PZHK në zhvillim e sipër.

18.2. Ndërlidhja me programet e përgjithshme dhe orientimet e politikave të qeverisjes qendrore

Ky dokument është në harmoni me prioritetet e Qeverisë aktuale që në programin e tyre qeverisës, Banimin e kanë një prej prioritetëve duke synuar Banim për të gjithë nëpërmjet realizimin të Banimit Social të përbalueshëm. Për më tepër aktualisht është duke u hartuar Studimi i Fizibilitetit për banim social me ndihmën e bankës CEB nëpërmjet UN-Habitat Kosova ku Kosova ka mundësi të përfitojë përkrahje për zhvillimin e Sektorit të banimit social.

19. Instrumentet e garantimit të realizueshmërisë së programeve

Parakushtet për zbatimin e këtij dokumenti janë:

- Vullneti i Kryetarit por edhe Kuvendit Komunal të merret seriozisht me zgjidhjen e problemeve të banimit;
- Burimet njerëzore, të angazhohen zyrtarë për monitorimin dhe menaxhimin e fushës së banimit në përgjithësi;
- Përkrahja financiare dhe profesionale nga niveli Qendror si dhe nga donatorët duke pasur parasush që Rahoveci është i populluar me komunitete që jetojnë në vështirësi të mëdha;
- Raportimi në MMPHI për zbatimin dhe kërkesa me projektpropozime për përkrahje;

20. PËRFSHIRJA E PUBLIKUT NË PROCESIN E SIGURIMIT TË TRANSPERENCËS

Sikur u potencua, publiku si sovran i Komunës përkatëse do të ketë të drejtën të dijë mënyrën sesi shpenzohen të mjetet financiare të komunës në tërësi dhe ato të programeve tre vjeçare në veçanti e do të sigurohet duke përfshirë publikun në procesin e sigurimit të transparencës si:

- Zhvillimi i diskutimeve publike për përmbajtjen e këtij dokumenti dhe marrja e inputeve të tyre;
- Bërja e anketimeve apo studimeve të ndryshme për marrjen e mendimit të publikut;
- Bërja publike e programeve dhe projekteve që përfshijnë ato;
- Bërja e njoftimeve të ndryshme në mjetet e informimit publik apo në vend njoftimet komunale për aktivitetet ku mund të sigurohet pjesëmarrja e publikut;
- Prezantimi i të dhënave në platformën digjitale për kërkesat për përkrahje në banim dhe mundësitë e zgjidhjeve me projektet specifike
- Çdo masë tjetër e cila vlerësohet e nevojshme në përmbushje të këtij qëllimi.



21. PËRFUNDIMET

Nevoja për hartimin dhe zbatimin e efektshëm të projekteve për banim sipas programeve të veçanta kërkon koordinimin e aktiviteteve të të gjithë akterëve në kuadër të Komunës, në përputhje me kompetencat e përcaktuara.

Në këtë drejtim është i nevojshëm fuqizimi i Strukturës për banim- sektor apo zyrtar qoftë që do të shërbejë si organi përgjegjës, që në mënyrë aktive të zhvillojë procesin e zbatimit të aktiviteteve sipas këtij dokumenti. Ndërtimi i njësive të reja të banimit është një prej masave të rëndësishme për arritjen e qëllimit të këtij dokumenti e që do të duhej të bëheshin sipas standardeve dhe legjislacionit në fuqi, përmes fondeve nga buxheti komunal, Qeverisë dhe Partneriteti Publik – Privat e donatorëve.

Dokumenti jep orjentim në përmirësimin e kualitetit të banimit duke pasur parasysh objektet ekzistuese të banimit shumë-banesorë ku në masë të konsiderueshme do të ndikonte sektori i banimit në ngritjen e vetëdijes dhe motivimin e pronarëve të njësive të banimit për domosdoshmërinë e organizimit dhe menaxhimit.

Bazuar në këtë, zhvillimi i banimit orientohet nga:

- Përkrahja në zgjidhjen e çështjes së banimit me banesa me qira joprofitabile ose ne bonus të banimit për banesat e tregut me qira të ulët;
- Stimulim i ofertës dhe kërkesës;
- Mbështetje për grupet e rrezikuara për zgjidhjen e problemit të banimit;
- Rritja e ofertës së banesave joprofitabile, zvogëlimin - kufizimin e profitit nga ndërtimet, por jo të rrezikohet interesi i investitorëve që të zhvillojnë aktivitetet ndërtimore të banimit.
- Mirëmbajtja dhe menaxhimi i fondit banesor.

Me menaxhimin e sektorit të banimit do të ketë mundësi të ketë kontroll edhe mbi planifikimin urban dhe do të sigurojë që i menaxhon edhe kërkesat për banim me projekte dhe politika paraprake me zhvillimet në terren dhe do të ndaleshin zhvillimet e paligjshme kur e dimë që shfrytëzuesi më i madh i hapësirës është sektori i Banimit.

Banim për të gjithë s' do të ishte vetëm moto por kusht për zhvillim të qëndrueshëm të një vendi.

01 Nr. ____/22

Datë: 00.10.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesuesi i Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu



-III- Nr. 1 prot. 4651 Më 10.10.2022
Br. prot. Dt. 10.10.2022
RAHOVEC - ORAHOVAC

KOMUNA RAHOVEC

RAPORTI FINANCIAR JANAR-SHTATOR

2022



DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Përmbajtja

HYRJE	2
1.TË HYRAT VETANAKE.....	3
1.1 Të hyra të planifikuara, të realizuara dhe krahasimi i tyre 2022/2021	3
1.2 Të hyrat e rregullta të planifikuara dhe të realizuara në baza mujore 2022/2021 dhe krahasimi.....	3
i tyre.	3
1.3 Krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara në baza mujore 2016-2022.....	4
1.4 Krahasimi i të hyrave të realizuara nga gjobat e trafikut, dhe gjobat nga gjykatat 2022/2021.	4
1.5 Të hyrat e rregullta, Gjobat e Gjykatave, Gjobat në trafik 2022/2021.	5
1.6 Krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike 2022/2021.....	5
2.TATIMI NË PRONË	7
2.1 Planifikimi dhe realizimi i tatimit në pronë 2022/2021	7
2.2 Shpërndarja e faturave, regjistrimet dhe verifikimet e objekteve në Tatimin në Pronë	7
3. REALIZIMI I BUXHETIT	8
3.1 Shpenzimet sipas programeve (drejtorive	8
3.2 Shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe paraqitja grafike	9
3.3 Mallra dhe Shërbime sipas programeve	10
3.4 Mallra dhe Shërbime sipas kodeve ekonomike	12
3.5 Shërbime Komunale	14
4.0 RAPORTI PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE	15

HYRJE

Qëllimi i këtij raporti është që të njoftojë Kryetarin, Bordin e drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe Kuvendin Komunal, për realizimin e buxhetit komunal përfshirë buxhetin e secilës Drejtori – Program buxhetor, duke filluar prej programeve të Administratës së përgjithshme, Shëndetësisë primare, Arsimit dhe Shkencë për periudhën Janar – Shtator 2022, duke përfshirë kategoritë ekonomike të pagave & mëditjet, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe investimet kapitale.

Realizimin i të hyrave komunale-vetjake dhe strukturën e tyre sipas burimeve të tyre, në mënyrë analitike, të hyrat nga gjobat e trafikut dhe të gjykatave si dhe krahasimi i tyre në raport me të njëjtën periudhë Janar-Shtator të vitit 2021/2022

Buxheti i Komunës për vitin 2022, nënkupton Buxhetin e aprovuar nga Ministria e Financës, respektivisht Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2022, për komunën e Rahovecit, të aprovuar paraprakisht edhe nga Kuvendi Komunal dhe organet e tij.

Prezantimi i të dhënave në këtë mënyrë mundëson:

- Prezantimin e raportit financiar në formë transparente dhe të tërësishme,
 - Shikimin e realizimit, respektivisht shpenzimin e mjeteve sipas kategorive (pagave & mëditjet, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe investimet kapitale.
 - Mundësin e krahasimit në mes fondit të planifikuar, të alokuar dhe të shpenzuar sipas kategorive, se a është tejkaluar-shfrytëzuar apo nuk është shfrytëzuar fondi i planifikuar, alokuar,
 - Shprehja në përqindje e shfrytëzimit të buxhetit në periudhën vjetore.
- ❖ Në këtë mënyrë nga aspekti financiar është e arsyeshme të paraqitet:
- Realizimi i të hyrave vetjake-komunale sipas burimeve,
 - Shpenzimet e krijuara sipas kategorive buxhetore,
 - Përqindja e realizimit të buxhetit për këtë periudhë kohore.

Të dhënat e poshtë shënuara, sa i përket shpenzimeve për paga, mallra & shërbime, shërbimeve komunale, subvencioneve, investimeve kapitale si dhe regjistrimi i të hyrave, sipas klasifikimit ekonomik janë të harmonizuara me Departamentin e thesarit të Ministrisë për Financa dhe raportet që dalin nga SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës.

1. TË HYRAT VETANAKE

1.1 Të hyra të planifikuara, të realizuara dhe krahasimi i tyre 2022/2021

Përshkrimi	Realizimi 2021	Realizimi 2022	Ndryshimi 2022-2021	Krahasimi 2022/2021
Të hyrat e rregullta	923,391.32	929,072.70	5,681.38	0.62%

-Vërejtje: në këtë tabelë të hyrat e realizuara për vitet 2021 dhe 2022 janë pa gjokat e trafikut dhe gjykatave.

1.2 Të hyrat e rregullta të planifikuara dhe të realizuara në baza mujore 2022/2021 dhe krahasimi i tyre.

Periudha	Realizimi 2021	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Ndryshimi Realizimi/Planifikim 2022	Përqindja e Realizimit 2022
	1	2	3	3/2	3/2
Janar	79,206.53	112,454.67	66,546.55	(45,908.12)	(40.82)
Shkurt	85,381.57	112,454.67	69,046.40	(43,408.27)	(38.60)
Mars	116,898.68	112,454.67	119,738.61	7,283.94	6.48
Prill	107,245.33	112,454.67	144,682.98	32,228.31	28.66
Elementet e Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale sigurojnë informata edhe për procedura dhe aspekte ligjore të një shërbimi publik, për këtë arsye kategorizimi i fushave për nga niveli arritjeve është bërë duke marrë parasysh qëllimin e treguesve, ngjashmëritë në mes të tyre, përmbajtjes dhe llojit të fushës së kompetencës. Së këndejmi, grupimi i fushave në vijim merr parasysh këto segmente:

- 1) Standardet e qeverisjes së mirë dhe
- 2) Ofrimin e shërbimeve publike.

1) Fushat dhe treguesit e qeverisjes, përfshijnë të dhëna rreth respektimit të standardeve të ligjshmërisë, transparencës, llogaridhënies, përfshirjes aktive të qytetarëve, standardeve të konsultimit publik si dhe çështje të ngjashme. Treguesit e kësaj kategorie kryesisht mbulojnë aktivitetet në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, planifikimin e pronës, punësimin, rregullativën ligjore për të drejtat e komuniteteve, personave me aftësi të veçanta, përfaqësimit gjinor shërbimeve sociale etj.

Fig.3. % e arritur në fushat e qeverisjes



Nga figura 3 vërejmë që në kuadër të treguesve të qeverisjes, në vitin 2021 mesatarja është 56.70%, nga 59.11% sa ishte në vitin 2020. Krahasuar me vitin paraprak, të dhënat tregojnë se komunat kanë rritur efikasitetin në ofrimin e *shërbimeve administrative*, prej 74.42% në 81.66%, apo 7.24% më shumë. Në kuadër të kësaj fushe vlerësohet efikasiteti i komunave në kthimin e përgjigjeve palëve në procedurë administrative, trajtimin të tyre brenda afateve ligjore si dhe ofrimin të shërbimeve administrative në formë elektronike¹.

Në kuadër të *Transparencës komunale*, niveli i përgjithshëm i të arriturave shprehet me 66.92%, nga 77.62% sa ishte në vitin 2020, apo 10.7% më e ulët. Sipas të dhënave, për 3.14% komunat shënojnë ngritje në treguesit e përfaqësimit të barabartë gjinor, megjithëse mbetet

ndër fushat me përqindjen më të ulët (38.02%).

Transparenca komunale lidhet ngushtë me fushën e *përgjegjshmërisë komunale*, e cila vlerësohet me numrin më të madh të treguesve në kuadër të SMPK-së. Për dallim nga treguesit e transparencës të cilët kryesisht janë të orientuar në ofrimin e publicitetit për aktivitetet dhe të dhënave zyrtare, përgjegjshmëria komunale inkorporon të dhëna që tregojnë për nivelin e llogaridhënies së organeve komunale, si dhe aktivitet e tyre për përfshirjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje. Përderisa komunat qëndrojnë mjaft mirë në treguesit e transparencës, rezultatet e përgjegjshmërisë tregojnë për nevojën e fuqizimit të elementeve të llogaridhënies dhe përfshirjes më të madhe të qytetarëve. Kjo fushë rezulton me 53.97%, duke pësuar rënie prej 6.7% krahasuar me vitin paraprak. Edhe më tutje komunat qëndrojnë jo mirë në zbatimin e rregullave për standardet minimale të konsultimit publik 4.65%. Rëndësia e zbatimit të këtyre standardeve qëndron në përmirësimin e planifikimit të politikave, mbështetjen e tyre në informata të vlefshme dhe nevoja reale, për të siguruar shpërndarje të drejtë të investimeve me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik lokal.

Në kuadër të veprimeve që *ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal* komunat kanë përmirësuar performancën për 2.69%, me nivel të përgjithshëm të të arriturave në shkallën 44.55%, krahasuar me vitin 2020 sa ishte 41.86%². Derisa në vitin 2020 vetëm 9 komuna argumentuan të kenë në fuqi Planet për

² Në këtë % të ulët ka ndikuar mungesa e Planeve për zhvillim ekonomik lokal, i cili është një nga indikatorët e kësaj fushe, i përmbyshur në vetëm 9 komuna.

zhvillim ekonomik lokal, në vitin 2021 këto plane janë evidentuar në 12 komuna. Po këtë vit, 13 komuna kanë ndërmarrë veprime për publikimin e listës së pronave të paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, sipas dispozitave të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës. Në të njëjtën kohë, komunat kanë arritur që standardin e verifikimit prej 20% me qëllim të mbledhjes së tatimit në pronë ta përmbushin në shkallë prej 72.09%, apo 14.48 më shumë se në vitin 2020 sa ishte 57.61%. Në anën tjetër, 41.09% është raportuar niveli i përgjithshëm i mbledhjes së tatimit në pronë, për 0.91% më pak se në vitin 2020 (pa borxhe, interesa, ndëshkime).

Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare – Në kuadër të kësaj fushe janë matur veprimet e komunave për ofrimin e banimit social, si dhe kujdesin institucional ndaj grupeve të cënueshme. Po ashtu janë mbledhur të dhëna për punësimin e personave me aftësi të veçanta dhe punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë bazuar në të drejtat ligjore të tyre. Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 55.09% krahasuar me 65.23% të vitin paraprak. Bazuar në Ligjin Nr.03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, përrkatësisht nenin 12, “çdo institucion publik duhet të ketë të punësuar një person me aftësi të kufizuara në çdo 50 punonjës (apo 2% e të punësuarve)”. Sipas të dhënave të vitit 2021, ky kriter ligjor është përmbushur në shkallën prej 23.67%, për dallim nga viti 2020 sa ishte 21.69%. Ndërsa, sa i përket përmbushjes së kriterit ligjor për punësimin e komuniteteve joshumicë, respektivisht nenit 9 të Ligjit për zyrtarët publik me të cilin kërkohet që plotësimi i vendeve të punës në nivel komunal të bëhet në pajtim me përqindjen e popullatës së asaj komune, të dhënat tregojnë për 58.13% të përmbushjes së këtij kriteri. Të dhënat e analizuara për strehimin familjar theksojnë se në vitin 2021 komunat kanë arritur t’i përgjigjen kërkesave të qytetarëve në shkallën 47.92%, krahasuar me 62.30% të vitit 2020.

2) Fushat me tregues për ofrimin e shërbimeve publike.

Në kuadër të këtyre fushave bëjnë pjesë tregues për lloje të ndryshme të ofrimit të shërbimeve nga ana e komunave, si në: menaxhim të mbeturinave, furnizim me ujë, mbrojtje të ambientit, kanalizim, planifikim urban, aktivitete kulturore, arsim, shëndetësi, infrastrukturë rrugore, trotuare, ndriçim publik, mirëmbajtje të hapësirave publike, mirëmbajtje të rrugëve, shtigje të biçikletave, parkingje publike, shenjëzim të rrugëve etj. Nga figura 4 rezulton që në kuadër të treguesve të shërbimeve publike, mesatarja e përgjithshme e arritur është 56.8%.

Fig 4. % e arritur në fushat e shërbimeve publike




Fig.6. Performanca e komunave në fushat e matjes së shërbimeve publike gjatë vitit 2020

Furnizimi me ujë është njëra ndër kompetencat vetanake të komunave e përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Legjislacioni specifik e ka rregulluar më gjerësisht çështjen e menaxhimit të ujit të pijshëm, duke e lënë një pjesë të rëndësishme të kësaj fushe në përgjegjësi të ndërmarrjeve qendrore. Pavarësisht kësaj, komunave nuk u është hequr kjo kompetencë, pasi që në mesin e obligimeve të rëndësishme strategjike, duhet të planifikojnë dhe zbatojnë investime të përvjetshme në zgjerimin e infrastrukturës dhe rrjetit të ujësjellësit.³ Të dhënat për shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit në komuna, gjegjësisht familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore, pasqyrohen me 79.19 të ofrimit të këtij shërbimi. Derisa në vitin 2020, komunat kishin arritur të zbatonin 22.11% të planeve vjetore për ndërtim dhe mirëmbajtje të sistemit të ujësjellësit, në vitin 2021 këto plane apo projekte të planifikuara janë zbatuar në shkallë prej 48.65%. Krahas ujit të pijshëm, **ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të zeza** rezultojnë me 35.49%, ku 60.10% shprehet në treguesin për realizimin e planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit, ndërsa 73.23% e ekonomive familjare, institucioneve publike dhe njësive biznesore të 27 komunave që kanë ofruar të dhëna janë të kyçura në sistemin e kanalizimit.

Sa i përket **menaxhimit të mbeturinave**, mesatarja e të arriturave në vitin 2021 shprehet në nivel prej 70.16, krahasuar me 64.72%, të vitit 2020.. Më konkretisht janë realizuar 40% e aktiviteteve të planifikuara në këtë fushë janë realizuar, për dallim nga viti paraprak ku ishin realizuar 35.32% të projekteve.

Në anën tjetër, 80.28% është niveli përfshirjes së ekonomive familjare në sistemin e grumbullimit të mbeturinave, sipas të dhënave valide të 31 komunave. Gjithashtu, të dhënat për këtë vit tregojnë se komunat, kanë përmbyshur 72.40% orarin për grumbullimin e mbeturinave sipas planeve të tyre. Sipas të dhënave të 30 komunave që kanë dokumentuar nivelin e inkasimit të obligimeve ndaj operatorëve të mbeturinave, të arriturat pasqyrohen në nivel prej 89% të mjeteve. Shkalla e deponimit të mbeturinave

vlerësohet në 50.62%, krahasuar me kriterin e marrë sipas standardeve të BE-së prej 300 kg për person në vit.

Bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale, komunat janë kompetente edhe për fushën e infrastrukturës lokale, zhvillimit ekonomik lokal, mbrojtjes së ambientit, menaxhimit të fatkeqësive, planifikimit urban, pronës komunale, arsimit dhe shëndetësisë. Të dhënat për *infrastrukturën rrugore* tregojnë për 52.04% të arriturave në këtë fushë. 81.78% e rrugëve lokale konsiderohen të shtruuara sipas të dhënave valide të 29 komunave, për dallim nga viti paraprak sa ishte 76.04%. Në anën tjetër, 62.6% e rrugëve janë mirëmbajtur në 26 komuna që kanë ofruar të dhëna të dokumentuara, krahasuar me 58.76% në vitin paraprak. Mirëmbajtja dimërore shprehet në shkallë prej 68.03%. Krahasj tyre, 22.39% e rrugëve të 24 komunave që kanë raportuar, janë të përcjella me trotuare, për dallim nga viti paraprak sa ishin 20.69 %. Komunat kanë përmirësuar edhe infrastrukturën e ndriçimit të rrugëve publike, e cila në vitin 2021 del të jetë në shkallë prej 46.33, apo 7.58% më e lartë se në vitin 2020. Po ashtu, të dhënat e 27 komunave që kanë raportuar, tregojnë për 60.92 të rrugëve të pajisuar me shenjzim vertikal e horizontal, për 7.92% më lartë se në vitin 2020.

Sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese të hollësishme ose harta zonale është në shkallë prej 8.05%, në 19 komuna të cilat kanë ofruar të dhëna për vitin 2021. Në 94% të rasteve komunat janë përgjigjur në trajtimin e kërkesave për leje ndërtimore (sipas të dhënave të vlefshme të 29 komunave). Në anën tjetër, 65.48 të hapësirave publike mirëmbahen rregullisht, krahasuar me 64.52% të një viti më parë. 79.74% e këtyre hapësirave janë të përcjella me ndriçim publik. Njëherësh komunat kanë raportuar Rreth 87% e vendbanimeve janë të raportuar të jenë të përfshira në shërbimin e transportit publik lokal në 24 komuna.

Sa i përket *menaxhimit të fatkeqësive*, kjo fushë matë planifikimin, organizimin dhe udhëheqjen e sistemit të organizuar të komunës për tu përgjigjur ndaj dukurive të shkaktuara nga fuqitë e pakontrolluara dhe nga fuqitë tjera. Fusha ka vetëm një rezultat dhe dy tregues, që kryesisht vlerësojnë realizimin e planit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore, si dhe nivelin e përgjigjeve të institucioneve komunale ndaj rasteve të paraqitura në këtë fushë. Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 61.67%.

Fusha e Arsimit parauniversitar mbledh tregues të shumtë për kompetencat e komunave në krijimin e kushteve për edukimin dhe arsimimin e nxënësve, prioritetet e vëna në këtë sektor përmes planifikimit të buxhetit, nivelin e planifikimit dhe realizimit të orëve mësimore, rezultatet e nxënësve, kushtet teknike dhe higjienike në shkollë, pajisjet e klasave me mjete pune, digjitalizimin e shkollave, aspektet e sigurisë, kriteret për kualifikimin dhe licencimin e mësimitdhënësve, mbingarkesën në klasë, hapësirat shkollore etj. Në këtë fushë komunat kanë treguar performancë në shkallë prej 58.39%. Nisur nga niveli parafillor, të dhënat flasin për përfshirje tejet të ulët të fëmijëve nëpër çerdhe, e sidomos në zonat rurale, për shkak të mungesës së investimeve në këto zona. Shikuar sipas kriterit të matjes 1 çerdhe për 10 mijë banorë, të dhënat tregojnë për vetëm 0.61% të arritjes këtij kriteri. Në vitin raportues, të dhënat tregojnë për përmirësim të kushteve të kërkuara me infrastrukturë, pajisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar. Derisa në vitin 2020 të dhënat në këtë tregues ishin në shkallë prej 57.49%, në vitin 2021 janë prezantuar me 66.77%. Në këtë pjesë përfshihen të dhënat për: mjetet e sallave të edukatës fizike, kabinetet, laboratorët, materialet shpenzuese, bibliotekat, orenditë e zakonshme shkollore, pajisjet elektrike, projektorë, tabelat elektronike etj. Për të gjitha këto, komunat pranojnë mjete financiare nga

buxheti i rregullt publik, çoftë përmes grantit specifik për arsim, apo përmes ndarjeve buxhetore nga kategoria e të hyrave vetanake. Bazuar në të dhënat e vitit 2020, mesatarja e hapësirave shkollore në nivel vendi është 18 m² për kokë nxënësi në zonat rurale dhe urbane. Komunitat kanë raportuar për 71.34 % të shkollave të pajisura me kabinete të TIK-ut, për dallim nga viti 2020 që shprehej me 61%. Po ashtu, të dhënat tregojnë komunitat kanë zgjeruar investimet në paisjen e shkollave me masa të efijencës, ku 62.95% e shkollave vlerësohen të jenë të pajisura me masa tilla, krahas 50.81% sa ishte në vitin 2020. Prej numrit të përgjithshëm të mësimehënësve në nivelin e arsimit parauniversitar në komunitë, sipas niveleve ISCEC 02, 1, 2, dhe 3, përqindja e atyre që janë të pajisur me licencë sipas UA 05/2017 MASHT, është 82.18% (sipas të dhënave të 24 komunitave). Konstantja e llogaritur prej 26 nxënës për 1 mësimehënës sipas udhëzimit administrative të MASHT, është 67.46%. Lidhur me plotësimin e vendeve të lira të punës në arsim me konkurs të rregullt, sipas të dhënave valide të 24 komunitave, performance është 94.43% në raport me planifikimin. Mesatarja e kalueshmërisë (KI.12) për komunitat që kanë ofruar të dhëna valide, është 76.34%.

Në fushën e *shëndetësisë primare* janë ofruar të dhëna për infrastrukturën dhe hapësirat e destinuara për shëndetësinë primare, resurset dhe personelin e mjaftueshëm, si dhe ofrimin e shërbimeve nga niveli komunal. Sipas të dhënave të raportuara nga komunitat, në përgjithësi kjo fushë ka nivel prej 51.14 në vitin 2021, krahas performances prej 55.96% të një viti më parë.

Bazuar në të dhënat e ofruara, 44.85% e objekteve të kujdesit primar shëndetësor janë të pajisura me mjetet e kërkuara sipas udhëzimit administrativ të MSH-së për shërbimet laboratorike, për dallim nga viti paraprak sa ishte 41.78%. Në 24 komuna me të dhëna valide, niveli i pajtueshmërisë me raportin një specialist i mjekësisë familjare dhe 2 infermirerë për 2000 banorë sipas kriterëve të caktuara nga MSH, është 73.93%. Për këtë sektor, komunitat kanë ndarë nga buxheti i të hyrave vetanake rreth 8.69 % krahasuar me Grantin specifik për shëndetësi të alokuar nga buxheti i përgjithshëm, apo 3.64%

Kapitulli II

II. Pjesa e veçantë - Performanca e komunitave 2020

1. Rezultatet e komunitave sipas fushave dhe treguesve

Matja e performancës në vitin 2021 ka pasur në fokus pasqyrimin e të arriturave për 38 komuna. Kërkesës për raportim i janë përgjigjur 37 komuna, megjithëse shkalla e pavarshmërisë së të dhënave ishte mjaft e shprehur në disa komuna

Shkalla e ofrimit të shërbimeve dhe respektimit të standardeve të qeverisjes ndryshon nga njëra komunitë në tjetrën, varësisht nga fusha e kompetencave që matet. Në nivelin e performancës mund të ndikojnë faktorë të shumtë, si: prioritetet e vëna nga komuna brenda fushave për të cilat ushtrohet matja, mënyra dhe cilësia e planifikimit të punëve, realizimi në raport me planifikimin, realizimi në raport me mundësitë dhe pengesat e caktuara, kapacitetet dhe resurset, kompleksiteti i çështjeve, cilësia e raportimit të të dhënave në SMPK, si dhe faktorë të tjerë relevant.

Në vijim të këtij raporti, janë paraqitur detaje të të arriturave të komunitave sipas fushave dhe treguesve përkatës.

Sqarim: Në vijim të raportit, llogaritja e rezultatit përfundimtar të fushave të matjes, merr për bazë edhe vlerën 0 për të dhënat e të cilave janë shpallur të pavlefshme. Kjo është bërë për arsye se edhe keqraportimi konsiderohet performancë e dobët, gjë që duhet të ndikoj në rezultatit përfundimtar të komunave që nuk kanë ofruar të dhëna. Kjo reflekton edhe në krahasimet në mes të komunave si dhe vlerësimet e bëra për qëllime të Grantit për Performancë.

PËRMBAJTJA:

- Fusha e parë- Shërbimet publike administrative
- Fusha e dytë- Transparenca
- Fusha e tretë- Përgjegjshmëria komunale
- Fusha e katërt- Barazia në punësim
- Fusha e pestë- Kulturë, rini dhe sport
- Fusha e gjashtë- Menaxhimi i fatkeqësive
- Fusha e shtatë- Planifikimi hapsinorë
- Fusha e tetë- Hapësirat publike
- Fusha e nëntë- Infrastruktura rrugore
- Fusha e dhjetë- Transporti publik
- Fusha e njëmbëdhjetë- Parkingjet publike
- Fusha e dymbëdhjetë- Uji i pijshëm
- Fusha e trembëdhjetë- Kanalizimi
- Fusha e katëmbëdhjetë- Menagjimi i mbeturinave
- Fusha e pesëmbëdhjetë- Mbrojtja e ambientit
- Fusha e gjashtëmbëdhjetë- Përfaqësimi gjinor
- Fusha e shtatëmbëdhjetë- Arsimi parauniversitar
- Fusha e tetëmbëdhjetë- Kujdesi primar shëndetsorë
- Fusha e nëntëmbëdhjetë- Zhvillimi ekonomik lokal

1. HYRJE

Në bazë të udhëzimit të punës së sistemit të menagjimit të performancave, komuna raporton për 19 (nëntëmbëdhjetë) fusha gjithsej.

Për here të parë në këtë vit kemi raportuar për 19 fusha, mendoj që ka qenë punë me përgjegjesi dhe shumë e vështirë për disa fusha të cilat kanë qenë të panjohura për zyrtarët, por në përgjithësi puna është kryer dhe janë plotësuar të gjitha dhe iu është dërguar materiali në ministri.

○ FUSHA E PARË- SHËRBIMET PUBLIKE ADMINISTRATIVE

Tek administrata kërkohet numri i lëndëve të parashtruara gjatë tërë vitit, numri i lëndëve të shqyrtuara gjatë një viti nga ana e komunës, problemi është sepse tek intraneti ende nuk është funksional për shqyrtimin e lëndëve 7-ditore, 10 ditore, 30-ditore dhe 45-ditore, varësisht nga rëndësia e lëndës.

Te kjo fushë te formulari 1.1.1- te kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit komuna ka raportuar 99.6 %

Te formulari 1.1.2- te kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore komuna ka raportuar 100%.

Te formulari 1.1.3- te formulari koha mesatare e shqyrtimit të lëndëve gjatë vitit ka qenë indikator i ngrirë.

Te formulari 1.1.4- te formulari shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna ende nuk ka kërkesa të mjaftueshme nga qytëtarët nga E-kiosku, për një performancë më të mirë duhet të njoftohen qytëtarët që mund të kryejn shërbime edhe përmes E-kioskut ose edhe me sistem online kurse komuna ka raportuar 71.40%

○ FUSHA E DYTË- TRANSPARENCA

Tek kjo fushë te formulari 2.1.1- te mbledhja e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtëpersedrejtë online vlera e tregiesit është raportuar 100%.

Te formulari 2.1.2- te sigurimi i qasjes në dokumentat publike nga qytetarët kemi raportuar 100%.

Te formulari 2.1.3- te përmbushja e kriterëve te faqes zyrtare elektronike të komunës vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 2.1.4- publikimi i akteve të miratuar në kuvendin komunal vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 92.50%, për arsye sepse ka pasur problem me web-faqen, nuk ka funksionuar dhe për këtë arsye nuk është arritur 100%- ndëshi.

Te formulari 2.1.5- publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm të miratuar nga kryetari i komunës në faqën zyrtare të komunës vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 2.2.1- publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shfrytëzim të buxhetit për kornizën afatmesme buxhetore vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 80%.

Te formulari 2.2.2- publikimi i dokumenteve të prokurorimit publik dhe kontratave dmth publikimi i planit të prokurimit dhe datave të publikimit të raportit vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 98.49%.

o FUSHA E TRETË- PËRGJEGJËSHMËRIA KOMUNALE

Tek kjo fushë te formulari 3.1.1- publikimi i njoftimeve për mbajtjen e dy takimeve publike vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 3.1.2- te numri i pjesëmarrësve në konsultime publike gjatë vitit nga informatat dhe mbajtja e debateve në konsultime publike vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 38.84%.

Te formulari 3.1.3- numri i akteve të miratuara me interes të përgjithshëm që është organizuar me konsultime publike vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 3.1.4- te raporti i procesverbalit të degjimeve buxhetore vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 3.1.5- te numri i konsultimeve publike të mbajtur gjatë vitit vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 3.2.1- tek miratimi me kohë i propozimit të buxhetit vjetor komunal, kemi arritur rreth 70% për arsye sepse nuk është bërë miratimi nga kuvendi komunal i buxhetit para datës 30- Shtator për këtë arye është vlera e ulët e performancës.

Te formulari 3.2.2- sigurimi i llogaridhënies dhe respektimi i akteve ligjore në procese të kuvendit komunal, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 3.2.5- diskutimi i raportit të auditorit të brendshëm, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 0 %.

Te formulari 3.2.6- numri i mbledhjeve të kuvendit në të cilat ka marrë pjesë kryetari i komunës, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 3.3.1- Niveli i zbatimit të planit te prokurimit , vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100 %.

Te formulari 3.3.3- niveli i adresimit të rekomandimeve të zyrës kombëtare të auditorit vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 33.33%.

Te formulari 3.4.1- raporti i planit vjetor të integritetit para kuvendit komunal vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 0%.

Te formulari 3.4.2- suspendimi i zyrtareve komunal në raport me aktakuzat e ngitura ndaj tyre nuk ka pasur për vitin 2021, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 3.5.1- zbatimi i skemës të punës te sherbyesit civil kemi vlerën 100 %

Te formulari 3.5.3- kontratat për shërbime të veçanta a janë në pajtueshmëri me kornizën ligjore, dmth numri i kontratave të cilat e plotësojnë kornizën ligjore, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

○ FUSHA E KATËRT- BARAZIA NË PUNËSIM

Tek kjo fushë te formulari 4.1.1- numri i njerëzve me nevoja të veçanta të punësuar në komunë arrinë vlerën 41.77%.

Te formulari 4.1.2- numri i të përgjithshëm i të punësuarve në institucione komunale në krahasim numrin e përgjithshëm nga komunitetit pakicë vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 4.2.1- numri i përgjithshëm i familjeve të cilave iu është siguruar banimi social nga komuna, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 4.2.2- fëmijet me nevojë për strehim të cileve iu është siguruar stehim familjar vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

○ FUSHA E PESTË- KULTURË, RINI DHE SPORT

Tek kjo fushë te formulari 5.1.1- hapësirat për aktivitetet sportive me numër të banorëve për m², vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

○ FUSHA E GJASHTË- MENAXHIMI I FATKEQËSIVE

Tek kjo fushë te formulari 6.1.1- niveli i realizimit të planit komunal për menaxhim të fatkeqësive numri i veprimeve të planifikuara dhe ato të realizuara, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 0% sepse ende nuk kemi Plani i Menaxhimeve te Fatkeqësive .

Te formulari 6.1.2- numri i fatkeqësive në të cilat ekipet kanë intervenuar në vendin e ngjarjes, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

o FUSHA E SHTATË- PLANIFIKIMI HAPSINORË

Tek kjo fushë te formulari 7.1.1- sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese të hollësishme vlera e raportimit është 5.59% për arsye sepse nuk kemi plane rregulluese të hollësishme ende, harta zonale është në proces.

Te formulari 7.2.1- kërkesa të shqyrtuara për leje të ndërtimit vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 85.29%.

Te formulari 7.2.2- numri i përgjithshëm të objekteve ndërtimore të reja në vitin e raportimit, me numrin e përgjithshëm të objekteve të inspektuara gjatë vitit të raportimit vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 71.42%.

Te formulari 7.2.3- numri i përgjithshëm i objekteve të reja gjatë vitit të raportimit me numrin e përgjithshëm e përgjithshëm të objekteve të inspektuara në raport me objektet e reja të inspektuara vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

o FUSHA E TETË- HAPËSIRAT PUBLIKE

Tek kjo fushë te formulari 8.1.1- sipërfaqja e Hapësirave të gjelbra publike në hektar për kokë banori vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 8.1.2- sipërfaqja e Hapësirave që mirëmbahen rregullisht në hektar për kokë banori vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 60.11%.

Te formulari 8.1.3- sipërfaqja e Hapësirave të paisura me ndriqim publik në hektar për kokë banori vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 31.31%.

o FUSHA E NËNTË- INFRASTRUKTURA RRUGORE

Tek kjo fushë te formulari 9.1.1- rrugët lokale të shtruara, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 81.80%.

Te formulari 9.1.2- rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonit të verës, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 33.79%.

Te formulari 9.1.3 - rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonit të dimrit, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 74.43%.

Te formulari 9.2.1 - gjatësia e rrugëve lokale të paisura me trotuar, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 43.79%.

Te formulari 9.2.2 - gjatësia e rrugëve lokale të paisura me ndriqim publik, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 49.49%.

Te formulari 9.2.3 - gjatësia e rrugëve lokale të paisura me shenjëzim vertikal dhe horizontal, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 9.2.4 - gjatësia e rrugëve urbane me shteg të biçikletave, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 8.14%.

Te formulari 9.2.5 - rrugët lokale të riasfaltuara, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

○ FUSHA E DHJETË- TRANSPORTI PUBLIK

Tek kjo fushë te formulari 10.1.1- plani komunal për transport lokal publik, numri i veprimeve të planifikuara dhe të realizuara, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 0 %.

Te formulari 10.1.2 – vendbanimet e përfshira në transport lokal publik ku janë të përfshira 36 vendbanime, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 10.1.3 – vendndalimet e shenjëzuara për automjetet e transportit publik, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

○ FUSHA E NJËMBËDHJETË- PARKINGJET PUBLIKE

Tek kjo fushë te formulari 11.1.1- numri i përgjithshëm i parkingjeve publike në komunë, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 18.79%.

Te formulari 11.1.2 – numri i vendparkimeve publike në krahasim me numrin e veturave të cilat kanë regjistrim të vlefshëm, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 11.1.3 – vendparkingjet e destinuara për Taxi, nga 19 të cilat kanë kërkuar leje 19 janë licensuar dhe 19 kanë vendparkingje, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 11.1.3 – numri i parkingjeve me vendparkim të rezervuar për persona me aftësi të kufizuara, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 50,1%.

○ FUSHA E DYMBËDHJETË- UJI I PIJSHËM

Tek kjo fushë te formulari 12.1.1- realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e ujësjellësit, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 12.1.2 – ekonomitë familjare dhe institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në ujë të pijshëm, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 99.07%.

○ FUSHA E TREMBËDHJETË- KANALIZIMI

Tek kjo fushë te formulari 13.1.1- realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 13.1.2 – ekonomitë familjare dhe institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistem të kanalizimit, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 86.99%.

○ FUSHA E KATËRMBËDHJETË- MENAGJIMI I MBETURINAVE

Tek kjo fushë te formulari 14.1.1- realizimi i planit komunal për planin komunal për menagjim të mbeturinave, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 14.1.2 – ekonomitë familjare dhe institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistem të grumbullimit të mbeturinave, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 88.14%.

Te formulari 14.2.1 – ofrimi i qëndrueshëm i ofrimit të mbledhjes së mbeturinave dhe realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 14.2.2 – inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave, , vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 88.14,%.

○ FUSHA E PESËMBËDHJETË- MBROJTJA E AMBIENTIT

Tek kjo fushë te formulari 15.1.1- realizimi i planit të veprimit lokal të veprimit në mjedis, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 15.1.2 – kërkesat për leje mjedisore komunale për objektet që kërkohet leja gjatë vitit, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 15.1.3 – ndërtesat e reja të cilat e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale në raport me numrin e kërkesave të inspektorave gjatë vitit, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

o FUSHA E GJASHTËMBËDHJETË- PËRFAQËSIMI GJINOR

Tek kjo fushë te formulari 16.1.1- gratë e punësuar në institucione komunale, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 74.01%.

Te formulari 16.1.2 – gratë në pozita udhëheqëse neper institucione arsimore, shëndetsore, kulturore, sportive, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 52.63%.

Te formulari 16.1.3 – gratë e emëruara në pozita politike në komunë, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 84.61%.

Te formulari 16.1.4 – barazia gjinore tek anëtarët e komuniteteve komunale, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 75.35%.

Te formulari 16.1.5 – barazia gjinore te përbërja e këshillave lokale, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 16.2.1 – buxhetimi dhe shpenzimi i përgjegjshem gjinor, përfshirja e aspektit gjinor në buxhetin komunal, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 16.2.2 – barazia gjinore në buxhetimin për punësim dhe ndërmarrësi të grave, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 2.06%

Te formulari 16.2.3 – pjesëmarrja e grave në takime publike, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 36.80%.

Te formulari 16.2.4 – plani komunal për barazi gjinore, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 16.3.1 – barazia gjinore tek emertimet e rrugëve, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 18.88%

Te formulari 16.3.2 – regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 0,2%.

o FUSHA E GJASHTËMBËDHJETË- ARSIMI PARAUNIVERSITAR

Te formulari 17.1.2 – shtrirja adekuatë e infrastrukturës arsimore dhe objekteve të paisura me mjete bashkëkohore për zhvillimin e aktiviteteve arsimore në m², vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 6.87%.

Te formulari 17.1.3 – shkollat e paisura me kabinete të TIK-ut, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 40%.

Te formulari 17.1.4 – shkollat me masë të eficiencës së energjisë, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 65.62%.

Te formulari 17.1.5 – siguria në institucionet e arsimit parauniversitar (kamerat), vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 70%.

Te formulari 17.1.6 – shtrirja adekuatë e infrastrukturës arsimore, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 57.81%.

Te formulari 17.2.1 – mësimdhënësit të cilët i plotësojnë kriteret e kualifikimit të licencuar, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 87,9%.

Te formulari 17.2.2 – Niveli i pajtueshmërisë me raportin e synuar nxënës për mësimdhënëës –urban dhe rural 54.35 %

Te formulari 17.2.3 – plotësimi i buxhetit për arsim për të hyra vetanake, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 0.59%.

Te formulari 17.2.4 – plotësimi i vendeve të lira të punës me konkurs të rregullt, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 17.2.5 – plotësimi i vendeve të lira të punës me konkurs plotësues, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 17.2.6 – respektimi dhe procedurat ligjore në përzgjedhjen e stafit drejtues në shkolla (drejtorve dhe zëvendësdrejtorëve), vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 17.3.2 – shkalla bruto e regjistrimit në klasë të parë , vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 17.3.3 – shkalla e çasjes së tranzicionit prej klasës 9-10, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 17.3.4 – rezultatet e testit të arritshmërisë tek klasat e 9-nta, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 76.01%.

Te formulari 17.3.5 – kalueshmëria në maturën kombëtare e klasëve të 12-ta, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 65.17,2%.(ndarja sipas gjinisë.)

Te formulari 17.3.7 – Braktisja e shkollës nga nxënësit (shkalla inverse), vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 99.33 %.

Te formulari 17.3.8 – shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vjetorë të arsimit, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 96.18%

o FUSHA E TETËMBËDHJETË- KUJDESI PRIMARË SHËNDETËSORË

Tek kjo fushë te formulari 18.1.1- m² të hapësirave për 10,000 banorë, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 18.1.2 – objektet të cilat janë të paisura me shërbimet laboratorike, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 18.2.1 – niveli i pajtueshmërisë në raportin një mjek familjar dhe dy infermjere për 2000 banorë, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 66.17%.

Te formulari 18.2.2 – përqindja e kujdesit primar shëndetësor të mbështetur nga komuna për të hyra vetanake, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 3.12%.

Te formulari 18.3.1 – numri i vizitave të pacienteve në kujdesën shëndetësor për kokë banori, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 18.58%.

Te formulari 18.3.2 – fëmijët e përfshirë në programin e imunizimit, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 92.44%.

Te formulari 18.3.3 – ofrimi i kujdesit shëndetësor për gra dhe fëmij, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

o FUSHA E NËNTËMBËDHJETË- ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL

Tek kjo fushë te formulari 19.1.1- realizimi i planit vjetor, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 19.1.2 – përgaditja dhe publikimi i listave të pronave komunale të dhëna në shfrytëzim, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 50 %.

Te formulari 19.1.3 – niveli i azhurimit të regjistrimit të tatimit në pronë, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 100%.

Te formulari 19.1.4 – niveli i mbledhjes së faturës te tatimi në pronë, vlera e përqindjes të cilën kemi raportuar është 46.15 %.

PËRFUNDIM

Matja e performancës është një instrument i rëndësishëm i të gjitha programeve të menagjimit të cilësisë. Si institucion kemi përgjegjësi se si ku dhe kur duhet ti marrim masat për zhvillimet e ndryshme të institucioneve.

Ne do të mbetemi të përkushtuar si qeverisje lokale të jemi një qeverisje e mirë që të ofrojmë shërbime sa më cilësore për qytetarët e komunës sonë, po ashtu synojmë të jemi pjesë e grandit fitues Janar- Dhjetor 2021.

Bjondina Ramaj- Fazliu
Koordinatorë për Performancë





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC



Njësia e Auditimit të Brendshëm
Komuna e Rahovecit

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI I PREDSIEDIKE OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2668 Nr. i faq./Br.sht./No.pg 38
Data/Datum/Date 5 / 9 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

RAPORT VJETOR I PUNËS

Për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021.

14.01.2022

Raporti i punës së NJAB-së për periudhën Janar - Dhjetor të vitit 2021

Në periudhën Janar – Dhjetor Njësia e Auditimit të Brendshëm për punën e vet, është bazuar kryesisht në Planin vjetor të punës për vitin 2021, i cili plan ka qenë i aprovuar nga Kryetari i Komunës së Rahovecit.

Ndërsa bazë ligjore ka pasur Ligjin Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Udhëzimet Administrative për Auditim të Brendshëm, Doracakun e Auditimit të Brendshëm, Statutin e Auditimit të Brendshëm dhe Instruksionet lidhur me Standardet Ndërkombëtarë të Auditimit të Brendshëm.

Sipas Planit Vjetor të NJAB-së, për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2021, kemi arritur të kryejm 10 (dhjetë) auditime, aq edhe sa ishin të planifikuara.

Në listën e mëposhtme do të paraqiten të gjitha auditimet të planifikuara dhe të kryera për periudhën Janar - Dhjetor të vitit 2021 sipas Planit Vjetor dhe sipas shkallës së rrezikshmërisë.

Drejtoritë e audituara të Planifikuara dhe të realizuara për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2021

1. Auditimi i brendshëm në Drejtorin Komunal të Arsimit.
2. Auditimi i brendshëm në Drejtorin për Shërbime Publike, Komunale.
3. Auditimi i brendshëm në Drejtorin për Urbanizëm, Planifikim Hapsinor dhe Mbrojtje të Mjedisit.
4. Auditimi i brendshëm në Drejtorin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
5. Auditimi i brendshëm në Drejtorin për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.
6. Auditimi i brendshëm në Drejtorin për Shëndetësi dhe Mirqenie Sociale. (QKMF).
7. Auditimi i brendshëm në Drejtorin për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
8. Auditimi i brendshëm në Drejtorin për Administratë të Përgjithshme.
9. Auditimi i brendshëm në Drejtorin për Financa dhe Buxhet.
10. Auditimi i brendshëm në Zyrën e Prokurimit.

Aktivitetet dhe angazhimet e tjera të Njesisë së Auditimit të Brendshëm

Angazhimet tona kryesisht kanë qenë:

- Vlerësimi i objektivave për auditime, sipas shkallës së rrezikshmërisë, është pregaditur Plani Strategjik i NJAB për vitet 2022 – 2024, dhe Plani Vjetor i Punës së NJAB-së për vitin 2022.
- Raporti i gjashtëmujorshit të dytë dhe Raporti Vjetor i NJAB-së për vitin 2021, i janë dorëzuar Njesisë Qendrore për Harmonizim të Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), Kryetarit të Komunës dhe Komitetit për Auditim të Brendshëm, të gjitha janë dorëzuar brenda afatit kohor të paraparë me ligj.
- Verifikimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna në periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2021.
- Si aktivitete tjera mund të ceken ofrimin e ndihmave profesionale të vazhdueshme për të gjitha Drejtoritë Komunale që kanë shfaqur interesim dhe nevojë, lidhur me të kuptuarit e rreziqeve në implementimin e rekomandimeve, identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e tyre, duke e krijuar një regjistër me rreziqe të identifikuara ashtu që menaxhmentet gjegjëse të kenë më lehtë të ushtrojnë kontrollet gjegjëse adekuate për minimizimin e çdo rreziku që mund të jetë pengesë për zbatimin e objektivave të Drejtorive.
- Gjithashtu NJAB-ja ka pasur angazhime me të gjithë zyrtarët të cilët me një formë ose tjetër kanë qenë të kyçur në procesin e implementimit të rekomandimeve.

